



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



---

**TEZA E MAGJISTRATURËS**

**“MENAXHIMI I PARADIGMAVE TË MËSIMDHËNIES BASHKËKOHORE MBËSHTETUR  
NË TEKNOLOGJINË E KOMUNIKIMIT NË ARSIMIN FILLOR NË KOMUNËN E  
TETOVËS”**

---

**Studime të ciklit të dytë - Menaxhimi dhe udhëheqja në arsim**



**Universiteti i Evropës Juglindore**

**Fakulteti i Gjuhëve Kulturave dhe Komunikimit**

Mentori:

Prof.Dr.Arafat Shabani

Kandidatja:

Fazlije Ceka

## PËRMBAJTJA E TEZËS SË MAGJISTRATURËS

|                                                                                                                                                                    |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Përmbledhje .....                                                                                                                                                  | 4  |
| Предговор .....                                                                                                                                                    | 6  |
| Abstract .....                                                                                                                                                     | 8  |
| Hyrja .....                                                                                                                                                        | 10 |
| Lënda e hulumtimit .....                                                                                                                                           | 10 |
| Qëllimet e hulumtimit .....                                                                                                                                        | 17 |
| Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit .....                                                                                                                           | 17 |
| Metodologjia e hulumtimit.....                                                                                                                                     | 18 |
| Rëndësia e punimit .....                                                                                                                                           | 20 |
| Kapitulli 1 - Definimi i koncepteve dhe paradigmeve arsimore .....                                                                                                 | 21 |
| 1.1 Definimi i menaxhimit të arsimit .....                                                                                                                         | 21 |
| 1.2 Definimi i udhëheqjes së mësimdhënies .....                                                                                                                    | 27 |
| 1.3 Definimi i mësimdhënies tradicionale kundrejt mësimdhënies bashkëkohore të mbështetur në teknologji si koncept dhe paradigmë e re e arsimit të shekullit ..... | 29 |
| Kapitulli 2 - Menaxhimi i paradigmes së re të mësimdhënies dhe nxënies në arsimin fillor .....                                                                     | 30 |
| 2.1 Praktikat më të mira të menaxhimit të shkollave fillore në drejtim të menaxhimit të paradigmes së re të mësimdhënies .....                                     | 30 |
| 2.2 Roli dhe sfidat e drejtorëve të shkollave fillore në sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies .....                                                    | 35 |
| 2.3 Roli dhe sfidat e drejtorëve të shkollave fillore në sigurimin e infrastrukturës teknologjike në shkolla .....                                                 | 39 |
| 2.4 Roli dhe sfidat e drejtorëve të shkollave fillore në zhvillimin profesional të mësimdhënësve për të përdorur teknologjinë informative në mësimdhënie .....     | 40 |
| Kapitulli 3 – Efikasiteti i metodave bashkëkohore të mësimdhënies të bazuara në teknologji informative .....                                                       | 44 |
| 3.1 Praktikat më të mira të dixhitalizimit të shkollave dhe përdorimin efektiv të teknologjisë në klasë .....                                                      | 44 |
| 3.2 Efikasiteti i metodave të mësimdhënies të mbështetura në teknologji.....                                                                                       | 46 |
| 3.3 Përfitimet e arsimtarëve dhe nxënësve nga përdorimi i teknologjisë në procesin edukativo arsimor .....                                                         | 50 |
| 3.4 Përdorimi i teknologjisë informative në klasë si mjet mësimor                                                                                                  |    |

|                                                                                                                                 |     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| (përparësi dhe mangësi) .....                                                                                                   | 54  |
| 3.5 Roli dhe sfidat e arsimtarëve dhe nxënësve në zbatimin e paradigmes bashkëkohore të mësimdhënies.....                       | 56  |
| <br>Kapitulli 4: Hulumtimi dhe analiza e të dhënave nga hulumtimi .....                                                         | 60  |
| 4.1. Rezultatet nga hulumtimi: paraqitja grafike e rezultateve nga hulumtimi, interpretimi i pyetësorëve dhe intervistave ..... | 60  |
| 4.2. Përfundimi nga analiza e të dhënave .....                                                                                  | 119 |
| Kufizimet .....                                                                                                                 | 122 |
| Përfundimi .....                                                                                                                | 122 |
| Rekomandimet .....                                                                                                              | 127 |
| Bibliografia .....                                                                                                              | 129 |
| Shtojcat .....                                                                                                                  | 135 |

## **Përmbledhje**

Teza e magjistraturës me temë ‘‘Menaxhimi i paradigmave të mësimdhënies bashkëkohore mbështetur në teknologjinë e komunikimit në arsimin fillor në komunën e Tetovës’’ trajton dy çështje shumë të rëndësishme dhe shumë të ndërlidhura mes veti, menaxhimin e arsimit, gjegjësisht, menaxhimin e segmentit më të rëndësishëm të arsimit, atë të mësimdhënies dhe nxënies në shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më saktësisht, në dy shkolla fillore, ‘‘Bratstvo-Migjeni’’ dhe ‘‘ Kiril dhe Metodi’’ në Komunën e Tetovës, si dhe metodologjinë e mësimdhënies, më saktë mësimdhënien bashkëkohore të mbështetur në teknologji. Sa i përket të parës, pra menaxhimit të mësimdhënies dhe nxënies në shkollat fillore, këtu do të fokusohemi tek roli i drejtorit në shkollat fillore në sigurimin e infrastrukturës teknologjike në shkollë për të siguruar mësimdhënie dhe nxënie cilësore, si dhe të përgaditjes së arsimtarëve në procesin e menaxhimit të paradigmave mësimore, nga ajo tradicionale në atë bashkëkohore të mbështetur në teknologji. Po ashtu, ky punim do të tentojë të nxjerrë në pah edhe sfidat me të cilat ballafaqohen drejtorët e shkollave në komunën e Tetovës për sa i përket projektit të menaxhimit të këtyre paradigmave. Ndërsa, sa i përket çështjes së dytë, pra aspektit metodologjiko-didaktik do të fokusohemi tek zbatimi i mësimdhënies bashkëkohore të mbështetur në teknologji si dhe në efikasitetin e metodave bashkëkohore mësimore të mbështetura në teknologji në arsimin fillor. Ky punim poashtu do të tentojë të nxjerrë në pah edhe sfidat me të cilat drejtorët e shkollave të komunës së Tetovës ballafaqohen gjatë menaxhimit të këtyre paradigmave. Do të tentojmë të nxjerrim në pah edhe perceptcionet e më shumë palëve të interesit, këshillat e shkollave, këshillat e prindërve, drejtorët, specialistët e teknologjisë informative në shkollat fillore, arsimtarët dhe nxënësit për sa i përket zbatimit të mësimdhënies bashkëkohore të mbështetur në teknologji në shkollat fillore të cilat janë subjekt analize dhe hulumtimi i kësaj teze të magjistraturës. Më tej, do të analizojmë mënyrën se sa dhe si arsimtarët e këtyre shkollave përdorin teknologjinë në mësimdhënie. Po ashtu, edhe do të hulumtojmë nivelin e përgaditjes së arsimtarëve për të përdorur teknologjinë në klasë si dhe përfshirjen e tyre eventuale në trajnime dhe përgaditje profesionale që të përdorin teknologjinë në mësimdhënie në mënyrë më efikase. Më tutje, do të hulumtojmë ndikimin e teknologjisë në efikasitetin e mësimdhënies dhe nxënies në procesin edukativo arsimor në shkollat fillore. Pra, kjo tezë magjistrature trajton çështjen e ndikimit që drejtorët e shkollave kanë në cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në shkollat fillore, si dhe ndikimin e drejtpërdrejtë që ka paradigma bashkëkohore e mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë në cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në arsimin fillor. Përveç kësaj, kjo tezë do të bëjë përpjekje të nxjerrë në pah gjendjen dhe sfidat aktuale me të cilat ballafaqohen shkollat për sa i përket përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie në shkollat fillore. Me qëllim të arritjes së rezultateve përbajtësore që do mbështesin hipotezat e kësaj teze të magjistraturës, kemi përdorur metoda të ndryshme të hulumtimit si metoda analitike, komparative, studim rasti dhe anketën, si dhe instrumentet e hulumtimit si: intervista dhe

pyetësorët, etj. Të gjitha këto metoda do të na ndihmojnë në nxjerrjen e përfundimeve cilësore që do të na mundësojnë të japim edhe ndonjë rekomandim për përmirësim si në aspektin menaxherial ashtu edhe në atë metodologjiko-didaktik. Për sa i përket madhësisë së mostrës që do trajtojmë në 2 shkollat ato do të jetë si në vijim: 2 drejtorë, 2 specialistë të teknologjisë informative në 2 shkollat, 2 anëtarë të këshillit të shkollave, 2 anëtarë të këshillit të prindërve, 41 arsimtarë, dhe 158 nxënës.

#### Fjalët kyçe

*Menaxhimi i arsimit, drejtori , mësimdhënia, paradigmat ,metodat inovative,teknologjia e iformacionit ,të nxënit*

## Предговор

Магистерскиот труд: “Управување со современи наставни парадигми засновани на комуникациска технологија во основното образование во општина Тетово” се осврнува на две многу важни и меѓусебно поврзани прашања, управувањето со образованието, имено, управување со најважниот сегмент на образованието, наставата и учењето во основните училишта на Република Северна Македонија, поточно, во две основни училишта, „Братство–Миѓени” и “Кирил и Методиј” во Општина Тетово, како и методологијата на наставата, поточно современата настава базирана на технологија. Што се однесува до првото, односно управувањето со наставата и учењето во основните училишта, овде ќе се фокусираме на улогата на директорот во основните училишта во обезбедување на технолошка инфраструктура во училиштето за обезбедување квалитетна настава и учење, како и во подготвувањето на наставниците во процесот на управување на наставните парадигми, од традиционалната во современата настава засновано на технологија. Додека, во врска со втората работа, т.е. методолошко-дидактички аспект, ќе се фокусираме на имплементација на современа настава заснована на технологија и ефикасност на современите наставни методи засновани на технологија во основните училишта. Овој труд исто така ќе се обиде да ги потенцира предизвиците со кои се соочуваат директорите на училиштата во општина Тетово во однос на управувањето на овие парадигми. Исто така, ќе се обидеме да ги истакнеме перцепциите на многу засегнати страни, училишниот одбор, советот на родители, директори, специјалисти за информатичка технологија во основните училишта, наставници и студенти во врска со примената на современата технологија базирана на настава во основните училишта. предмет на анализа и истражување на оваа магистерска теза. Понатаму, ќе анализираме како и колку наставниците од овие училишта користат технологија во наставата. Ние, исто така, ќе го истражime нивото на подготовка на наставниците за употреба на технолози во училницата, како и нивната евентуална вклученост во обука и стручна обука за да ја користиме технологијата за поефикасна настава. Понатаму, ќе го истражime влијанието на технологијата врз ефикасноста на наставата и учењето во образовниот процес во основните училишта на општина Тетово. Така, овој магистерски труд се осврнува на прашањето за влијанието што директорите на училиштата го имаат врз квалитетот на наставата и учењето во основните училишта, како и на директното влијание што го имаат современите парадигми на наставата преку технологијата врз квалитетот на наставата и учењето во основното образование. Покрај тоа, оваа теза ќе се обиде да ја истакне моменталната состојба и предизвиците со кои се соочуваат училиштата во однос на користење технологија во наставата во основните училишта. За да постигнеме значајни резултати што ќе ги

подржат хипотезите на оваа магистерска теза, користевме различни методи на истражување како што се аналитички, компаративни, студија на случаи и анкети, како и истражувачки инструменти како интервјуа и прашалници и сл. Сите овие методи ќе ни помогнат да извлечеме квалитативни заклучоци што ќе ни овозможат да дадеме неколку скромни препораки за подобрување и во раководни и во методолошко-дидактички аспект. Во однос на големината на примерокот со кои ќе се занимаваме во 2 училишта ќе биде како што следува: 2 директори, 2 специјалисти за информатичка технологија во 2 училишта, 2 члена на училишни одбори, 2 члена на совети на родители, 41 наставници и 158 студенти.

### **Клучни зборови**

**Управување со образованието, директор, настава, парадигми, иновативни методи, информатичка технологија, учење**

## **Abstract**

Masters Thesis ‘‘Management of contemporary teaching paradigms based on communication technology in primary education in the municipality of Tetovo’’ addresses two very important and interconnected issues, management of education, namely, management of the most important segment of education, teaching and learning in the primary schools in the Republic of North Macedonia, more precisely, in two primary schools, ‘Bratstvo-Migjeni’ and ‘Cyril and Methody’ in the Municipality of Tetova, as well as the teaching methodology, more precisely modern teaching through technology. Regarding the first, that is, the management of teaching and learning in primary schools, here we will focus on the role of the principal in primary schools in providing technological infrastructure in the school to provide quality teaching and learning as well as in preparing teachers in the process of managing learning paradigms from the traditional to the contemporary one based on technology. This paper will also attempt to highlight the challenges that school principals in the municipality of Tetovo are facing with regard to the project of managing these paradigms. Whereas, regarding the second issue, namely the methodological-didactical aspect, namely, the implementation of modern technology-based teaching and the efficiency of modern technology-based teaching methods in primary schools. We will also try to highlight the perceptions of many stakeholders, the school board, parents’ councils, principals, information technology specialists in primary schools, teachers and students regarding the application of modern technology-based teaching in primary schools which are the subject of analysis and research of this master thesis. Further, we will analyze how teachers of these schools use technology in teaching. we will also explore the level of teacher preparation to use technology in the classroom as well as their eventual inclusion in vocational training to use technology in teaching more effectively. Further, we will explore the impact of technology on the efficiency of teaching and learning in the educational process in the primary schools of the municipality of Tetova. Thus, this master's thesis addresses the question of the impact that school principals have on the quality of teaching and learning in elementary schools, as well as the direct impact that the modern technology paradigm of teaching has on the quality of teaching and learning in primary education. In addition, this thesis will attempt to highlight the current situation and challenges that schools face in terms of using technology in teaching in primary schools. In order to achieve meaningful results that will support the hypotheses of this master thesis, we have used various research methods such as analytical, comparative, case study and survey, as well as research instruments such as interviews and questionnaires, etc. All of these methods will help us draw qualitative conclusions that will enable us to make any recommendations for improvement in both managerial and methodological-didactic terms. Regarding the sample size, we will be dealing with 2 schools where we will try to collect the data from: 2



principals, 2 information technology specialists in 2 schools, 2 school board members, 2 parents' council members, 41 teachers, and 158 students.

**Key words**

**Education management, principal, teaching, paradigms, innovative methods, information technology, learning**

## HYRJE

### Lënda e hulumtimit

Lëndë e kësaj teze të magjistraturës është menaxhimi i paradigmave të mësimdhënies në arsimin fillor, në veçanti prej klasës së 6 deri në klasën e 9, prej asaj tradicionale në atë bashkëkohore të bazuar në teknologji. Përveç kësaj, lëndë tjetër e kësaj teze të magjistraturës është edhe menaxhimi i këtij tranzicioni apo procesi, respektivisht roli i drejtorit të shkollave fillore në menaxhimin e kësaj dukurie shumë me rëndësi për arsimin fillor.

Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë është bërë nevojë e kohës bashkëkohore dhe praktikat e mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë kërkojnë një qasje krejt tjetër nga ajo tradicionale. Prandaj, për tu përshtatur me këtë praktikë të re të mësimdhënies duhet të ridefinohet edhe roli i mësimdhënësve në shkollat fillore si dhe të ridefinohen edhe praktikat edukativo arsimore duke inkorporuar teknologjinë në mësimdhënie dhe nxënie. “Për të realizuar ndryshime në klasa, në mënyrë që teknologjia të përdoret vërtet çdo ditë si një pajisje për mendim krijues dhe kërkimor, kërkon punë të konsiderueshme në ndryshimin e qasjeve mësimore, vlerësimet dhe strategjitë e menaxhimit "(Wiburg, 1997).

Përdorimi i teknologjisë është bërë një pjesë e rëndësishme e procesit të të mësuarit si brenda ashtu edhe jashtë klase. Është bërë rutinë që në çdo klasë të çdo shkolle në një mënyrë apo tjetër të përdoret teknologjia informative. Teknologjia informative po përdoret me qëllim të përmirësimit të mësimdhënies dhe nxënies, gjegjësisht përshtatjes së mësimdhënies dhe nxënies për nxënës të gjeneratës së re, që ndryshe njihet si gjenerata Z, që përdorimin e teknologjisë e kanë përditshmëri dhe teknologjia është bërë pjesë e jetës së tyre të përditshme. Nga ana tjetër, teknologjia u mundëson arimtarëve të përshtasin aktivitetet në klasë që të jenë më të kapshme, më motivuese dhe më tërheqëse për nxënësit. Rëndësia e teknologjisë informative akoma po rritet pasi zhvillimi teknologjik nuk ka të ndalur.

Teknologjia si pajisje ndihmëse në procesin edukativo arsimor ka historikun e saj. Qysh në kohërat antike procesi edukativo arsimor ka qenë objekt studimi i shumë filozofëve dhe shkencëtarëve. Fokusi i tyre ka qenë gjithmonë gjetja e metodologjive dhe pajisjeve të ndryshme që do të përdornin në procesin edukativo arsimor për të mundësuar përcjelljen më efikase të dijes nga mësimdhënësi tek nxënësi.

Në vijim, do të nxjerrim në pah disa fakte historike që do të mbështesin tezën se njeriu gjatë procesit të evoluimit dhe përsosjes së tij gjithmonë ka tentuar të zbulojë pajisje që do ndihmonin në ngritjen e cilësisë së arsimit në përgjithësi, pasi arsimin e kanë konsideruar si shtyllë kryesore të zhvillimit të shoqërisë në tërësi. “Për shembull, hieroglifet egjiptiane kombinuan simbole logografike dhe alfabetike në papirus dhe dru. U zbuluan qysh në vitin 3400 para Krishtit. Hieroglifet treguan se kishte pasur një sistem arsimimi qysh në lashtësi. Më tutje, Herodoti për herë të parë shkroi për Abakusin në vitin 480 para erës sonë. Egjiptianët e lashtë gjithashtu e përdorën atë si një mekanizëm për llogaritje dhe për tregti. Abakusi

më i hershëm i mbijetuar, Tabela Salamis, daton nga viti 300 para Krishtit dhe u përdor nga Grekët. Abakusi me të cilin jemi njohur më së shumti është ‘suan-panja’ kineze, e cila u dokumentua për herë të parë në vitin 190 pas Krishtit, një pajisje që secili mund ta konsideronte si të saktë dhe të besueshme. E sa i përket pajisjeve më të avancuara, si për shembull, disa kompjutorë analogë janë ndërtuar në kohërat e lashta për të kryer llogaritjet astronomike. Këto përfshinin mekanizmin Antikythera dhe Astrolabe. Të dy këta konsideroheshin përgjithësisht si kompjutorë analogë/ mekanik të njohur qysh më herët. Këto pajisje kontribuan në edukimin e shoqërisë dhe të vendosjes së bazës së njohurive të Grekëve të vjetër në Greqinë e Lashtë. Dhe ata nuk prisheshin fare dhe kurrë nuk kishin nevojë për azhurnime të softuerëve!”<sup>1</sup>

Më vonë dikundi nga viti 1870 teknologjia përparoi deri në atë nivel që të mund të përfshinte ‘Magic Lantern’, një verzion primitiv i një projektori rrëshqitës që parashikonte imazhe të shtypura në pllaka xhami. Pas Luftës së Parë Botërore sistemi arsimor publik në Cikago të SHBA u pajisën me rreth 8,000 projektorë. Ky zhvillim teknologjik sinjalizoi se nxënësit ishin të uritur për mjete arsimore më të përparuara. Në vitin 1873, Anna Eliot Ticknor themeloi Shoqërinë për të inkurajuar studimet në shtëpi e destinuar për një rrjet të grave që mësojnë gratë e tjera përmes postës elektronike. Në vitin 1875 u krijua një bibliotekë për anëtarët e Shoqërisë, e cila përfundimisht u shërbeu rreth 10,000 anëtarëve deri në vitin 1897.

Në vitin 1977 u lëshua Apple II dhe paraqiti ‘Visicalc’ (dokumente elektronike) dhe lojëra edukative si Oregon Trail. Kompania Apple gjithashtu lejoi Bell dhe Hoëell (një furnizues i pajisjeve shkollore) të shpërndanin Apple II në shkolla. Në 1979 u krijua Fondacioni ‘Edukimi Apple’, i cili u dha sisteme të plota Apple II shkollave. Deri në vitin 2009, 97% e klasave në SHBA kishin një ose më shumë kompjutorë, dhe 93% e kompjutorëve në klasë kishin qasje në internet. Për çdo 5 nxënës, kishte një kompjutor. Mësimdhënësit deklaruan që 40% e nxënësve përdornin kompjutorë në metodat e tyre arsimore, përveç tabelave të bardha interaktive dhe kamerave digjitale.<sup>2</sup>

Në vitet e para të shekullit 21 revolucioni shpërthyes teknologjik si interneti dhe teknologjia informative pa tela ka mundësuar rrjete të ndryshme interaktive multimediale të cilat filluan të përdoren për mësimdhënie. Përshtatshmëria e internetit për të nxjerrë materijale të ndryshme për mësimdhënie dhe për të zbatuar ato në procesin edukativo arsimor në shkolla në përmasa kombëtare do të mundësojë menaxhimin e paradigmave të mësimdhënies nga ajo tradicionale në atë bashkëkohore të bazuar në teknologji. (Bates, 2016; Min-Hung-Lin et al, 2017).

Sipas Profesorit Michael Fullan, teknologjia ndihmon në përshpejtimin e nxënies si dhe në përmirësimin e cilësisë së nxënies, por që ajo varet nga mësimdhënësit, gjegjësisht se sa dhe si mësimdhënësit do të shfrytëzojnë resurset teknologjike në klasë. Ai përshkruan ato si "qëllime të thella"

<sup>1</sup> The Evolution of Learning Technologies, [http://www.opencolleges.edu.au/informed/evolution-of-learning-technologies?utm\\_source=informed\\_newsletter&utm\\_medium=email&utm\\_campaign=evolution](http://www.opencolleges.edu.au/informed/evolution-of-learning-technologies?utm_source=informed_newsletter&utm_medium=email&utm_campaign=evolution)

<sup>2</sup> <https://online.purdue.edu/blog/evolution-technology-classroom>

të të mësuarit - të menduarit kritik, komunikimi, krijimtaria, bashkëpunimi, edukimi i karakterit dhe qytetaria - dhe mendon se teknologjia mund të ndihmojë në përshpejtimin e tyre.<sup>3</sup> Po ashtu ai thotë se teknologjia mund të nxisë komunikimin dhe bashkëpunimin në klasa ku arsimtarët janë aktivizues ose agjentë të ndryshimit, dhe studentët janë partnerë në mësim. Sipas tij, një qasje për integrimin e teknologjisë me mësimin është përmes "klasës së rrokullisuar", ku studentët rishikojnë përmbajtjen e videos së mësimin në shtëpi dhe reflektojnë atë përsëri në klasë.<sup>4</sup> Kjo qasje sipas Profesorit Michael Fullan duplikon kohën e të mësuarit.

Globalizimi dhe zhvillimi i teknologjive të reja gjatë shekullit 21 kanë revolucionarizuar metodat e mësimdhënies dhe nxënies dhe për këtë arsye, sistemi arsimor në shekullin e 21 duhet të pësojë një rishikim të plotë.<sup>5</sup>

Pra, nga e gjithë ajo që u përmend më lartë, zhvillimi i hofshëm i teknologjisë dhe ndikimi i tij pozitiv dhe dobidhënës në shumë sfera të jetës imponon nevojën për identifikim dhe përzgjedhje të teknologjisë adekuate dhe inkuadrimit të saj në klasë. Qëllimi i futjes së teknologjisë në procesin edukativo arsimor është përshtatja e mësimdhënies me mënyrën e të mësuarit të nxënësve të shekullit 21, pra Gjeneratës Z. ‘Mësuesit duhet të jenë në gjendje të operojnë në një botë të Gjeneratës Z, referuar gjithashtu si Gjenerata Teknologjike nga Tucker dhe Bari (2010), të cilët përcaktojnë këtë gjeneratë si "teknikisht të gjithanshme dhe të përshtatshme për të komunikuar përmes Internetit. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të përdorin dhe vlerësojnë teknologjinë që përdorin nxënësit e tyre në baza ditore dhe të kuptojnë se si mund të inkuadrojnë atë në kurrikulat shkollare që përfshin njohuritë teknologjike dhe interesin e nxënësve me njohuri teknologjike’ (Keane et al, 2013). Më tej, Keane et al, 2013 potencojnë se në ndryshimin e kontekstit teknologjik, shkollat duhet të përqendrohen në më shumë shkathtësi sesa vetëm ato themelore shkrimit, leximit dhe matematikën të cilat mund të përshkruhen si mësim sipërfaqësor dhe të zhvillojnë një qasje të personalizuar të të mësuarit në kontekstin e aftësive të shekullit 21 - të mësuarit e thellë - në mënyrë që të përgatisin nxënësit për të ardhmen. Ngjashëm edhe Silva (2008) pohon se, "integrimi i aftësive të shekullit XXI në mësimdhënie nuk është vetëm një domosdoshmëri ekonomike por një aspekt thelbësor i përmirësimit të mësimin" (Silva, 2008).

Në kontekst të kësaj që u tha më sipër qeveritë e shumë shteteve të përparuara kanë investuar kryesisht në kërkimin dhe zhvillimin e platformave dixhitale të mësimin. Janë prodhuar softuerë dhe harduerë për shumë platforma dixhitale të mësimdhënies si dhe janë prodhuar materiale të ndryshme mësimore dixhitale. Shkollat kanë prezantuar në mënyrë aktive platforma të veçanta mësimore dixhitale në rregulloret e shkollës dhe kanë synuar rezultate më të mira të të nxënit në shkollë (Pai & Tu, 2011: Min-Hung-Lin et al, 2017).

<sup>3</sup> <http://www.educationalleaders.govt.nz/Leading-change/Future-schools-and-innovation/Technology-the-new-pedagogy-and-flipped-teaching>

<sup>4</sup> ibid

<sup>5</sup> The importance of digital skills, <https://www.crissh2020.eu/importance-digitalcompetence-21st-century/>, March 7<sup>th</sup>, 2018,

Kjo tezë magjistrature, pra, shqyrton edhe mënyrën se si drejtorët e shkollave fillore drejtojnë dhe udhëheqin planprogramet shkollore të fokusuara nga e ardhmja siç është metodologjia moderne apo bashkëkohore e mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë. Po ashtu, do të shqyrtojmë edhe çështjen e mbështetjes që drejtorët ua sigurojnë mësimdhënësve në zbatimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie sepse hulumtimet kanë nxjerrë në pah që shumë mësimdhënës nuk ndihen të përgatitur për të integruar teknologjinë në udhëzimet e tyre në klasë (Charp, 2003). Smith dhe Robinson (2003) zbuluan se për shkak të mungesës së aftësive teknike, mësimdhënësit acarohen shpejt. Ata shumë shpesh nuk ndjehen rehat kur përdorin teknologji gjatë procesit të mësimdhënies dhe nuk janë të vetëdijshëm se sa mund teknologjia dhe interneti atyre tu ndihmojë në punën e tyre të përditshme (Mouza, 2002/2003) (Crane, 2005).

Rezultatet e hulumtimit mbi përdorimin e teknologjisë në shkollat fillore kanë treguar gjithashtu se arsimtarët duhet të jenë të mbështetur nga drejtorët në zbatimin e paradigms së re të mësimdhënies të bazuar në teknologji dhe duhet të jenë mjaft fleksibil për tu përshtatur dhe të integrojnë udhëzimet e bazuara në teknologji. Në këtë kontekst, Doersch (2002) pohon se mësuesit janë të gatshëm të provojnë gjëra të reja nëse e dinë se do të kenë ndihmë dhe mbështetje nga udhëheqësit e shkollës (Doersch, 2002). Në këtë drejtim, drejtori i shkollës duhet të mundësojë, gjegjësisht sigurojë një rrjedhë të qëndrueshme të shembujve të përdorimit të teknologjisë dhe inovacionit në shkollën që ai drejton.

Sipas Gupta (2016) derisa teknologjitë e reja janë në rritje, shkollat duhet të parashikojnë dhe të përgatiten për ndryshimet në paradigmat e mësimdhënies bazuar në këto teknologji dhe në integrimin e tyre në çdo lëndë mësimore. Drejtorët mund të shkëmbejnë informacione me shkollat e tjera dhe të marrin shembull nga shkollat me praktika më të mira të përdorimit apo integritit të teknologjisë në mësim si dhe për praktikatat më të mira të menaxhimit të shkollës. Mësimdhënia përmes teknologjisë mund të jetë një sukses i madh nëse liderët e mbështesin atë aktivisht dhe përfshihen në të, si dhe të sigurojë zhvillim profesional të përshtatshëm për stafin në procesin e vazhdueshëm të ndryshimit (Gupta, 2016).

Sipas Caroline Salermo, drejtorët e shkollave fillore mund të inkurajojnë arsimtarët për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie në më tepër mënyra edhe atë duke mbështetur arsimtarët të trajnohen për përdorim sa më efikas të teknologjisë në mësim, të përdoret emaili si mjet për komunikim me të punësuarit dhe me prindërit e nxënësve, planet mësimore të dërgohen me email, të insistojnë që arsimtarët të krijojnë faqe në internet klasë (e-klasë), pra të mund të ligjerojnë online nëpërmjet ‘google meet’ pajisjes elektronike apo pajisjeve tjera që mundësojnë mësim online si dhe të marrin pjesë në konferenca të ndryshme për të ndarë përvoja me shkolla tjera të cilët përdorin teknologjinë në mësimdhënie si dhe për të mësuar se çfarë bëjnë drejtorët e shkollave tjera për të inkurajuar përdorimin e teknologjisë në shkollat dhe klasat e tyre (Starr, 2009).

‘I vetmi person i cili është përgjegjës për të siguruar zbatimin efektiv të teknologjisë në mësim në shkollë është drejtori’ (Sergiovanni, 2009: Dunham, 2012). Drejtori i shkollës është katalizatori kryesor në zbatimin e pajisjeve teknologjike që përdoren në mësim në mjediset shkollore (Qendra Kombëtare e Statistikave të Arsimit, 2010: Dunham, 2012).

Edhe në Maqedoninë e Veriut politikëbërësit për një kohë të gjatë debatojnë dhe diskutojnë për ndryshimet që duhet të ndodhin në arsim, por deri tani ato ishin arbitrare dhe pa asnjë mbështetje të themi reale dhe të mbështetur në shkencë. Të gjitha këto debate synonin ndryshimin e gjendjes në arsim në përgjithësi, e cila akoma konsiderohet si arsim tradicional. Periudha e gjatë e tranzicionit në Maqedoninë e Veriut afër dy dekadave, krijoi hapësirë që arsimi të konsiderohet si ‘Sistem arsimor tradicional’ dhe si pasojë mundë të mos u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të kohës në të cilën ne tani jetojmë (Zajazi, T., 1997).

Sipas Profesorit Michael Fullan, është politika shtetërore ajo e cila duhet vënë në funksion ndryshimet pozitive në arsim dhe ato politika paraqesin thelbin e patjetërsueshëm të tejkalimit të gjendjes tradicionale në arsim. Më tej ai shton se atje ku politikat e një shteti vihen përballë mëdyshjes për të bërë ndryshime në sistemet arsimore, nuk pritet që të ndodhin ndryshime thelbësore në arsim siç janë për shembull zhvendosja e paradigmave metodologjike nga ajo tradicionale në atë moderne të bazuar në teknologji, ndryshimet thelbësore në kurikulare dhe e infrastrukturës arsimore në kuptimin më të gjerë (Fullan, 2002).

Politikakanët kanë vënë veten përballë hamendjes se si të bëjnë ndryshime apo reforma në shkallë më të gjerë, si edhe në të njëjtën kohë të realizojnë reforma dhe ndryshime më të thella (Fullan, 2016). Me fjalë të tjera në kontekst të kësaj teze mund të thuhet se ‘infrastruktura teknologjike në arsim’ si një paradigmë e re ka shumë rëndësi për të gjitha ndryshimet që politika shtetërore dëshiron t’i bëjë në arsim.

Nëse dëshirojmë të bëjmë reforma thelbësore në përmasa më të gjera dhe më të thella atëherë rolin kryesor do të duhet ta luajnë qeveritë e shteteve, pasi vetëm ato kanë potencialin e duhur për të bërë ndryshime madhore (Fullan, 2016).

Gjatë periudhës së gjatë të tranzicionit në Maqedoninë e Veriut, i cili tranzicion me të gjitha gjasat akoma është duke ndodhur, u bënë ca hulumtime dhe analiza të situatës në arsim. Sipas Zajazit (2003) këto analiza të bëra nga një komision të ekspertëve shtetëror kishin për qëllim hartimin e politikave reformuese të sistemit arsimor në Maqedoninë e Veriut (Fullan, 2016). Më tej ai potencon se ky hulumtim i detajuar që doli nga skenimi i gjendjes së arsimit në vendin tonë nxorri në pah ca të meta dhe defekte: arsim i centralizuar, përgjegjësi jo mirë të definuara, mjedis shkollor jo i papërshtatshëm, mësimdhënie tradicionale ku metoda faktografike dominon gjatë procesit edukativo arsimor, mjete financiare jo të mjaftueshme, mësimdhënës të pa motivuar, e tjera (Zajazi, 2003).

Prandaj, Zajazi (2003) propozon ndërhyrje me qëllim të sajimit të sistemit arsimor edhe atë në këto sfera: ndryshimi i kurikulumeve, ndryshimi i paradigmave të metodologjive të mësimdhënies dhe nxënies nga ajo tradicionale në atë moderne dhe të bazuar në teknologji, transformim të fakulteteve pedagogjike etj.

Në këtë drejtim, Qeveria e Maqedonisë ka ndërmarrë hapa konkrete për të përmirësuar gjendjen në arsimin fillor. Por, megjithatë, ngel shumë për t'u bërë dhe po ashtu lëvizjet duhet dinamizuar me qëllim të arritjes së qëllimit përfundimtar e ai është arsim me standarde evropiane.

Ndryshimi themelor që duhet të ndodhë në vitet që vijnë është bartja nga një mësimdhënie tradicionale në atë bashkëkohore të bazuar në teknologji, pra ndryshim të paradigmave të mësimdhënies nga ato tradicionale joteknologjike në atë të bazuar në teknologji.

Ndryshimet e mëturjeshme në sistemin arsimor në Maqedoninë e Veriut duhet të bëhen në krijimin e standardeve, ndërtimin e kapaciteteve dhe sigurimin e cilësisë. Sigurimi i cilësisë bëhet me sigurimin e mësimdhënësve të kualifikuar dhe profesionistëve të vërtetë. Mandej sigurimin e drejtuesve të kualifikuar, të cilët do të dinë të menaxhojnë punën e mësimdhënësve dhe ta vënë dijen e tyre në shërbim të atyre që duan të mësojnë dhe të furnizohen me kompetenca të duhura për të kryer punë të ndryshme si private ashtu edhe publike.

Ajo që nevojitet tani është një proces me dy faza, që fillon me llogaridhënien, si fazë e parë dhe shton ndërtimin e kapaciteteve, në fazën e dytë. Kriteri për arritjen e suksesit janë reformat në shkallë të gjerë që sjell ndryshime të thella.

Në këtë kontekst, është për tu përshëndetur hapi shumë guximtar, pra Dekreti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në këtë kohë kur pandemia e virusit korona ka kapluar edhe vendin tonë për të zhvendosur përnjëherë mësimdhënien nga ajo në klasa fizike në klasa virtuale, pra online apo e-klasa. (Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RVM, Dekreti i Qeverisë Teknike të RMV, i datës 23. 03. 2020).<sup>6</sup> Dekreti u soll në mbledhjen e Qeverisë së RMV. 'Kjo seancë miratoi edhe një Dekret me forcën e ligjit për zbatimin e Ligjit për arsimin fillor për realizimin dhe organizimin e mësimdhënies në shkollat fillore dhe për vlerësimin e nxënësve gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Sipas parashikimeve të këtij dekreti, mësimi në shkollat fillore organizohet me anë të mësimit në distancë, d.m.th. mësimi nga shtëpia, me anë të komunikimit elektronik. Edhe pse shkollat tona fillore akoma nuk janë të përgaditura për kësaj transformimi thelbesor ato do të duhet të ndërmarrin masa drastike për të menaxhuar paradigmat nga ajo tradicionale në ato bashkëkohore të bazuar në teknologji që të mund të vazhdojë dhe përfundojë procesi edukativo arsimor në shkollat fillore në Maqedoninë e Veriut.'"<sup>7</sup>

---

<sup>6</sup> <https://vlada.mk/covid19#ministries>

<sup>7</sup> ibid

Kjo situatë e pa prituri u përshtat me lëndën e kësaj teze të magjistraturës rastësisht dhe kjo temë e përzgjedhur u tregua që në start si temë e qëlluar për hulumtim sepse mendojmë se rezultatet nga kjo teze e magjistraturës do gjejnë zbatim në më tepër sektorë të arsimit dhe sado pak do japë kontribut në përpjekjet e shkollave fillore për të menaxhuar paradigmat e mësimdhënies nga ajo tradicionale në ato bashkëkohore të bazuar në teknologji.

Sidoqoftë, lënda kryesore e kësaj teze të magjistraturës është përdorimi i teknologjisë në klasat fizike shkollore me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira të të mësuarit të nxënësve në shkollat fillore. Pra, fokusi do të jetë në përshtatjen e infrastrukturës teknologjike për mësimdhënie bashkëkohore nëpërmjet teknologjisë në shkollat fillore të komunës së Tetovës nga ana e drejtorëve të shkollave që do mundësonin menaxhimin e paradigmes bashkëkohore të mësimdhënies. Kërcimi në mësimdhënie në distancë apo në e-klasa tash për tash e konsiderojmë si lloj mësimi shumë futuristik dhe se kjo paradigmë e stërvancuar është rëndë për ta zbatuar në shkollat fillore jo vetëm tek ne në Republikën e Maqedonisë së Veriut por edhe me gjerë në rajon apo edhe në botë. Arsyet janë të shumta, por përshkak se kjo temë nuk është lëndë e kësaj teze të magjistraturës ne nuk do e trajtojmë atë. Por, për shkak të situatës së krijuar me përhapjen e virusit korona këto masa janë të domosdoshme dhe shumë pozitive në veçanti kur bëhet fjalë për vazhdimin e procesit edukativo arsimor deri në përmbyllje të vitit shkollor 2019/ 2020.



## **2. Qëllimet e hulumtimit -**

Qëllimi kryesor i kësaj teze të magjistraturës është të nxjerrë në pah rëndësinë që ka sot teknologjia në përmirësimin e procesit edukativo arsimor, gjegjësisht përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies në arsimin fillor. Qëllim tjetër i kësaj teze është edhe nxjerrja në pah e rolit të drejtorëve të shkollave fillore në përshtatjen e mësimdhënies dhe nxënies sipas nevojës së kohës, gjegjësisht sipas dijeve dhe shkathtësive të nxënësve të shekullit 21 të njohur edhe si Gjenerata Z (Zet). Më tutje, qëllimi i kësaj teze është edhe studimi i perceptimit të arsimtarëve dhe nxënësve në lidhje me rolin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor si dhe veprimet e drejtorit në drejtim të sigurimit të teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Po ashtu qëllimi i kësaj teze magjistrature është të hulumtoje dhe të nxjerrë në pah veprimet e shkollave fillore në drejtim të sigurimit të infrastrukturën teknologjike, respektivisht të nxjerrë në pah prokurimet e deritanishme për të siguruar lloje të ndryshme teknologjisë që aktualisht përdoren në shkollat fillore të Tetovës dhe pikëpamjet e drejtorëve dhe arsimtarëve për sa i përket paradigmes bashkëkohore të zbatimit të metodologjisë mësimore bazuar në teknologji.

## **3. Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit**

Tematika që trajtohet në këtë tezë të magjistraturës tërheq më tepër pyetje hulumtuese, por ne do të fokusohemi në gjetjen e përgjigjeve të pyetjeve në vijim:

1. Cili është roli i drejtorit në menaxhimin e paradigmave të mësimdhënies tradicionale në atë bashkëkohore të mbështetur nga teknologjia informative? Si e menaxhon drejtori çështjen e zhvillimit profesional të arsimtarëve sa i përket përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie?
2. Si menaxhon drejtori çështjen e menaxhimit të infrastrukturës teknologjike në shkollën fillore, gjegjësisht resurseve teknologjike?
3. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohen si drejtuesit e shkollave fillore po ashtu edhe mësimdhënësit gjatë procesit të menaxhimit të paradigmave të mësimdhënies, respektivisht gjatë zbatimit të paradigmes bashkëkohore të mësimdhënies dhe nxënies të bazuar në teknologjinë e sotme të komunikimit në klasë?
4. Cilat pajisje teknologjike posedon secila shkollë e përfshirë në këtë hulumtim dhe cilat pajisje më tepër përdoren nga arsimtarët? Sa shpesh përdoret dhe si përdoret teknologjia nga ana e arsimtarëve në shkollat fillore?
5. Cilat janë metodat më efikase (më të përdorura) të mësimdhënies të mbështetur nga teknologjia në shkollat e hulumtuara?

6. Cili është perceptimi i palëve të interesit në shkollat fillore për sa i përket ndikimit të teknologjisë në procesin edukativo arsimor në përgjithësi, dhe në rezultatet e të mësuarit në veçanti?

Si rezultat i pyetjeve të mësipërme hulumtuese ne vendosëm edhe hipotezat e këtij punimi si në vijim:

**Hipotezat:**

**Hipoteza e përgjithshme:**

Menaxhimi i mirë i zhvendosjes së paradigmeve të mësimdhënies nga ajo tradicionale në atë të mbështetur nga teknologjia e sotme e teknologjisë informative ndikon dukshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies në shkollat fillore.

**Hipoteza kryesore:**

Përdorimi i metodave bashkëkohore mësimore të bazuara në teknologji siguron mësimdhënie dhe nxënie më cilësore.

**Hipoteza ndihmëse:**

Përdorimi efikas i teknologjisë në procesin edukativo arsimor siguron mësimdhënie dhe nxënie më cilësore.

**4. Metodologjia e hulumtimit**

Tema e parashtruar në këtë tezë magjistrature ka një rëndësi të madhe për më tepër palë të interesit pasi trajton praktikën më të mira si menaxheriale po ashtu edhe ato metodologjiko-didaktike. Në veçanti ka të bëjë me qasjen që kanë menaxhmentet e shkollave ndaj fenomenit të zhvendosjes së metodologjisë tradicionale në atë bashkëkohore të mbështetur me teknologji të sotme të komunikimit. Pra, qëllimi i këtij punimi është shqyrtimi i situatës në disa shkolla fillore të Tetovës dhe nxjerrja e të dhënave nga palë të ndryshme të interesit në shkollat fillore dhe më pas dhënia e ndonjë rekomandimi për përmirësimin e procesit edukativo arsimor në shkollat që do përfshihen në këtë hulumtim. Duke patur parasysh rëndësinë e çështjes që do trajtohet në këtë punim do të mundohemi ta trajtojmë më vëmendje të madhe. Prandaj, do të përzgjedhim metoda të hulumtimit me anë të së cilave do bëjmë përpjekje që të nxjerrim në pah situatën aktuale në shkollat fillore “Bratstvo-Migjeni” dhe “Kiril dhe Metodi” që gjinden në komunën e Tetovës dhe do të nxjerrim përfundime që do të mundësojnë rekomandime, të cilat shpresojmë që do të japin një kontribut modest në përmirësimin e gjendjes në shkollat fillore për sa i përket pajisjes së tyre me

teknologji bashkëkohore si dhe përgaditjes së arsimtarëve për të përdorur atë në procesin edukativo arsimor.

Kështu që, gjatë procesit të hulumtimit do të përdorim metodat hulumtuese si në vijim:

### **Metoda analitike**

Metoda analitike do të na mundësojë që të analizojmë situatën aktuale në shkollat që do të jenë objekt i këtij hulumtimi. Po ashtu, do të analizojmë të dhënat që do t'i mbledhim në këto shkolla nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave. Do të analizojmë edhe nivelin e angazhimit të menaxhmenteve të shkollave në furnizimin e klasave me teknologji si dhe përgaditjen e arsimtarëve për të përdorur teknologjinë në mënyrë sa më efikase me qëllim të arritjeve të objektivave/ qëllimeve të shkollave. Pra, do të analizojmë veprimet e ndërmarra të drejtorëve të shkollave në drejtim të menaxhimit të paradigmave arsimore nga ajo tradicionale në atë bashkëkohore të bazuar në teknologji. Më tej, do të analizojmë edhe efikasitetin e metodave moderne të bazuara në teknologji në procesin edukativo arsimor dhe në rezultatet e të mësuarit.

### **Metoda statistikore**

Metoda statistikore do të na ndihmojë në krijimin e një baze të të dhënave të cilën do ta përdorim për ta analizuar situatën aktuale në të dy shkollat në komunën e Tetovës. Po ashtu, do të nxjerrim në pah të dhënat me anë të tabelave dhe grafikoneve që do t'i vendosim në brendi të kësaj teze të magjistraturës.

### **Metoda komparative**

Metoda komparative do të na ndihmojë për të krahasuar dy shkollat, të cilat janë objekt hulumtimi në këtë tezë magjistrature, si dhe të bëjmë një krahasim me praktikën më të mira të cilat do t'i gjejmë gjatë hulumtimit teorik. Më pas, do të krahasojmë edhe dallimet në mes dy shkollave që do të hulumtojmë, sa i përket praktikave më të mira në drejtim të menaxhimit të paradigmave të mësimdhënies tradicionale në atë bashkëkohore të bazuar në teknologji.

### **Anketa dhe intervista**

Do të mundohemi të anketojmë me anë të intervistave dhe pyetësorëve disa palë të interesit siç janë drejtorët, anëtarët e këshillit të shkollave, arsimtarët, specialistët e teknologjisë informative në shkolla, anëtarët e këshillit të prindërve, si dhe nxënësit. Po ashtu, do të mundohemi të bëjmë ca intervista me drejtorët dhe specialistët e teknologjisë informative të shkollave që janë objekt i këtij hulumtimi.

### **Studim rasti**

Si studim rasti do të përdorim 2 shkolla fillore në komunën e Tetovës edhe atë "Brastvo-Migjeni" dhe "Kiril dhe Metodi" Do ta analizojmë gjendjen aktuale sa i përket teknologjisë informative në klasë (pra

do të analizojmë se si janë të furnizuara klasat me teknologji informative si dhe cfare teknologjie përdoret në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në këto shkolla. Po ashtu, do të analizojmë mënyrën e komunikimit në shkollat fillore si dhe mënyrat e komunikimit të shkollave me palët tjera të interesit). Po ashtu, do trajtojmë edhe praktikën më të mira që drejtorët e këtyre shkollave përdorin në drejtim të sigurimit të infrastrukturës teknologjike në klasë për të siguruar zhvendosjen e metodologjisë tradicionale me atë bashkëkohore të mbështetur me teknologji. Supozojmë se studim rasti i 2 shkollave në rajonin e Tetovës do të na mundësojë të nxjerrim përfundime cilësore si dhe rekomandime në drejtim të përmirësimit të gjendjes në të dy shkollat për sa i përket futjes dhe përdorimit të teknologjisë në klasa për të përmirësuar cilësinë e nxënies në shkollat fillore të Maqedonisë së Veriut.

## **5. Rëndësia e tezës së magjistraturës**

Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin se do të bëhet përpjekje të nxjerren në pah praktikën më të mira të menaxhimit të shkollave fillore, në veçanti për sa i përket menaxhimit të paradigmave të mësimdhënies nga ato tradicionale (jo-teknologjike) në ato bashkëkohore të bazuara në teknologji. Pastaj, do të tentojmë të nxjerrim në pah edhe perceptimet e palëve të ndryshme të interesit si drejtorët, anëtarë të këshillave të shkollave, anëtarë të këshillave të prindërve, arsimtarë dhe nxënës për sa i përket ndikimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollat fillore si dhe në rezultatet e të mësuarit. Kjo do të na ndihmojë të krijojmë një pasqyrë më të mirë për atë se në çfarë mase shkollat fillore pajisin klasat e tyre me teknologji dhe si e përdorin atë në drejtim të sigurimit të mësimdhënies më cilësore.

## Kapitulli 1 - Definimi i koncepteve dhe paradigmave arsimore

### 1.1 Definimi i menaxhimit të arsimit

Për ta kuptuar më mirë sintagmën ‘menaxhim të arsimit’ dhe më pas për të definuar atë në mënyrë të duhur, ne do të duhet së pari të ndajmë këtë sintagmë në dy pjesët (fjalët) e saja përbërëse dhe të definojmë ato fjalë veç e veç.

Do të fillojmë nga fjala menaxhim e cila origjinën e saj e ka në lashtësi. Më saktë, kjo fjalë etimologjinë e saj e ka nga gjuha latine edhe atë nga dy fjalët e gjuhës latine ‘manus’ që në përkthim do të thotë ‘dorë’ dhe ‘gere’ që do të thotë (veprim).<sup>8</sup>

Më tej, sa i përket definimit të ‘menaxhimit’ si term shkencor dhe si veprimtari shkencorë menaxhimi është një shkencë e gjallë, pragmatike dhe me zhvillim të shpejtë. Menaxhimi është i nevojshëm për të renditur dhe organizuar burimet njerëzore, materijale dhe financiare dhe për t’i bërë ato burime të dobishme dhe efektive për të arritur qëllimet e organizatës apo institucionit (Newman dhe Clarke 1994: 29 ; Bush, 2009).

Menaxhimi është përcaktuar dhe përkufizuar nga shkencëtarë dhe autorë të shumtë në mënyra të ndryshme. Disa e quajnë atë një proces, të tjerët koordinim të burimeve, disa e quajnë atë organ të personelit të sfiduar në detyrën e menaxhimit, ndërsa të tjerët e quajnë atë si një disiplinë e organizuar e veçantë. Disa nga përkufizimet e zakonshme të menaxhimit janë dhënë më poshtë:

Sipas Harold Koontz<sup>9</sup> dhe Heinz Weihrich<sup>10</sup>, ‘Menaxhimi’ është procesi i hartimit dhe mirëmbajtjes së një mjedisi në të cilin individët, duke punuar së bashku në grupe, realizojnë me efikasitet qëllimet e zgjedhura. Ndërsa, sipas Robert L. Trewelly<sup>11</sup> dhe M. Gene Newport<sup>12</sup>, menaxhimi përkufizohet si procesi i planifikimit, organizimit, veprimit dhe kontrollit të operacioneve të një organizate në mënyrë që të arrihet koordinimi i burimeve njerëzore dhe materiale thelbësore në arritjen efektive të objektivave. Më

---

<sup>8</sup> <https://en.wikipedia.org/wiki/Management#Etymology>

<sup>9</sup> Harold D. (Howdy) Koontz (19 maj 1909 - 11 shkurt 1984) ishte një teoricien organizativ amerikan, profesor i menaxhimit të biznesit në Universitetin e Kalifornisë, Los Angeles dhe konsulent për shumë nga organizatat më të mëdha të biznesit të Amerikës. Koontz bashkëautor i librit Parimet e Menaxhimit me Cyril J. O'Donnell; libri është shitur në rreth dy milion kopje dhe është përkthyer në 15 gjuhë.

<sup>10</sup> Heinz Weihrich është një autor, konsulent menaxhimi dhe profesor i Menaxhimit Global dhe Shkencës së Sjelljes në Universitetin e San Francisko

<sup>11</sup> Autor i librit ‘Menaxhimi, funksionet dhe sjellja’

<sup>12</sup> Autor i librit ‘Menaxhimi mbikëqyrës, mjetet dhe teknikat’, 1976

tutje, Robert Kreitner<sup>13</sup> definojnë menaxhimin si ‘procesi i të punuarit me dhe përmes të tjerëve për të arritur në mënyrë efektive objektivat organizative duke përdorur në mënyrë efikase burime të kufizuara në mjedisin në ndryshim’.

Duke u mbështetur në ato përkufizime të dhëna më sipër mund të konstatojmë se ‘menaxhimi përkufizohet si një proces i kryerjes së punëve nëpërmjet të tjerëve me qëllim të arritjes së qëllimeve të institucioneve në mënyrë efektive’. Si rrjedhojë dalin edhe disa fjalë me rëndësi për të shqyrtuar siç janë: procesi, efektiviteti dhe eficientia. ‘Procesi’ nënkupton funksionet parësore ose aktivitetet që menaxhimi kryen për t’i bërë gjërat. Këto funksione janë planifikimi, organizimi, burimet njerëzore, drejtimi dhe kontrolli. Efektiviteti ka të bëjë me rezultatin përfundimtar. Në thelb nënkupton përfundimin e detyrës së dhënë. Kështu, ‘Efektiviteti’ në menaxhim ka të bëjë me bërjen e detyrës së duhur, përfundimin e aktiviteteve dhe arritjen e qëllimeve. ‘Eficientia’ nënkupton bërjen e detyrës në mënyrë korrekte dhe me kosto minimale. Menaxhimi ka të bëjë me përdorimin efikas të burimeve hyrëse të cilat në fund të fundit ulin kostot dhe çojnë në fitime më të larta. Është e rëndësishme që menaxhimi i institucionit të arrijë qëllimet (efektivitet) me burime minimale d.m.th., sa më eficientë të jetë e mundur duke ruajtur një ekuilibër midis efektivitetit dhe eficientes.<sup>14</sup> Eficientia mat raportin mes të ardhurave dhe të prodhimit dhe përfshin prodhime të dobishme të shtuara (shërbime) nga niveli i përcaktuar i të ardhurave, ose zmadhimin e sasisë së mjeteve financiare të shpenzuara për krijimin e prodhimeve të përcaktuara.

Ndërsa, sa i përket koncepteve menaxheriale sipas George R. Terry në thelb ekzistojnë 5 koncepte të menaxhimit<sup>15</sup>:

1. Koncepti funksional - Menaxhimi në thelb është detyrë e planifikimit, koordinimit, motivimit dhe kontrollit të përpjekjeve të të tjerëve drejt qëllimeve dhe objektivave të organizatës. Sipas këtij koncepti, menaxhimi është ajo që bën një menaxher (planifikimi, ekzekutimi dhe kontrolli)
2. Koncepti i marrëdhënieve ndërnjerëzore - Sipas këtij koncepti, Menaxhimi është arti i bërjes së gjërave përmes dhe me njerëzit në grupe të organizuara. Po ashtu, menaxhimi është edhe art i krijimit të një mjedisi në të cilin njerëzit mund të performojnë dhe individët mund të bashkëpunojnë për arritjen e qëllimeve të grupit.
3. Koncepti i udhëheqjes dhe vendimmarrjes - Sipas këtij koncepti, menaxhimi është art dhe shkencë e përgatitjes, organizimit, drejtimit të përpjekjeve njerëzore të përdorura për kontrollin e forcave dhe përdorimin e materialeve të natyrës për përfitimet e njeriut.
4. Koncept prodhues - Sipas këtij koncepti, menaxhimi mund të përkufizohet si arti i sigurimit të prosperitetit maksimal me një përpjekje minimale në mënyrë që të sigurojë prosperitet dhe

<sup>13</sup> Autor i librit ‘Parimet e Menaxhimit’, 2008

<sup>14</sup> <https://www.papertyari.com/general-awareness/management/concept-management/>

<sup>15</sup> <https://tyrocity.com/topic/concept-and-meaning-of-management/>

lumturi maksimale si për punonjësit ashtu edhe për punëdhënësit dhe në këtë mënyrë të sigurojë shërbimet më të mira.

5. Koncepti i integritimit - Sipas këtij koncepti, menaxhimi është koordinimi i burimeve njerëzore dhe materiale drejt arritjes së objektivave organizative, si dhe organizimit të funksioneve prodhuese thelbësore për arritjen e qëllimeve ekonomike/ financiare.

Këto përkufizime të mësipërme të menaxhimit janë gjeneruar duke shqyrtuar definicione të ndryshme nga autorë dhe dijetarë të ndryshëm të menaxhimit. Praktikisht, pesë konceptet e menaxhimit janë zhvilluar nga dijetarë të ndryshëm duke theksuar aspektet e ndryshme të menaxhimit. Sidoqoftë, menaxhimi duhet të jetë term gjithpërfshirës, gjegjësisht të përfshijë më tepër aspekte për të kuptuar esencën e tij. Por, duhet të potencojmë faktin se shumica e definicioneve që ne përmendëm më sipër si dhe qindra definicione tjera që mund të gjinden në literaturë që trajtojnë menaxhimin, në masë të madhe thelbin e tyre e kanë tek teorite klasike të menaxhimit, ne veçanti ato bazohen tek studimet e tre studiuesve klasik të menaxhimit, Frederick Taylor, Max Weber dhe Henry Fayol.<sup>16</sup>

Në vazhdim ashtu siç paralajmëruam do të definojmë fjalën apo termin "arsim". Ashtu siç bënë me fjalën menaxhim do të kthehemi mbrapa në burimin e fjalës 'arsim' ose në etimologjinë e fjalës 'arsim'. Fjala ose termi 'arsim' ngjashëm me fjalën 'menaxhim' burimin e ka në lashtësi më saktë në fjalët latine "Educare", "Educatum", dhe "e" + "duco"<sup>17</sup>. Fjala 'Educare' nënkupton të rritesh, të ngritesh dhe të ushqehesh, të stërvitesh apo të formohesh. Më tej, fjala 'Educare' nënkupton 'të nxitësh'. Duhet të kemi kujdes me fuqitë e lindura të individit dhe t'i jepet hapësirë individit për t'u zhvilluar. Fëmiju ka fuqitë e lindura por ka nevojë për arsimim të duhur që fëmiju të zhvillohet. Termi "educare" nënkupton zhvillimin e mundësive latente të fëmijës. Fëmiju nuk i di aftësitë e tij. Janë edukatorët ata që mund ta njohin atë dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për ta zhvilluar atë. Përveç këtyre dy termeve, duhet të përmendim edhe termin 'Educatum' – që ka po ashtu një domethënie thelbësore për fjalën arsim. Në këtë kontekst, arsimi merrë kuptimin e diçkaje që imponohet nga jashtë, është rritje e jashtme përmes aktiviteteve dhe përvojës. Mësuesi, përmes arsimit jep udhëzime për të formuar aftësitë e nxënësit/individit. Dhe më në fund arrijme tek termi i fundit që ndërlidhet me arsimin e që janë fjalët 'E + duco', ku 'E' 'do të thotë 'nga' dhe 'duco' 'do të thotë' të udhëheqësh'. Fëmiju ka trashëguar potenciale. Ato i ka të lindura. Duhet të zhvillohet, por si dhe nga kush? Kjo është e mundur përmes arsimimit dhe bashkëpunimit aktiv të mësuesit.<sup>18</sup>

<sup>16</sup>

[https://wikieducator.org/Qualification\\_Framework/Professional\\_Education/Management/MHRM/Principles\\_of\\_Management/Management\\_Theories/Classical\\_Management\\_School](https://wikieducator.org/Qualification_Framework/Professional_Education/Management/MHRM/Principles_of_Management/Management_Theories/Classical_Management_School)

<sup>17</sup> <https://www.quora.com/What-is-the-etymological-meaning-of-education>

<sup>18</sup> Ibid

Nga kuptimi i mësipërm derivativ, zbulohet se arsimi është i nevojshëm për një shoqëri përparimtare dhe synohet të sjellë prosperitet të përgjithshëm te individit duke shpalosur potencialet e tij.<sup>19</sup>

Përveç përkufizimeve të mësipërme, në literaturë mund të hasim edhe përkufizime të tjera për arsimin. Në vazhdim do të citojmë definicionin e arsimit që gjetëm në wikipedia si në vijim 'Arsimi është proces i përvetësimit të njohurive, aftësive, vlerave, besimeve dhe zakoneve. Metodën arsimore përfshijnë mësimdhënien, trajnimin, ligjërimin, diskutimin dhe hulumtimin e drejtuar. Arsimi shpesh bëhet nën drejtimin e arsimtarëve, megjithatë nxënësit gjithashtu mund të arsimohen vetë (vetëarsimohen)'.<sup>20</sup>

Në fjalorin elektronik të gjuhës së sotme shqipe, termi "arsim" përkufizohet si "tërësi e shprehive dhe njohurive që barten tek gjeneratat e reja sipas një kurrikule shkollore për të arsimuar dhe edukuar brezin e ri gjatë një procesi edukativo arsimor; sistemi shkallë shkallë me anë të së cilit barten këto njohuri. Ndërsa, në Fjalorin e pedagogjisë "arsimi" përkufizohet si "sistem i caktuar njohurish dhe shprehish të përgjithësuara në shkencat mbi natyrën, shoqërinë dhe mendimin njerëzor, të cilat barten tek brezi i ri në mënyrë të planifikuar dhe të programuar në institucionet arsimore (shkolla, kurse, etj.); sistem shkallë shkallë me anë të së cilit barten dija, shkathtësitë dhe shprehitë".<sup>21</sup>

Duke patur parasysh misionin e arsimit në përgjithësi, politikat shtetërore të arsimit në vazhdimësi synojnë të zhvillojnë dhe përmirësojnë jetën e qytetarëve në më tepër aspekte edhe atë në aspekt social, ekonomik dhe kulturor duke u përqëndruar në zhvillimin e burimeve njerëzore përmes arsimit. Prandaj, arsimi duhet të ketë kurikula më të rëndësishme, të jetë dinamik dhe t'i fuqizojë nxënësit të sjellin ndryshime të dëshirueshme shoqërore duke ruajtur aspektet e dëshirueshme të ekzistencës shoqërore.

Më tutje, sipas Bush et al (2001) arsimi definohet si një ndërmarrje komplekse dhe si e tillë ka nevoja specifike të cilat kërkojnë qasje të dalluar apo specifike dhe për këtë ka disa argumente që mbështesin nocionet si në vijim (Bush, et al, 2001):

1. Vendosja dhe matja e objektivave arsimore;
2. Prezenca e fëmijëve apo nxënësve si 'output' ose ndryshe të njohur edhe si 'klientë' të institucioneve arsimore;
3. Autonomia më e madhe në klasë të profesionistëve arsimor;
4. Drejtorët në shkollat fillore kanë shumë pak kohë për t'i kushtuar aspektit menaxherial të punës së tyre.

Si pasojë e gjithë asaj që u përmend më lartë, për sa i përket definimit të menaxhimit dhe arsimit, mund të konkludojmë që përderisa arsimi siguron një sërë përvojash mësimore për individët apo nxënësit në mënyrë që të marrin njohuri, vlera, qëndrime dhe aftësi me qëllimin përfundimtar për t'i bërë ata

---

<sup>19</sup> Ibid

<sup>20</sup> <https://sq.wikipedia.org/wiki/Arsimi>

<sup>21</sup> Ibid



anëtarë produktiv të shoqërisë, menaxhimi i arsimit është procesi i planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollit të veprimtarive të një institucioni arsimor duke shfrytëzuar burimet njerëzore dhe materiale në mënyrë që të përmbushë funksionet e mësimdhënies dhe kërkimit në mënyrë më efektive (Bush, et al, 2001).

Pra, për sa i përket përkufizimit të menaxhimit të arsimit mund të gjejmë akoma më tepër përkufizime edhe atë nga dijetarë të njohur siç janë Tony Bush, Ray Bolam, Peter Ribbins e të tjerë. Në vazhdim do të cekim ca përkufizime që ta kemi më qartë se çfarë është menaxhimi i arsimit dhe cili është objektivi i tij.

Menaxhimi i arsimit si fushë e studimit dhe praktikës rrjedh nga parimet e menaxhimit të zbatuara më herët në industri dhe tregti, kryesisht në Shtetet e Bashkuara në pjesën e hershme të shekullit XX. Më vonë kjo shkencë u transferua edhe në Evropë në veçanti në Mbretërinë e Bashkuar edhe atë në vitet 1960ta. Menaxhimi i arsimit, siç nënkupton emri, vepron në organizata arsimore ose institucione arsimore. Teoritë e huazuara dhe më pas të zbatuara në arsim, që ndihmuan menaxhimin e arsimit të del në pah si një shkencë e re e cila merret me arsimin dhe dukuritë në arsim, përfshinin kryesisht modele industriale që përshtateshin në mjediset arsimore. Më vonë teoricientët dhe dijetarët e arsimit arritën që të zhvillojnë modele të pavarura të cilat i nxjerrnin apostafat për fushën e arsimit. Këto modele zbuloheshin gjatë hulumtimeve dhe vëzhgimeve që këta teoricientë arsimor bënë në institucione arsimore. Deri në shekullin XXI teoritë kryesore, ose ishin zhvilluar në kontekst arsimor ose ishte përshtatur nga modelet industriale për të përmbushur specifikën arsimore ose më saktë të përmbushin kërkesat e shkollave dhe kolegjeve.

Menaxhimi arsimor ka përparuar nga të qenit një fushë e re e varur nga idetë e zhvilluara në mjedise të tjera deri në atë shkallë kur arrin të qëndrojë si shkencë e pavarur e themeluar me teoritë dhe hulumtimet e veta (Bush et al, 2001). Bile ka edhe dijetarë të tillë që në start përjashtojnë mundësinë e zbatimit të modeleve të menaxhimit të marra nga biznesi apo industria ose së paku pa i shqyrtuar ato me kujdes të veçantë se si funksionojnë ato apo a funksionojnë fare ato modele në mjedisin unik akademik për shkak të specifikave të vecanta të arsimit. Prandaj, sipas Baldridge et al, 1978:9; Bush, 2011) duhet të kemi kujdes të madh gjatë përpjekjeve tona për të menaxhuar dhe përmirësuar arsimin me teknika moderne të menaxhimit të huazuara nga biznesi edhe pse ndonjëherë këto teknika do të kishin gjetur zbatim, por duhet kujdes i veçantë gjatë përshtatjes së tyre në institucionet arsimore (Bush, 2011).

Në vazhdim do të japim edhe disa përkufizime nga disa dijetarë të menaxhimit të arsimit duke filluar nga Ray Bolam (1999:194; Bush, 2009) i cili përcakton menaxhimin e arsimit si ‘një funksion ekzekutiv për kryerjen e politikës së rënë dakord’. Ai diferencon menaxhimin e arsimit nga udhëheqja e arsimit e cila ka në thelb përgjegjësinë e saj për formulimin e politikave dhe, aty ku është e përshtatshme, transformimin organizativ të institucionit arsimor”(f. 194). Më tej, Glatter (1979: 16; Bush, 2009)

argumenton se studimet e menaxhimit të arsimit kanë të bëjnë me 'funksionimin e brendshëm të institucioneve arsimore, dhe gjithashtu me marrëdhëniet e tyre me mjedisin e tyre, domethënë, komunitetet në të cilat janë vendosur, dhe me organet drejtuese të të cilave ata janë zyrtarisht përgjegjës'. Me fjalë tjera, menaxherët në institucionet arsimore duhet të bashkëveprojnë me ambientin e brendshëm dhe atë të jashtëm gjatë udhëheqjes së institucioneve të tyre arsimore. Sipas Bush (2003) menaxhimi i arsimit duhet të jetë i interesuar në mënyrë qendrore për qëllimin ose qëllimet e arsimit. Këto qëllime ofrojnë sensin thelbësor të drejtimit, i cili duhet të mbështesë menaxhimin e institucioneve arsimore. Menaxhimi drejtohet në arritjen e objektivave të caktuara arsimore. Nëse kjo lidhje midis qëllimit dhe menaxhimit nuk është e qartë dhe e afërt, ekziston rreziku i 'menaxherializmit', 'theksi vendoset tek procedurat në kurriz të arsimit, qëllimit dhe vlerave të tij' (Bush 1999: 240; Bush, 2003). Kjo mund të shkaktojë dëm në mbarëvajtjen e punës edukativo arsimore në institucionet arsimore, pasi që bëhet një defokusim nga ana e menaxherëve arsimor duke dashur që të vendoset një kontroll më i ashpër tek procedurat administrative. Kjo gjë mund t'u merrë shumë kohë mësimdhënësve dhe kjo mund të rezultojë në defokusim të mësimdhënësve nga objektivat arsimore dhe sigurimit të cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.

Sipas Bush et al (2001) menaxhimi i arsimit përqendrohet në studimin e teorive të shkencës së menaxhimit të cilat përcaktojnë dhe përshkruajnë rolet dhe përgjegjësitë e udhëheqësve apo menaxherëve arsimor dhe zhvillimin e aftësive të tyre menaxheriale.

Nga ana tjetër, Peter Ribbins në Bush et al (2001) thekson që menaxhimi i arsimit synon të arrijë objektivat e një institucioni arsimor, përmirësimin e proceseve të planifikimit, organizimit dhe zbatimit brenda institucionit arsimor, krijimin, forcimin dhe ruajtjen e një imazhi pozitiv publik të institucionit arsimor, shfrytëzimin optimal të burimeve njerëzore (administratorë, staf jo mësimdhënës, staf mësimor dhe nxënës/ studentë), përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të infrastrukturës, krijimin dhe ruajtjen e një atmosfere kohezive, menaxhimin e konflikteve ndërnjerëzore, përmirësimin e komunikimit ndërnjerëzor, ndërtimin e marrëdhënieve të mira me komunitetin e tjera. Sipas Tony Bush procesi i përcaktimit të objektivave të institucioneve arsimore është në zemër të menaxhimit të arsimit. Në disa institucione arsimore apo shkolla dhe kolegje qëllimet përcaktohen nga drejtori i shkollës në bashkëpunim me anëtarë tjerë të këshillit drejtues të shkollës ose në bashkëpunim me një grup të vogël të palëve të interesit. Në përgjithësi përcaktimi i objektivave të shkollave bëhet nga organe formale dhe grupe joformale (Bush et al, 2001).

Udhëheqja dhe menaxhimi shpesh konsiderohen si aktivitete praktike të cilat nuk kanë fare mbështetje në teori, përkundrazi janë praktika të cilat ndihmojnë në krijimin e teorive të menaxhimit të arsimit. Përcaktimi i vizionit, artikulimi i qëllimeve, ndarja e burimeve dhe vlerësimi i efikasitetit të gjitha këto përfshin në vete veprim. Shpesh ata që praktikojnë veprime menaxheriale tentojnë të injorojnë teoritë

dhe konceptet që sipas tyre janë larg realitetit të situatës në shkollë dhe që ato nuk kanë të bëjnë me veprimet e duhura për të zgjidhur situata të ndryshme në shkollë (Bush, 2009). Pra, nga kjo mund të konstatohet që shkollat janë hapësira sui generis dhe se këto kërkojnë trajtim sui generis.

Në këtë kontekst, pas shqyrtimit të literaturës, mund të konstatojmë se nuk ekziston një teori e vetme e udhëheqjes dhe menaxhimit të arsimit nga fakti se ekzistojnë institucione të ndryshme apo të llojllojshme arsimore nisur nga ato shkolla rurale e deri tek universitetet e mëdha që veprojnë në kushte dhe rrethana të ndryshme. Shumica e teorive të udhëheqjes dhe menaxhimit të arsimit posedojnë tre karakteristika kryesore (Bush, 2009): 1) Teoritë janë normative në kuptimin që ato reflektojnë besimet rreth natyrës së institucioneve arsimore dhe sjellja e individëve në brendi të tyre; 2) Teoritë pretendojnë të jenë selektive ose të pjesërishe në kuptimin që ato potencojnë disa aspekte të institucionit arsimor në kurriz të elementeve tjera. Mbështetja në një teori çon në mospërfilljen e teorisë tjetër. Shkollat janë sisteme shumë komplekse që të munden të trajtohen apo analizohen nga një këndvështrim i vetëm; 3) Teoritë e udhëheqjes dhe menaxhimit të arsimit shpeshherë janë të bazuara në vëzhgimin e praktikave në institucionet arsimore, gjegjësisht teoritë e ndryshme që trajtojnë udhëheqjen dhe menaxhimin e arsimit dalin dhe zhvillohen gjatë hulumtimeve empirike në shkolla.

Nga e gjithë ajo që u përmend më sipër mund të konstatojmë se menaxhimi i arsimit është fushë studimi dhe praktikë që merret me veprimin e institucioneve arsimore. Sic edhe pamë më sipër ka më tepër përkufizime për menaxhimin e arsimit dhe nuk ka asnjë përkufizim të vetëm që mund të jetë i pranueshëm në përgjithësi. Kjo është kështu në vecanti pasi zhvillimi i kësaj shkence bazohet në masë të madhe në disa disiplina shkencore mirë të etabluara sic janë sociologjia, shkencat politike, ekonomija dhe menaxhmenti i përgjithshëm (Bush, 2011).

## **1.2 Definimi i udhëheqjes së mësimdhënies**

Në këtë nënkapitull do të trajtojmë udhëheqjen e mësimdhënies si dukuri e re që bën dallimin në fushën shkencore të menaxhimit dhe udhëheqjes së arsimit. Që në fillim do të nisim me një citim të një nga dijetarëve më të njohur të fushës së Menaxhimit dhe udhëheqjes së arsimit Tony Bush i cili thotë: ‘Udhëheqja e mësimdhënies është një nga konstruksionet më të qëndrueshme në tipologjinë ndryshuese të modeleve të udhëheqjes’ (Bush 2011, Bush dhe Glover 2014: Bush, 2015).

Në fakt, udhëheqja e mësimdhënies si koncept u shfaq në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në bazë të gjetjeve nga hulumtimet e bëra në institucione arsimore ku u mat ndikimi i drejtorit në rezultatet e mësimin të nxënësve dhe u konkludua që udhëheqja e mirë e institucioneve arsimore mund të ketë ndikim pozitiv në rezultatet e të mësuarit të nxënësve (Bush, 2015). Në fakt, kjo ka të bëjë me organizimin e procesit të mësimdhënies në shkollë nga ana e drejtorit, gjegjësisht nga ana e udhëheqësit të institucionit arsimor.

Në vazhdim, do të trajtojmë këtë dukuri duke shqyrtuar punime shkencore të më tepër dijetarëve dhe autorëve që kanë trajtuar këtë dukuri në fushën e Menaxhimit të arsimit dhe udhëheqjes. Për shembull, një përmbledhje e literaturës nga Hallinger dhe Heck (1996a, 1996b, 1999) në Hallinger (2005) nxjerrë në pah se udhëheqja e mësimdhënies ishte modeli më i studiuar i udhëheqjes së arsimit apo të institucioneve arsimore, më saktë shkollave për njëzet e pesë vite me rradhë që nga vitet e 80ta (Hallinger, 2005). Sipas Hallinger (2005) gjatë këtyre viteve hulumtimi mbi udhëheqjen e mësimdhënies ka qenë në fokus të dijetarëve të shumtë të mënximit të mësimdhënies dhe ky studim ka përfshirë më tepër dijetarë dhe ka qenë me përmasa globale. Në këtë hulumtim janë përfshirë studiues të ndryshëm nga Amerika e Veriut, Evropa, dhe Azia, të cilët kanë dhënë kontribut të cmueshëm në këtë fushë shkencore (shih Hallinger & Heck, 1996a; 1996b; Heck & Hallinger, 1999; Hallinger, 2005).

Nga studimet e bëra nga ana e Sheppard (1996) u konkludua se udhëheqjen e mësimdhënies duhet vështuar nga dy këndvështrime. Këndvështrimi i parë, që ai e emërton si të ngushtë, ka të bëjë me përcaktimin e udhëheqjes së mësimdhënies si veprim që lidhet drejtpërdrejt me mësimdhënien dhe të mësuarit ose nxënien. Ndërsa, këndvështrimi i dytë, i emërtuar nga ana e tij si këndvështrimi i gjerë, ka të bëjë me udhëheqjen e mësimdhënies që përfshin të gjitha aktivitetet që ndikojnë në të mësuarit e nxënësve (Sheppard 1996, f.326; Hallinger, 2010). Duke u bazuar në pikëpamjet e Sheppard (1996) dhe duke i shqyrtuar ato në mënyrë kritike Southworth (2002, f.78; Bush & Glover, 2003:11) thotë se "udhëheqja e mësimdhënies ka gjasa të jetë më efektive kur është e konceptuar si "e gjerë" dhe jo "e ngushtë" "sepse rrit hapësirën për udhëheqësit e tjerë për të luajtur një rol kryesor sepse udhëheqësi ka njohuri mbi funksionimin e institucioneve publike. Më tej ai shton se "udhëheqja e mësimdhënies është fuqimisht e interesuar për mësimdhënie dhe nxënie, përfshirë zhvillimin profesional të mësuesve si dhe arritjen e rezultateve më të mira të mësimi nga ana e nxënësve".

Në të njëjtin drejtim shkon edhe pikëpamja e Geltner dhe Shelton (1991, f.339; Bush & Glover, 2003:11) duke pretenduar se "udhëheqja efektive e mësimdhënies karakterizohet nga një perspektivë strategjike që çon në lidhje të integruar dhe vendosje të të gjitha burimeve në dispozicion të shkollës për të arritur qëllimin dhe misionin e saj".

Nga ana tjetër Hill (2001) thotë se "udhëheqësit e shkollave mund të mos kenë njohuri të mjaftueshme për mësimdhënien dhe të mësuarit për të siguruar një udhëheqje adekuate, e lëre më të suksesshme" (Bush&Glover, 2003).

Pavarësisht këtyre komenteve, Bush dhe Glover (2003) konkludojnë se udhëheqja e mësimdhënies është një dimension shumë i rëndësishëm, sepse ai shënjestron aktivitetet qendrore të shkollës, mësimdhënien dhe të mësuarit (NCSL 2001b; Bush&Glover, 2003).

Sipas Hallinger dhe Murphy (1985; Bush & Glover, 2003) udhëheqja e mësimdhënies plotëson tre kategori të gjera: 1. përcaktimin e misionit të shkollës, 2) menaxhimin e programit mësimor, dhe 3) promovimin e klimës në shkollë.

Më tutje, në vitin 1980, Hallinger (1992: 37; Bush, 2015) vuri në dukje se udhëheqësi i mësimdhënies paraqiste burimin kryesor të njohurive për zhvillimin e programit arsimor të shkollës'. Ai sugjeroi një përqendrim më të fortë në mësimdhënie sesa në të mësuarit, prandaj edhe kritikët argumentuan se si mësimdhënia ashtu dhe nxënia, duhet të kenë një rëndësi të barabartë (Bush, 2015).

Udhëheqja e mësimdhënies si koncept u shfaq në vitet 1980 dhe u ndikua nga hulumtimet që kanë të bëjnë me shkollat efektive, me drejtorët që promovonin mësimin e studentëve, gjegjësisht që krijonin një lidhje mes efikasitetit të drejtorëve me rezultatet e mira të nxënies (Jenkins, 2009; Parsons & Beauchamp, 2012). Më tej, Wasicsko (2007) potencoi që kjo lidhje të funksionojë duhet që drejtori të posedojë cilësi njerëzore dhe disponim të kombinuara me njohuritë dhe aftësitë e tyre që do mundeshin të transformojnë mësuesit dhe me këtë jeta e nxënësve në shkollë dhe krijimi i një kulture shkollore ku qëllimi do ishte mësimi dhe rritja e të gjithë aktorëve në shkollë (Parsons & Beauchamp, 2012).

Sic mund të shihet nga ajo që përmendëm më lartë, studimet e menaxhimit dhe udhëheqjes së arsimit janë ridrejtuar nga menaxhimi administrativ drejt udhëheqjes së mësimdhënies, dhe e gjithë kjo në zhvendosje të përqendrimit nga mësimdhënia tek të nxënit. Strain (2009; Parsons & Beauchamp, 2012) rishikoi konceptin e udhëheqjes duke përdorur një koncept gjuhësor i njohur si "kthesë" (një ndryshim i papritur i gjendjes shpirtërore). Si përfundim mund të themi se menaxhimi i mësimdhënies ose më saktë udhëheqja e mësimdhënies, që në këtë rast i referohet udhëheqësit të institucionit arsimor ose drejtorit, shpesh herë e përshkruar si 'udhëheqje me nxënësin në qendër të vëmendjes' nuk ka ngjashmëri apo lidhje me asnjë nga modelet e menaxhimit pasi fokusohet drejtëpërdrejtë në ndikim për të siguruar mësimdhënie dhe nxënie cilësore e jo në procesin e ndikimit.

### **1.3 Definimi i mësimdhënies tradicionale kundrejt mësimdhënies bashkëkohore të mbështetur në teknologji si koncept dhe paradigmë e re e arsimit të shekullit 21**

Siç përmendëm në fillim të këtij punimi mësimdhënia ka qenë temë diskutimi dhe trajtimi edhe në kohërat e lashta. Mirëpo, me kohë mësimdhënia ka pësuar ndryshime në veçanti në aspektin metodologjik.

Kur flasim për metodologjinë e mësimdhënies ajo përfshin metodologjinë tradicionale dhe atë që në kohën më të re e quajmë metodologji moderne. Në këtë drejtim, Brooks & Brooks (1999) thekson se metoda tradicionale nxjerrë në pah aftësitë themelore, ndërsa metoda moderne nxjerrë në pah idetë e mëdha.

‘Mësimdhënia në thelb të tij është një profesion moral. Gërvishteni një mësues të mirë dhe aty do gjeni një qëllim moral’ (Stiegelbauer 1992: Fullan, 1993). ‘Qëllimi moral dhe mësuesit si agjent të ndryshimit, në shikim të parë, duket se janë çuditërisht të lidhur ngushtë njëri me tjetrin. Nëse i shikojmë nga më afër ata janë aleatë natyrorë’ (Fullan 1993).

Thënë më drejtpërdrejt, qëllimi moral - ose bërja e ndryshimit – ka të bëjë me sjelljen e përmirësuar, gjegjësisht bëhet fjalë për ndryshim. Përveç nevojës për ta bërë qëllimin moral më të qartë, arsimtarët kanë nevojë të kenë mjete për tu përfshirë në ndryshime në mënyrë produktive. Qëllimi moral i mban pranë mësuesit për nevojat e fëmijëve dhe të rinjve; qëllimi për ndryshim bën që ata të zhvillojnë strategji më të mira për përmbushjen e qëllimeve të tyre morale (Fullan, 1993).

Mësuesit profesionist, për të qenë efektiv dhe për të përmbushur misionin e tyre fisnik, duhet të bëhen nxënës gjatë gjithë karrierës së tyre si mësimdhënës dhe të mësojnë se si të përdorin teknologji më të sofistikuar në punën e tyre të përditshme dhe të jenë në gjendje të formojnë dhe reformojnë bashkëpunime të frytshme me kolegë, prindër, komunitet, biznese dhe të tjerë. Mësuesit e së ardhmes, me fjalë të tjera, duhet të jenë në të njëjtën kohë në shtëpi, në klasë dhe në punën me të tjerët për të të sjellë përmirësime të vazhdueshme (Fullan, 1993).

Se çfarë ndryshimi kërkohet nga shkollat e tanishme më së miri e elaboron Bill Gates<sup>22</sup>. Ai thotë se shkollat e SHBAve janë të vjetruara. Sipas Gates (2005) duke qenë shkollat e vjetra në kuptimin metodologjik, pra me metodologji tradicionale të mësimdhënies, nuk mund t’i mësojnë fëmijët atë që duhet të dinë sot. Të nxjerrësh fuqi punëtore të së ardhmës në shkollën e sotme është si të përpiqesh të mësosh fëmijët për kompjutorët e sotëm në një skemë 50-vjeçare në të ardhmen (Gates, 2005).

Kjo thënie e Gates (2005) përkon me thënien e një filozofi amerikan, psikolog dhe reformator arsimor,

Deëy (1859-1952) i cili kishte thënë "Nëse i mësojmë nxënësit e tanishëm, pra të sotit ashtu sic i mësuam ata të djeshmit ne do të pengojmë zhvillimin e tyre, gjegjësisht do t’i lëmë ata të prapambetur” (Randall, 1953: f. 9; Kivunja, 2015).

Duke u nisur nga këto kritika të përmendura më sipër dhe shumë kritika të tjera nga njerëz me ndikim në SHBA shumë organizata dhe kompani magnate sic janë Apple Computer Inc., Korporata Microsoft, Departamenti i Edukimit në SHBA, Korporata Dell Computer, Shoqata e Drejtorëve Shtetëror të Teknologjisë Arsimore, Shoqata Ndërkombëtare për Teknologjinë në Arsim dhe Shoqata Kombëtare e Arsimit u bashkuan që të bëjnë përpjekje për të identifikuar se si hendeuku midis njohurive dhe aftësitë e mësuara në shkollë dhe njohuritë dhe aftësitë në kërkesë në shoqërinë tipike të shekullit 21 mund të përshtaten (Kivunja, 2014b: f. 40).

---

<sup>22</sup> Bill Gates – bashkthemelues i Microsoft

Kjo përpjekje e përbashkët u emërtua si 'Partneriteti për Aftësitë e Shekullit 21,' misioni i të cilit ishte të shërbejë si katalizator për ndërtim të partneritetit apo bashkëpunimit mes arsimit, biznesit, komunitetit dhe udhëheqësve të qeverisë. Kryesuesi i këtij Partneriteti duke artikuluar misionin e tij tha se qëllimi i tyre kryesor ishte të përgjigjen një pyetje me rëndësi parësore për arsimtarët e Amerikës, punëdhënësit, prindërit dhe publikun që ishte se si mund t'i përgatisnin më së miri nxënësit për të pasur sukses në shekullin 21. Kivunja (2014) e quan lëvizjen në këto aftësi zhvendosje në "paradigmën e re të të mësuarit", të cilën ai e përcakton si: Qasja e re filozofike ndaj pedagogjisë, e cila kërkon që arsimi të përmbushë vërtet "qëllimin moral dhe të jep ndihmë në drejtim të prodhimit të qytetarëve që mund të jetojnë dhe punojnë në mënyrë produktive në shoqëritë gjithnjë e më komplekse dhe dinamike si dhe të rrethuar nga teknologjia informative "(Fullan, 2000: f. 4: Kivunja, 2014b: f. 40). Sipas Fullan (2000) të mësuarit, mësimdhënia, vlerësimi dhe kurrikulat duhet të pajisin të diplomuarit me aftësi që do t'u mundësojnë atyre të kontribuojnë në mënyrë efektive të kapacitetet prodhuese të ekonomisë së shekullit XXI. Ai argumenton se paradigma e re e të mësuarit është "vizioni për suksesin e nxënësve në ekonominë e re globale" (Kivunja, 2014b: f. 40).

## **Kapitulli 2 - Menaxhimi i paradigmes së re të mësimdhënies dhe nxënies në arsimin fillor**

### **2.1 Praktikë më të mira të menaxhimit të shkollave fillore në drejtim të menaxhimit të paradigmes së re të mësimdhënies**

Teknologjia gjithnjë e më shumë po gjen përdorim në çdo sferë të jetës e në veçanti në arsim. Në kohën e fundit jemi dëshmitar që për shkak të epidemisë Korona teknologjia po bën mrekulli pasi po ndihmon në mbarëvajtjen e procesit mësimor edhe përkundër faktit se procesi edukativ arsimor në shkolla është ndërprerë plotësisht. I gjithë procesi edukativ arsimor është bartur nëpër shtëpi dhe si arsimtarët dhe po ashtu edhe nxënësit po adaptohen në përdorimin sa më të madh të teknologjisë për të kryer obligimet arsimore. Kjo tregon se teknologjia më është bërë pjesë e jetës sonë dhe se pa të ne as nuk mundemi të paramendojmë jetën.

Në vazhdim do të sjellim pikëpamje të ndryshme të autorëve dhe dijetarëve të ndryshëm që në bazë të studimeve të tyre nëpër shkolla kanë ardhur deri në përfundime shkencore që theksojnë rëndësinë që ka teknologjia, në veçanti ajo e avancuar për arsimin në tërësi.

Sipas Shraim & Khalif (2010) teknologjitë e informacionit dhe komunikimit padyshim që sjellin ndryshime të rëndësishme në të gjitha aktivitetet njerëzore dhe gjithashtu në sistemin arsimor' (Shraim & Khlaif, 2010). Sipas tyre kohët e fundit, një paradigmë e re e procesit të mësimdhënies dhe të mësuarit ka dalë si rezultat i zhvillimit teknologjik. Ata pohojnë se besohet gjerësisht se nëse teknologjia informative përdoret në mësim ashtu siç duhet do të fuqizojë të gjithë nxënësit që të arrijnë rezultate më të mira në të nxëniet dhe me këtë të jenë qytetarë të denjë të shekullit XXI (Shraim & Khlaif, 2010).

Ndërsa sipas UNESCO (2004) ritmi i shpejtë i zhvillimeve teknologjike dhe ekonomike ka ngritur kërkesa më të mëdha tek sistemet arsimore. Nevoja thelbësore për nxënësit është që të përqendrohen në rëndësinë e jetës së të mësuarit, domethënë, të azhurnojnë vazhdimisht njohuritë dhe aftësitë e tyre, të mendojnë në mënyrë kritike dhe të frymëzojnë krijimtarinë dhe inovacionin në mënyrë që të përshtaten me ndryshimet globale' (UNESCO, 2004).

Në një linjë është edhe Groff (2013) e cila thotë se zhvillimi teknologjik zgjeron hapësirën e të mësuarit, mësimin e bën më të mirë përmes krijimit të një mjedisi të ri arsimor të dixhitalizuar (Groff, 2013). Groff (2013) në punimin e saj shkencor thekson se bota jonë që po ndryshon shpejtë ka shtruar pyetjen për një kohë të gjatë në arsim, "Si mund që shkollat e sotme të shndërrohen në mjediset e tyre për mësimdhënie dhe nxënie që i bëjnë individët nxënës gjatë gjithë jetës dhe i përgatisin ata për Shekullin 21? Ajo sqaron se si përgjigje ndaj kësaj pyetjeje OECD ka inicuar një projekt të quajtur 'Learning Inovative Environment' dhe ka prodhuar mostra të një grupi të madh të vizioneve të reja për arsim në gjithë botën. Siç mund të imagjinohet, shumë shkolla në përpjekjet e tyre për ta redizajnuar procesin e mësimdhënies dhe nxënies shikimin e tyre e kanë drejtuar nga teknologjia, pra sipas tyre mënyra më e mirë për transformim të mësimdhënies dhe mësimnxënies është integrimi i teknologjisë në procesin edukativo arsimor në shkolla. Teknologjitë e reja dhe ato në zhvillim po provokojnë një rikonceptim të mësimdhënies dhe mësimnxënies, ndërsa gjithashtu shërbejnë si katalizatorë për transformim dhe inovacion. Përgatitja me sukses e të gjithë nxënësve si dhe aftësimi i tyre për shekullin 21 sic janë vetëdija globale, krijimtaria, zgjidhja e problemeve bashkëpunuese, të mësuarit e vetë-drejtuar — nuk është një rend i vogël, dhe shumë udhëheqës arsimor po zbulojnë se format tradicionale të arsimit që kanë evoluar deri në fund të shekullit të kaluar janë thjesht të papërshtatshme për arritjen e këtyre qëllimeve. E gjithë kjo krijon një sfidë dhe mundësi - një hapësirë për të rishqyrtuar, ri-imagjinuar dhe ri-shpikur mjediset e të mësuarit që të jenë në gjendje të përgatisin dhe shkëlqejnë secilin individ apo nxënës për të mësuar në mënyrë më efektive gjatë gjithë jetës (Groff, 2013).

Teknologjia mund të kryejë disa funksione kryesore në procesin e ndryshimit, përfshirë ofrimin e mundësive të reja që përmirësojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien, veçanërisht me mundësitë e përshtatjes së të mësuarit për nevoja individuale të nxënësit, i cili mbështetet shumë nga shkencat e të mësuarit OECD, 2010: Groff, 2010.

Sot teknologjia po njihet në mënyrë progresive si një mjet i rëndësishëm mësimi për të ndihmuar fëmijët e vegjël në zhvillimin e aftësive të tyre njohëse, sociale dhe mësimore. Edhe pse disa studiues janë kundër përdorimit të teknologjisë për mësimin e fëmijëve, pavarësisht kësaj efektet e teknologjisë janë njohur gjerësisht në fushën e arsimit dhe janë dëshmuar të jenë shumë pozitive për zhvillimin e fëmijëve të vegjël. Fëmijët që përdorin teknologjia tregojnë aftësi më të mira gjuhësore, inteligjencë, njohuri



strukture dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve krahasuar me fëmijë që nuk përdorin teknologji për mësimin e tyre (Tahir & Arif, 2016).

Sidoqoftë, zbulimi i PISA alarmoi autoritet shtetërore pasi PISA nxorri në pah gjegjësisht zbuloi se frekuenca e përdorimit të teknologjisë informative nga ana e nxënësve në shtëpi nuk përshtatet, respektivisht është në diskrepancë me përdorim e teknologjisë informative nga ana e nxënësve në shkollë, dhe se në shumicën e vendeve të OECD, më shumë se 80% e 15-vjeçarëve përdorin kompjuterë shpesh, megjithatë kishte edhe të tillë që nuk kishin kompjuterë në shtëpi (OECD, 2010a).

Edhe pse shumica e shkollave ishin të pajisura me kompjuterë dhe kishin qasje në internet, kjo pabarazi në përdorimin e kompjuterëve në shkollë dhe përdorimit të tyre në shtëpi ishte e madhe. Pjesa më e madhe e nxënësve që përdornin kompjuterët në shtëpi ishin të orientuar drejt argëtimit. Kjo imponon nevojën që shkollat të luajnë një rol më të madh për t'i ndihmuar nxënësit të përfshihen në mësim jashtë shkollës duke rritur kohën e përdorimit të teknologjisë informative për të mësuar (OECD, 2010a).

Numri i madh i pajisjeve teknologjike të cilat janë në dispozicion për t'i përdorur nëpër institucione arsimore lejon dhe krijon shumë ambiente mësimore të diversifikuara dhe kjo mundëson nxitjen e përdorimit të teknologjisë informative si një linjë për ndryshimin dhe përmirësimin e arsimit (UNESCO, 2003).

Ekzistojnë shembuj të panumërt të praktikave më të mira të përdorimit të teknologjisë në shkolla, të vendosura në kontekste sfiduese, të cilat kanë bërë kërcime të mëdha në përparim akademik të nxënësve në shkolla duke krijuar mjedise mësimi të pasur me teknologji. Kur integrohen siç duhet dhe lidhen strategjikisht së bashku, teknologjia dhe të mësuarit, fuqizohen deri në atë shkallë sa që mundësojnë angazhim më të madh të nxënësve dhe motivojnë nxënësit në procesin e të mësuarit, si dhe teknologjia bëhet një mjet për katalizimin e ndryshimeve strategjike në pedagogji dhe praktikë. Teknologjitë inovative jo vetëm që kanë potencial të evoluojnë praktikën pedagogjike, por edhe transformojnë plotësisht mjediset e tëra mësimore (Groff, 2013).

Në vijim do të shohim se si praktikat më të mira të integritit të teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie ndikojnë në përmirësimin e performancave të shkollave.

Nga një studim i bërë në një shkollë në zemër të New Yorkut (339) në SHBA e cila ishte konsideruar si shkollë më e dobët dhe për një afat shumë të shkurtë ishte bërë një shkollë me sukses të shkëlqyer. Në vitin 2005, vetëm 9% e nxënësve po performonin në nivele adekuate në matematikë. Shkolla vendosi të injektojë teknologjinë në lëndën e matematikës duke furnizuar çdo nxënës me nga një laptop dhe duke zbatuar Google Docs si forma kryesore e menaxhimit të përmbajtjes. Me laptopët, nxënësit përfundonin detyrat e shtëpisë në internet, menaxhonin bloget e tyre, menaxhonin bashkërisht të dhënat dhe përdornin platformat online të krijuara nga mësuesit për të mbështetur punët e projektit.

Tabelat e bardha interaktive në klasë i lejonin nxënësit të ndajnë punën e tyre me tërë klasën. Pas tre vjetësh, rezultatet e matematikës ishin rritur deri në 62% dhe dhuna dhe sjellja dhe çështjet tjera të mosbindjes dhe mosbashkëpinimit ishin ulur në mënyrë dramatike. Nxënësit kishin raportuar rritje të motivimit për të bërë punë në shkollë pasi ata konsideronin se teknologjia i stimulon ata në bërjen e detyrave dhe të mësuarit duke rezultuar në një demonstrim më të madh të investimeve të tyre në udhëtimin e tyre arsimor. Suksesi i madh i arritur në shkollën 339 u bë shembull për të gjitha shkollat e tjera në zonën e Neë York City (Groff, 2013).

Pra, shembulli i mësipërm ishte një shembull i spikatur i cili në fakt mbështet fortë hipotezën e këtij punimi pasi tregon se si një shkollë, e cila kishte ngecur në përparim pasi kishte përdorur mësimdhënie tradicionale, kishte bërë një kërcim të madh pas integritit të teknologjise informative në shkollë. Dallimi nga gjendja paraprake (pa teknologji) dhe ajo gjendja pasuese pas integritit të teknologjisë në shkollë ishte shumë i madh, nga një reputacion shumë i dobët shkolla arrin të transformohet në një shkollë model për të tjerat shllolla në atë vend.

Më tutje, Shkolla Fillore Inovative Silverton në Australi ka një histori të ngjashme me atë të Shkollës 339. Përballë sfidave të panumërta dhe performancës së ulët të nxënësve, kjo shkollë, si një mjedis i vështirë mësimi, vendosi të kapitalizojë nga kycja e saj në projektin mbarëkombëtar të Qeverisë Australiane për të investuar në arsim duke integruar teknologjinë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkolla fillore e cila filloi një iniciativë të gjerë transformimi të arsimit dhe së bashku me të të krijojë një plan gjithëpërfshirës për ndryshim. Pra, transformimi ishte enorm dhe përparimi ishte i theksuar. Përfitimet nga furnizimi i teknologjisë informative në shkollat fillore ishin të shumta (Groff, 2013).

Megjithatë, ajo që e bën kaq dramatike transformimin e Silverton Primar është ndryshimi i nisur në fushat tjera kritike të mjedisit mësimor. Së bashku me një transformim strategjik të mësimdhënies dhe mësimit përmes hapësirave të reja të të mësuarit, teknologjive të reja dhe qasjeve të reja kurrikulare, Silverton Primary krijoi një skemë gjithëpërfshirëse të ndryshimit dhe zhvillimit të mësuesve. Kjo përfshiu vaucher trajnimi për mësuesit në një program trajnimi intensiv, në programe të vazhdueshme dhe afatgjata për të mbështetur të gjithë arsimtarët pasi ato vazhdojnë të përmirësojnë dhe përsosin praktikën e tyre.. Me këtë Shkolla Silverton Primar arriti një sukses të madh duke transformuar tërësisht ambientin e tyre mësimor nga ai tradicional në atë modern të mbështetur nga teknologjia informative dhe ndryshimit të metodologjive si pasojë e integritit të teknologjisë informative në shkollë. Si rezultat i gjithë këtij projekti të madh të zbatuar në Silverton Primary arsimtarët e kësaj shkollë tani marrin pjesë në projekte kërkimore, me qëllim që të arrijnë më shumë të përfshihen thellë në praktikën e tyre. Sot, Silverton Primary është një nga 12 shkollat globale të mentorëve në Programin ‘Shkolla Inovative Microsoft’, ku ata udhëzojnë shkollat në Portugali, Hollandë, Irlanda, Sri Lanka, Malta dhe Izrael përmes takimeve

dyjavore në internet. Programe të tilla si këto nuk ndihmojnë vetëm mësuesit e Silverton Primar për ta përmirësuar dhe rafinuar vazhdimisht zanatin e tyre, por që ata gjithashtu të rriten dhe evoluojnë si bota në të cilën veprojnë (Groff, 2013).

Edhe ky shembull dëshmon për mundësitë transformative të teknologjisë informative në procesin edukativo arsimor në shkollat fillore. Edhe ky shembull po ashtu edhe mbështet hipotezat e këtij punimi dhe na furnizon me siguri për të rekomanduar integrim të teknologjisë informative dhe përdorim të saj në mësimdhënie dhe nxënie me plane paraprake të menaxhmenteve të shkollave fillore në komunën e Tetovës për të siguruar rritje të performancës akademike të nxënësve të këtyre shkollave.

Një praktikë tjetër e mirë e integritit të teknologjisë në shkollë dhe përdorimin e saj për të transformuar procesin edukativo arsimor po ashtu është edhe Shkolla Shady Hill në Kembrixh, Massachusetts (SH.B.A.) e cila morri pjesë në një projekt dy vjeçar ku për dy vite zbatuan një të ashtuquajtur “projekt të infeksionit teknologjik” duke injektuar laptopë, projektorë dhe teknologji të ndryshme të tjera dixhitale në klasë, gjithashtu të injektojnë praktikën e inovacionit në shkollë. Shkolla madje krijoi hapësirë vetëm për arsimtarët të cilët u furnizuan plotësisht me teknologji të reja dhe të paktën një specialist të teknologjisë integruese në çdo kohë. Arsimtarët në këtë hapësirë, e krijuar apostafat për ata, kishin mundësi të hulumtojnë, shkëmbejnë mendime, krijojnë dhe mësojnë me teknologji të reja.

Studimet e mësimpërme të rasteve demonstrojnë gjithashtu fuqinë e teknologjisë jo vetëm për të ndryshuar mjediset arsimore, por edhe për të ndryshuar vazhdimisht edhe vetë natyrën e inovacionit si një sistem kolektiv.

Në nivel global, ekziston një nevojë e konsiderueshme që sistemet arsimore të rishikojnë qasjet e tyre. Investimi në teknologji informative që do përdorej nëpër shkolla tejkalon thjesht krijimin e një mjeti më të efektshëm ose më efektiv për të siguruar arsim më cilësor. Kjo po ashtu prodhon një mjedis që krijon dhe zhvillon një qytetar efektiv (OECD, 2006).

Sic shihet teknologjia jo vetëm që ka ndryshuar formën e të mësuarit tradicional, por po ashtu i jep potencial kreativitetit mes nxënësve, integritit të strategjive të ndryshme pedagogjike (Serdyukov & Serdyukov, 2017. Shumë mundësi tërheqëse të ndërlydhura me teknologjinë informative në klasë kanë dalë në pah për të ndryshuar formën e mësimdhënies dhe nxënies si dhe metodave të mësimdhënies dhe sjelljes së nxënësve në përgjithësi (Kinshuk et al., 2016).

## **2.2 Roli dhe sfidat e drejtorëve të shkollave fillore në sigurimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies**

Sic përmendëm më sipër arsimi është me rëndësi kruciale për zhvillimin e shoqërisë në çdo aspekt. Prandaj, edhe shoqëria dhe sistemi politik, pra qeveria duhet të kujdeset që të kemi arsimim cilësor në vend.

Ka shumë faktorë që ndikojnë në arsimimin cilësor edhe atë: e para, faktori politik, që ka të bëjë me zvogëlimin e shpenzimeve si përpjestim ndaj Bruto Prodhimit Vendor dhe kërkesat e arsimit ndaj shpenzimeve të tjera publike; e dyta, faktori ekonomik, që ka të bëjë me lidhjen mes shpenzimeve për arsim dhe suksesit ekonomik të shtetit, si dhe e treta, faktori i performancës së shkollave, që nënkupton sigurim të performancës cilësore dhe efektive në mësimdhënie si dhe në menaxhim efektiv dhe cilësor të mësimdhënies në shkollë që do të ndihmonte në edukimin dhe arsimimin cilësor të gjeneratave të reja dhe shoqërisë në tërësi (Stuart, 1994: Preedy et al, 2004).

Sic shihet ka më tepër faktorë që ndikojnë në sigurim të arsimit cilësor, por në këtë nënkapitull do të trajtojmë vetëm faktorin e tretë edhe atë pjesën që ka të bëjë me menaxhimin e mirë të shkollave në drejtim të sigurimit të mësimdhënies dhe nxënies cilësore.

Në këtë kontekst, do të nxjerrim në pah dy trendet e forta që u paraqiten nga fundi i shekullit 20, më saktë viteve të 1970 të cilat ndryshuan thelbësisht mënyrën se si tani konsiderohen dhe menaxhohen shkollat. E para është quajtur "lëvizja efektive e shkollave"; ishte në fakt një përpjekje e bashkërenduar në disa vende për të zbuluar mënyra të krijimit të shkollave vërtet të shkëlqyera. Lëvizja ka prodhuar një literaturë mbresëlënëse që menaxherët e shkollave nuk mund të anashkalojnë. Lëvizja e dytë ishte një ndryshim i thellë në fushën e studimit të quajtur menaxhim i arsimit, sic e përmendëm edhe më lartë në këtë punim, i cili u paraqit në Britaninë e Madhe dhe i njëjti u quajt Administrim i arsimit në Amerikën e Veriut dhe Australi, dhe i cili ka tendencë të bëjë shumë prej ideve të trashëguara nga para vitit 1975 të konsiderohen si të vjetëruara.

Sipas Preedy et al (2004) procesi i arsimit fillon me Kurikulën Kombëtare dhe me Deklaratat e shkollave në të cilat radhiten objektivat dhe qëllimet e shkollave. Nga ana tjetër është nxënësi. Cdo fëmijë vjen në shkollë me një përvojë unike të tij/ saj si dhe me interesat dhe aftësitë individuale të tij/saj dhe kjo ndikon në aftësitë e fëmijës të merrë nga ajo që shkolla ofron. Puna e rëndë e drejtorisë së shkollës si dhe e arsimtarëve është që të afrojnë apo bashkojnë nxënësit dhe kurrikulën në atë mënyrë që nxënësit të mësojnë (Dean, 2004,91: Preedy et al, 2004).

Sipas Dean (2004,91:Preedy, 2004) detyrat organizative të drejtorisë së një shkolle janë:

1. Organizimi i shkollës në mënyrë efektive për procesin e mësimdhënies dhe nxënies.
2. Të sigurojë mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit.
3. Organizojë dhe koordinojë të punësuarit në mënyrë efektive.

Është detyrë e menaxhmentit të shkollës që të organizojë procesin edukativo arsimor në shkollë në atë mënyrë që të ketë nxënie cilësore nga ana e nxënësve, organizimin dhe koordinimin e të

punësuarve, kohës dhe hapësirës në mënyrën më të mirë të mundur. Kjo përfshin grupimin e nxënësve në mënyra të ndryshme për të mësuar, ndonjëherë duke bërë përpjekje për të krijuar grupe homogjene dhe ndonjëherë me qëllim formimin e grupeve të përziera. Puna organizohet në atë mënyrë që nxënësit të mund të mësojnë individualisht, duke përdorur materiale kompjuterike si dhe materiale nga burime të tjera dhe mundësitë ka gjasa të rriten me rritjen e programeve për këtë qëllim. Menaxhmenti duhet të planifikojë përdorimin e kohës për të siguruar program arsimor gjatë vitit shkollor që përdor aftësitë e të punësuarve dhe hapësirën si dhe resurse të tjera të disponueshme për përfitime maksimale (Dean, 2004,91: Preedy, 2004).

Duke patur parasysh se shumica e drejtorëve të shkollave trashëgojnë strukturën dhe nuk janë në gjendje të bëjnë ndryshime të mëdha, pasi të punësuarit vec më janë në pozicionet e tyre dhe ndoshta levizjet e ndryshme në pozicione për të krijuar një strukturë tjetër mund edhe të mos funksionojnë. Cdo reorganizim i shkollës mund edhe të kushtojë po ashtu edhe psh në shkollat e Anglisë qeverisja lokale lejon drejtorin e shkollës të bëjë lëvizje apo edhe largim nga puna të të punësuarve për të qenë brenda shpenzimeve buxhetore. Edhe pse kjo formë e drejtimit të shkollës me autonomi të theksuar të drejtorit për restrukturim të shkollës mund të duket jo popullore megjithatë paraqet një fillim të mirë për të implementuar ndryshimet e planifikuara. Në këtë mënyrë, drejtori ngadal fillon ta restrukturojë shkollën, gjegjësisht të krijojë një strukturë të re gjatë një periudhe kohore ashtu sic paraqiten mundësitë. Pra, këto ndryshime strukturore zgjasin dhe nuk janë ndryshime oportune apo klanore por bëhen me qëllim të ndryshimeve programore me anë të të cilave tentohet të arrihen rezultate të mira në nxënien e nxënësve por edhe në ngritjen e cilësisë së programeve (Handy, 1976:198-99: Preedy, 2004).

Më tej, Handy (1976:Preedy, 2004) sqaron se në cdo insitucion arsimor ka më tepër lloje të aktiviteteve prej të cilave më tepër theksohen katër:

1. Gjendje e qëndruar – kjo ka të bëjë me programimin e aktiviteteve rutinore kundrejt atyre jorutinore.
2. Inovative/ zhvillimore – kjo ka të bëjë me të gjitha aktivitetet të cilat kanë për qëllim ndryshimin e gjërave që insitucioni arsimor i bën apo mënyrën se si i bën.
3. Dëmtimet/ krizat – kjo ka të bëjë me dëmtimet që mund të ndoshin në institucione apo humbje të paparashikueshme.
4. Rregulloret/ drejtimi – Vendosja e prioriteteve dhe e standardeve, drejtimin dhe alokimin e resurseve, inicimi i veprimt e të tjera.

Në një linjë me Handy janë edhe Beare et al (2018) të cilët sugjerojnë katër domene ose fusha: 1) meaxhimi rutinor operacional; 2) planifikimi dhe zhvillimi; 3) shërbimi profesional; dhe 4) politik. Secila nga këto kërkon një mënyrë të sjelljes. Disa njerëz mund të marrin pjesë në disa fusha dhe do të kërkohet nga ata që të veprojnë ndryshe në secilën fushë. Ata theksojnë se pikërisht në fushën operative llojet e

strukturave të ndryshme veprojnë në mënyrë më efikase. Në domenin e planifikimit kërkohet nga strukturat e përkohshme që secila nga strukturat të kenë një udhëheqës të cilët do të menaxhojnë me grupet e punës. Në këtë drejtim institucioni mund të përzgjedh njerëz që kanë aftësi për të kryer këtë punë. Kjo mënyrë është e ngjashme me të Handy-it i cili thekson se udhëheqësit duhet të jenë inovativ (Beare et al, 2018).

Beare et al (2018) sugjeron që duhet të ketë një domen në të cilën duhet të mundësohet shërbim profesional për klientët. Nga arsimtarët pritet që të bashkëpunojnë mes veti duke grumbulluar idetë dhe aftësitë e tyre me qëllim që të ketë një analizë më të mirë të mundshme, si dhe për të akumuluar mendime kolektive për të siguruar shërbim cilësor, në këtë rast mësimdhënie cilësore, dhe për të zbatuar një operacion sa më kompetent. Duke patur parasysh se kjo mund të kuptohet si një mënyrë e veprimit të institucioneve prapë se prapë është në linjë me atë se si shkollat normalisht veprojnë. Vënia e theksit tek “klientët” mund të prodhojë një qasje apo ndjenjë të ndryshme, në vecanti kundrejt prindërve, ku ligjet shtetërore dhe propaganda shtetërore kombinohen për të krijuar një raport të ndryshëm mes shkollës dhe prindërve që ata shërbejnë.

Fusha apo domeni politik ka të bëjë me rolin e drejtorit në vendosjen e bashkëpunimit me palë të ndryshme të interesit jashtë shkollës. Ata e potencojnë rolin e drejtorit për të punuar me koalicionë pushtetare dhe lobi grupe dhe si pasojë të menaxhojnë me skenën politike pasi politika ndikon në punën e shkollës (Beare et al, 2018).

Sipas Dean (2004: Preedy, 2004, 101) këto katër domene apo fusha krijojnë implikime në strukturën e shkollës të cilën drejtori e krijon. Sugjerimet e tyre kanë të bëjnë me lejimin e krijimit të grupeve të projektit të cilët mund të negociojnë me strukturat tjera dhe me këtë shumica vendimeve të sillen në mënyrë kolegjiale. Më tej, Dean (2004:Preedy, 2004:1010) thekson se struktura e të punësuarve që drejtori krijon është pra mënyra apo mjeti me anë të së cilës drejtori zbaton aspektet e ndryshme menaxheriale.

Duke patur parasysh rolin delikat të një drejtori të shkollës si një arsimtar, pedagog, psikolog, edukator, udhëheqës, administrator, trainer dhe mentor shihet se gjitha këto attribute në fakt janë arritje të evoluimit të rolit të drejtorit gjatë një kohë më të gjatë. Pra, në këtë drejtim roli i drejtorit me kalimin e kohës evoluon edhe më tej, edhe atë nga një autoritet të vetmuar, i cili ka qenë i ngarkuar psikikisht me pozicionin e tij dhe detyrën e shpëtimtarit të shkollës së rrezikuar nga dështimi, deri tek një udhëheqës efektiv që inkurajon ato cilësi tek nxënësit dhe arsimtarët, duke i motivuar ata të dalin përtej kufijve të klasës për të shndërruar shkollën nga një vend pune në një vend mësimi (Hallinger, 2005).

Sa i përket rolit të drejtorit janë bërë shumë studime për të analizuar këtë rol i cili ka ndikim të dukshëm në funksionimin e shkollës dhe arritjet e nxënësve. Psh u bënë disa studime në të cilat u studiuan administratorët në pesë shkolla fillore shumë të efektshme. Këta udhëheqës, përmes akteve të

vullnetit dhe bashkëpunimit kishin hequr dorë nga statusi ikonik i udhëheqjes, në mënyrë që udhëheqja e shkollës të bëhej bashkërisht me të punësuarit e tjerë në shkollë. Përfshirja e shtuar e të gjithë “punonjësve” si palë të interesuara në vendimmarrje organizative është bërë një praktikë e pranuar globalisht gjatë 20 viteve të fundit. (Eright, Horn, & Sanders, 1997).

Më tutje, sipas Wright, Horn&Sanders (1997) udhëheqësit e suksesshëm i përgjigjen në mënyrë produktive sfidave dhe mundësive të krijuara nga konteksti i orientuar drejt përgjegjësisë për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve të ndryshëm. Udhëheqja ka një efekt të rëndësishëm në nxënien. Drejtuesit e shkollës bëjnë një ndryshim duke ndikuar në mënyrë indirekte tek të punësuarit për të kryer punët në drejtim të planifikuar. Kjo zakonisht ndodh kur ndikon pozitivisht tek arsimtatër të kryejnë punën e mësimdhënies në mënyrë më efikase. Angazhimi dhe motivimi i stafit, nxitja e një qëllimi të përbashkët, krijimi i kushteve për mësimdhënie dhe mësim efektiv, nxitja e koherencës së programit, inkurajimi i të mësuarit organizativ dhe përmes reagimeve, drejtimit dhe komunikimit (Wright, Horn, & Sanders, 1997).

Pra, shqyrtimi i literaturës më sipër dëshmon për një fakt se arritja e nxënësve është ‘leitmotif’ (motiv udhëheqës) i secilit udhëheqës arsimor si dhe gjithë veprimtaria e drejtorëve dhe suksesi i tyre në udhëheqjen e shkollave ndërlidhet shumë ngushtë me arritjen e nxënësve. Në një linjë me këtë që përmenda tani është edhe Mero (2009: Parsons & Beauchamp, 2012), i cili thekson se është e rëndësishme të vihet re se udhëheqja e shkollës, që paraqet njërin nga funksionet e drejtorëve, paraqet një lloj përgjegjësie për arritje.

## **2.3 Roli dhe sfidat e drejtorëve të shkollave fillore në sigurimin e infrastrukturës teknologjike në shkolla**

Dihet që një ndër çështjet më kryesore në punën efikase të shkollave në përgjithësi është sigurimi i ambientit për mbarrëvatjen e procesit edukativo arsimor në shkolla, sigurimi i materijaleve, librave, dhe mjeteve të ndryshme për arsimtarët për të kryer detyrën e tyre edukativo arsimore si dhe furnizimi i shkollës apo më saktë të klasave me pajisje të ndryshme teknologjike për të siguruar mësimdhënie dhe nxënie cilësore në shkolla. E gjithë kjo punë bie mbi përgjegjësitë e drejtorëve të shkollave të cilët së bashku me ekipin e drejtorit bëjnë planifikimet e nevojshme për të siguruar ambientin në të cilën do të rrjedh procesi edukativo arsimor.

Përveç kësaj, normal që më pas duhet edhe drejtori dhe ekipi drejtues i shkollës siç është edhe Bordi i shkollës të alokojnë mjetet e nevojshme për të siguruar teknologjinë e duhur në shkollë. Pra, do duhet të jenë në përputhshmëri të plotë kurrikula e cila thekson përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie, pritjet e arsimtarëve dhe mjetet financiare të ndara për prokurim të pajisjeve

teknologjike. Cdo devijim nga plani mund të ketë pasoja në arritje të objektivave të shkollës gjegjësisht objektivave të planifikuara nga procesi edukativo arsimor. (Brody, 1995).

Po ashtu, me rëndësi për të përmendur në këtë rast është edhe vendimmarrja për të blerë pajisje të caktuara teknologjike, në veçanti kjo i referohet nevojës për të pasur udhëheqës që e njohin teknologjinë informative mirë dhe bëjnë vendime të duhura për pajisje teknologjike të nevojshme. Ose së paku shkollat duhet të kenë personel adekuat të teknologjisë informative, ose specialist i teknologjisë informative në shkollë të cilët do të këshillonin drejtorinë e shkollës për llojin e duhur të teknologjisë informative e cila do mundësonte arritje të objektivave mësimore të planifikuara të arrihen duke përdorur teknologjinë informative. Cdo mangësi në dije për të përzgjedhur teknologjinë më të avancuar apo të duhur për të zbatuar kurikulumin teknologjik të shkollës do kishte pasoja negative mbi procesin edukativo arsimor dhe si rrjedhojë do ketë mësimdhënie të mangët si dhe rezultatet e nxënies do jenë më të ulëta (Brody, 1995). Edhe pse, sipas Brody (1995) ndonjëherë ndodh që edhe specialistët më të mirë teknologjik të mos jenë në gjendje të bëjnë vendime të duhura sa i përket përzgjedhjes së teknologjisë më të avancuar për shkak të zhvillimit të shpejtë teknologjik.

Shqyrtimi i literaturës për sa i përket furnizimit të shkollave fillore me teknologji informative nxjerrë në pah faktin se çdo ditë e më shumë shkollat po investojnë në teknologji për të përmirësuar arritjet e nxënësve dhe për të mbyllur hendekun e arritjeve (Darling-Hammond, Zielesinski & Goldman, 2014, Nagel, 2014, Leithood, Louis & Anderson, 2004, Schiller, 2003, Abdullah et al, 2013).

Duke patur parasysh avancimin e hofshëm të teknologjisë informative, furnizimi i shkollave me infrastrukturë teknologjike në vecanti me kompjutorë është bërë një zë buxhetor permanent, e jo vetëm për një herë (Leithood, Louis & Anderson, 2004: Abdullah et al, 2013). Për këtë arsye drejtorët e shkollave si dhe institucionet përkatëse në Ministrinë e arsimit duhet të konsiderojnë sigurimin e infrastrukturës teknologjike informative në shkolla si çështje strategjike dhe për atë shkak prokurimi i teknologjisë informative duhet të jetë i vazhdueshëm.

Studimet e ndryshme tregojnë se nuk ka një strategji të vetme më të mirë për të ndërtuar infrastrukturë teknologjike në një shkollë; përkundrazi, për sa kohë që nxënësit kanë fleksibilitet se kur dhe si i qasen teknologjisë digjitale. Ministrinë e shteteve të ndryshme janë një hap më afër për qëllimet e tyre për të promovuar mësimin me në qendër nxënësin dhe përdorimin e teknologjisë informative për nxënësit (Light&Pierson, 2013).

Studimet po ashtu forcojnë rëndësinë për Ministrinë e Arsimit dhe autoritetet e arsimit lokal që të sigurojnë qasje adekuate në teknologjinë informative në shkolla, gjegjësisht në sigurimin e infrastrukturës teknologjike në shkolla. Por, ata më tej sugjerojnë që mund të ketë mënyra të ndryshme por edhe me efikasitet të njejtë për shpërndarjen e pajisjeve teknologjike në shkolla. Analizat nga këto studime sugjerojnë që qasja në kompjutor të cdo nxënësi jo vetëm që rrit frekuencën me të cilën ata përfshihen në



aktivitete të bazuara në teknologji informative por kjo ndikon edhe në llojet dhe cilësinë e aktiviteteve në klasë (Light&Pierson, 2013).

Një studim i kryer nga Daëson dhe Rakes (2003: Esplin, 2017) zbuloi se me zhvillimin profesional të drejtorëve për përdorim të teknologjisë informative shkollat bëjnë më shumë përparim në integrimin e teknologjisë. Përveç kësaj, studimi i tyre sugjeroi që të aftësohen drejtorët për të integruar teknologjinë në shkollë për shkak se përdorimi më efikas dhe më efektiv i teknologjisë informative duhet të bëhet mbizotërues në shkolla. Rritja e njohurive të drejtuesve gjithashtu çoi në më shumë mbështetje të arsimtarëve në përpjekjet e tyre për të përdorur në mënyrë efektive teknologjinë në klasat e tyre (Daëson and Rakes, 2003: Esplin, 2017). Përveç kësaj, studimet argumentojnë se drejtorët e mirëpërgaditur për të furnizuar shkollat me infrastrukturë të mirëfilltë teknologjike si dhe integrimin e teknologjisë në shkollë në fakt krijojnë një urë ndërmjet infrastrukturës teknologjike dhe rezultatëve të të mësuarit nga ana e nxënësve (Arafah, 2015: Esplin, 2017).

## **2.4 Roli dhe sfidat e drejtorëve të shkollave fillore në zhvillimin profesional të**

### **mësimdhënësve për të përdorur teknologjinë informative në mësimdhënie .....**

“Udhëheqja është një proces, jo një pozicion. Udhëheqja merret me njerëzit dhe dinamikën e tyre, e cila është duke u ndryshuar vazhdimisht. Sfidat e udhëheqjes është për të krijuar ndryshime dhe për të ndihmuar rritjen.” – John Maxwell

Këtë nënkapitull nisim me një citim të një thënie të një dijetari dhe udhëheqësi me përmasa botërore, John Maxwell,<sup>23</sup> i cili më së miri përshkruan rolin e një udhëheqësi të një institucioni në këtë rast rolin e drejtorit të një institucioni arsimor në zhvillimin e stafit mësimdhënës për të arritur qëllimet dhe objektivat e institucionit arsimor apo shkollës.

Sipas Maxwell (2017) udhëheqësi i një institucioni është personi që mban pozitën më të lartë në atë institucion, prandaj edhe është detyrë dhe përgjegjësi e tij/ saj për zhvillimin profesional të ekipit të të punësuarve. Prandaj, aftësia për të krijuar një ekip të suksesshme dhe mirë të përgaditur për tu ballafaquar me sfidat e kohës dhe për të qenë në trend me zhvillimet teknologjike, apo për të krijuar një departament apo institucion që siguron produktivitet të lartë, tregon një nivel më të lartë të aftësisë drejtuese të udhëheqësit apo në rastin tonë drejtorit të shkollës (Maxwell, 2017).

Por, për të arritur nivelet më të larta të udhëheqjes që krijojnë insitucione arsimore elitare, drejtori apo udhëheqësi i shkollës duhet të kalojë nga niveli i udhëheqësisë së lejimit, nivelit 2 në nivelin e

---

<sup>23</sup> Maxwell është shumë i apasionuar pas udhëheqjes. Ai është një mësues motivues i cili përpiket të ndihmojë njerëzit të arrijnë potencialin e tyre. Maxwell është trajnoi më shumë se 5 milion udhëheqës në 126 vende botëror. Cdo vit ai mbanë presentimi dhe diskuton me udhëheqësit e organizata të ndryshme, siç janë ndërmarrjet Fortune 500, qeveritë e huaja, Lidhja Kombëtare e Futbollit, Akademia Ushtarake e Shteteve të Bashkuara në West Point, dhe Kombet e Bashkuara. New York Times, etj . Maxwell ka shkruar tre libra që kanë shitur më shumë sesa një milion kopje

udhëheqësisë së nivelit 3 dhe 4, gjegjësisht nivelit të udhëheqësisë së prodhuesit dhe udhëheqësisë së zhvilluesit (Maxwell, 2017)<sup>24</sup>.

Sipas Maxwell (2017) burimet njerëzore në një institucion janë aset i vlerësueshëm apo më i vlefshëm në institucion dhe udhëheqësi duhet të vazhdojë të zhvillojë marrëdhëniet dhe kujdesin për të tjerët derisa udhëheqësi prodhon rezultate nga puna e tij si drejtues institucioni. Kostoja e udhëheqjes është të mbajë përgjegjësinë e suksesit të ekipit në supet e tij/saj.

Sipas Maxwell (2017) udhëheqësi fiton besueshmëri kur ai/ ajo kryen punë me përsosmëri dhe ndihmon të tjerët të jenë produktivë, modelon dhe vendos standardin për të tjerët, komunikon vizionin përmes veprimit, duke u dhënë njerëzve një pamje më të qartë se çfarë do të thotë të përmbushin vizionin e institucionit, përhap produktivitetin në të gjithë organizatën, krijon vrull, duke i bërë gjërat më të lehta, dhe në fund e gjithë kjo bëhet themeli për krijimin e ekipit, pasi njerëzit duan të jenë pjesë e një ekipi fitues.

‘Zhvillimi profesional i njerëzve është përmbushja më e madhe e një udhëheqësi’ (Maxwell, 2017). Ndërsa, zhvillimi profesional i njerëzve i takon nivelit të katërt të udhëheqësisë. E në këtë nivel, udhëheqësi i mirë investon kohën, energjinë, paratë dhe të menduarit e tij/ saj në rritje apo zhvillim profesional të të tjerëve për të arritur objektivat dhe qëllimet institucionale. Udhëheqësit në nivelin e zhvillimit profesional të të punësuarve zhvendosin fokusin e tyre nga prodhimi i arritur nga të tjerët në zhvillimin e potencialit të tyre. Dhe ata vendosin vetëm 20 përqind të përqendrimit të tyre në produktivitetin e tyre personal ndërsa 80 përqind të saj vendosin në zhvillimin profesional dhe udhëheqjen e të tjerëve. Udhëheqësi në këtë nivel duhet të heq dorë nga egoja dhe kontrolli dhe fokusin e vendos tek ndërtimi i besimit me njerëzit që ai/ ajo udhëheq. Kjo mund të jetë një zhvendosje e vështirë, por është një ndryshim që mund të revolucionarizojë një institucion dhe t’i japë atij një të ardhme shumë më të ndritshme (Maxwell, 2017).

Në linjë të njëjtë me Maxwell (2017) janë edhe kolegët e tij nga Universiteti i Minnesota dhe Universiteti i Torontos të cilët nga hulumtimet e bëra në shkolla nxorren në pah se sa më shumë drejtorët të jenë të gatshëm për të deleguar përgjegjësitë e tyre tek stafi mësimdhënës aq më mirë për nxënësit.

Gjetja më e rëndësishme nga këto hulumtime nxorren në pah lidhmërinë mes udhëheqjes efektive, e cila në këtë rast nënkupton udhëheqjen e përbashkët (drejtori me ekipin e tij/saj ndihmës, stafin akademik, e të tjerë) me performancën më të mirë të nxënësve. Pra, kjo dëshmon për një marrëdhënie shumë të fortë mes udhëheqjes efektive të shkollës dhe rezultateve të të mësuarit tek nxënësit. Pra, lidhja është e fortë edhe pse indirekte pasi i tërë procesi rrjedh nëpërmjet arsimtarëve, gjegjësisht nëpërmjet procesit të mësimdhënies dhe nxënies (Wallace Foundation Report, 2013).

---

<sup>24</sup> Për të mësuar më tepër për 5 nivelet e udhëheqësis shihni Maxwell (2017)

Nga ana tjetër edhe hulumtues nga Universiteti i Uashingtonit në hulumtimin e tyre mbi udhëheqjen në sistemet shkollore urbane theksojnë nevojën për një ekip udhëheqës (të udhëhequr nga drejtori dhe përfshirë ndihmës drejtorë dhe drejtues të mësuesve) dhe përgjegjësi të përbashkët për përparimin e nxënësve, një përgjegjësi e reflektuar në një grup marrëveshjes, si dhe norma të pashprehura ndërmjet stafit të shkollës. Drejtorët si udhëheqës të shkollave gjithashtu kërkuar mënyra për të inkurajuar zhvillimin profesional të arsimtarëve si dhe bashkëpunimin me ata, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mënyrës së ndarjes së përgjegjësi në shkollë.

Pra, e gjithë ajo që u përmend më lartë mund të themi se drejtorët efektivë, që promovojnë cilësi në mësimdhënie dhe nxënie, inkurajojnë mësimin e vazhdueshëm profesional. Vendimmarja e drejtorëve efektive bazohet në strategji të bazuara në hulumtime për të përmirësuar mësimdhënien dhe nxënien dhe iniciimin e diskutimeve në lidhje me qasjet metodologjike didaktike, si në ekipe ashtu edhe me arsimtarë individual. Në praktikë, kjo do të thotë që drejtuesit duhet të njihen ngushtë me "thelbin teknik" të procesit edukativo arsimor dhe procesin e mësimdhënies dhe nxënies, gjegjësiht për atë se çfarë kërkohej për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies.

Trajnimi dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve për të përdorur teknologji në mësimdhënie është shumë me rëndësi për procesin edukativo arsimor. Për këtë shkak në Britaninë e madhe në vitin 2014 është prezantuar projekti i digjitalizimit të kurrikulave në shkollat fillore. Dhe kjo iniciative ishte reflektuar edhe në shumë vende të tjera të botës.<sup>25</sup> Një raport i qeverisë irlandeze për TIK në Shkolla zbuloi se: "vetëm 30% e mësuesve në arsimin fillor dhe 25% e mësuesve pas arsimit fillor thanë se ishin përdorues të rehatshëm të TIK; një numër i vogël i mësimdhënësve mendonin se dinin ta zbatonin teknologjinë në mësimdhënie në mënyrë efektive." Sipas raportit, arsimtarët në arsimin fillor raportuan që metodat e tyre të preferuara të trajnimit ishte një kurs për përdorimin e TIK-ut në klasë i organizuar në shkollën e tyre. Pothuajse katër nga pesë arsimtarët (79%) nga 1,162 të anketuar e vlerësuan këtë metodë në tre zgjedhjet e tyre të para. Kjo metodë ishte e popullarizuar kryesisht nga fakti që trajnimi në këto ambiente zakonisht bëhej me pajisje teknologjike të disponueshme në shkollë. Arsimtarët raportuan që metoda e tyre e preferuar e trajnimit ishte një kurs i udhëhequr nga arsimtarët në qendrën e tyre lokale arsimore. Gati tre nga katër arsimtarët (73%) nga 800 të anketuarit e vlerësuan këtë metodë në tre zgjedhjet e tyre të para. Zgjedhja e dytë për arsimtarët në arsimin fillor ishin kurset e udhëhequra nga mësuesit në një qendër arsimi (74%), ndërsa në nivelin pas-fillor ishte kursi i organizuar në shkollë (69%). Metoda e tretë më e njohur për të gjithë mësuesit ishte një grup përkrahës i TIK-ut të mbështetur në qendrën arsimore. Ky konstatim është veçanërisht i rëndësishëm nga këndvështrimi i menaxhimit të shkollës. Kur organizohen trajnime për anëtarët e stafit, drejtori duhet të jetë i vetëdijshëm për metodat e preferuara të trajnimit të arsimtarëve.

<sup>25</sup> <https://www.ics.ie/news/why-teachers-need-to-improve-their-ict-skills>

Këtë nënkapitull do ta përfundoj me dy citate që sinjalizojnë një konsensus që elementi thelbësor i përmirësimit të cilësisë të arsimit është përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve dhe angazhimit të personelit arsimor. Sidoqoftë, këto citate theksojnë se detyra përfshin më shumë sesa ndërtimin e kapaciteteve ose "trajnimin" e arsimtarëve. Përpjekjet për të reformuar mënyrën se si mësuesit dhe drejtuesit arsimorë / menaxherët kryejnë rolet e tyre gjithashtu përqëndrohet në çështjet e sistemit arsimor dhe politikave (Baker-Doyle, 2010; McKinsey, 2010; Mulkeen et al., 2005; Ginsburg, 2011).

‘Është e qartë, që përmeshja e pritjes që të gjithë nxënësit do të mësojnë në standarde të larta do të kërkojë një transformim në mënyrat me të cilat sistemi ynë arsimor tërheq, përgatit, mbështet dhe zhvillon mësues ekspertë. Një aspekt i këtij transformimi po krijon mjete për të vlerësuar dhe njohur efektivitetin e mësuesve përgjatë karrierës së tyre, për qëllime të licencimit, marrjes në punë dhe dhënies së mandatit; për sigurimin e zhvillimit profesional të nevojshëm.’ (Darling-Hammond and Prince, 2007, f. 3; Ginsburg, 2011)

‘Përmirësimi i cilësisë së arsimit kërkon domosdoshmërisht përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe cilësisë së menaxhimit të arsimit dhe këto kërkojnë një përpjekje të madhe financiare dhe politike, përmirësim të konsiderueshëm të trajnimit të mësuesve para dhe gjatë shërbimit si arsimtarë, ndryshime rrënjësore në konceptin e menaxhimit të arsimit, një rregullim në mbikëqyrjen e mësimdhënies gjegjësisht gjatë ligjerimit të materijalit nga kurrikula shkollore, një strategji e re për rekrutimin e mësuesve që mund të aftësohen për të ngritur nivelin e të mësuarit tek nxënësit.’ (Carnoy, 2007, f. 3-4, Ginsburg, 2011)

### **Kapitulli 3 – Efikasiteti i metodave bashkëkohore të mësimdhënies të bazuara në teknologji informative**

#### **3.1 Praktikrat më të mira të dixhitalizimit të shkollave dhe përdorimit të teknologjisë në klasë**

Arsimi në përgjithësi, por edhe arsimi fillor në veçanti, duke patur parasysh numrin e madh të pajisjeve të avancuara teknologjike që gjithnjë e më tepër po përdoren në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, gjithnjë e më shumë po bëhen reflektues në lidhje me sfidat dhe mundësitë që sjell digjitalizimi, apo aplikimi i teknologjisë në arsim.

Në vazhdim do të përmendim disa nga praktikrat më të mira të përdorimit të teknologjisë në sistemet arsimore të disa vendeve si atyre evropiane po ashtu jashtë kontinentit evropian.

Le të fillojmë nga praktikrat më të mira të zbatimit të teknologjisë në sistemin arsimor Evropian, më saktë të Hollandës. Sipas Schleicher (2012), digjitalizimi, gjegjësisht, pajisjet e avancuara teknologjike kur zbatohen mirë në shkolla kanë potencialin për të transformuar mjediset e të mësuarit

dhe të fuqizojë nxënësit që të bëhen aktivë në formimin e arsimimit të tyre. Prandaj, sipas Schleicher (2012), është thelbësore që arsimtarët të kuptojnë se si nxënësit mësojnë, luajnë dhe socializohen jashtë klasës dhe të kërkohen pajisje teknologjike që do të mundësonin një jetë më të mirë për këta nxënës si në shkollë po ashtu edhe jashtë shkollës. Për shembull, në Hollandë në vitin 2008 doli një raport mbi burimet e hapura arsimore, i cili nxiti interesin tek mësuesit për të krijuar një mënyrë për të bashkëpunuar dhe ndarë materialet edukative dhe praktikat më të mira të tyre në përdorimin e teknologjisë në klasë. Nga ky bashkëpunim në mes arsimtarëve në tërë shtetin e Hollandës u nxit krijimi i një platforme e cila ishte e bazuar në Internetin e quajtur Uikivajs ("Wikiwise"). Kjo platformë u mundësonte arsimtarëve të gjejnë, shkarkojnë, zhvillojnë dhe shkëmbejnë burimet arsimore. Kjo platformë elektronike u krijua nga Open Universiteit Nederland dhe Kennisnet me kërkesë të Ministrisë së Arsimit të Holandës. Arsimtarët kishin mundësi të përdorin lirshëm çdo gjë që ata gjenin në bazën e të dhënave Wikiwise në klasat e tyre (Schleicher, 2012).

Në vazhdim, do të përmendim një rast jashtë Evropës. Bëhet fjalë për një projekt të përbashkët të quajtur 'Federata Le@rning'. 'Federata Le@rning' filloi si një projekt i madh me përmbajtje dixhitale për shkollat Australiane dhe Zelanda e Re. Projekti zhvilloi specifikime për qëndrueshmëri arsimore dhe sisteme të reja të mësimdhënies siç janë portalet në internet, sistemet e menaxhimit të mësimin, dhe sistemet e menaxhimit të përmbajtjes. Një numër i madh i shkollave në këto dy vende implementuan një pako të softuerëve për të mbështetur këto funksione. Federata Le@rning zhvilloi gjithashtu një "Pako Pajisjesh Thelbësore të Mësimin Elektronik" për të furnizuar shkollat me funksionalitetin bazë për menaxhimin e objektivave të të mësuarit, deri sa të krijohen kushte juridike për të implementuar sistemet e menaxhimit të përmbajtjes gjithëpërfshirëse të mësimin (OECD, 2010).

Përveç projekteve të mësipërme ka edhe projekte të tjera si p.sh. një projekt me anë të së cilit e tërë shkolla dixhitalizohet dhe mundësohet intensifikim të bashkëpunimit të shkollës me komunitetin dhe prindërit. Bëhet fjalë për shkollën fillore 'Courtenay Gardens', në Victoria, Australi. Një shembull suksesi nga dixhitalizimi i infrastrukturës shkollore dhe zbatimit me sukses të saj në procesin edukativ arsimor. Kjo është një shkollë fillore me nxënës të moshës 5-12 vjeç, në një zonë me status të ulët socio-ekonomik, e cila përdor intensivisht pajisje multimediale dhe kornizat e mësimin të personalizuar bazuar në kërkime. Nxënësit kanë qasje në një studio multimediale televizive dhe një stacion radioteleviziv, që nxisin zhvillimin e aftësive organizative të nxënësve, sjellje shoqërore, shkrim-lexim dhe mësim të numrave dhe që i lidhin me komunitetin. Përparimi i nxënësve monitorohet në baza ditore elektronikisht gjatë gjithë vitit me anë të një ndjekësit të të dhënave. Prindërit mund të ndjekin një program trajnimi për të siguruar ndihmë fëmijëve të tyre (OECD, 2012).

Një shembull tjetër i praktikave të mira të futjes së teknologjisë në arsim dhe zbatimin e saj është edhe Projekti i quajtur Handhelds në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Projekti Handhelds kishte të

bënte me iniciativën '1: 1' në arsim. Gjatë dekadës së fundit, gjithnjë e më shumë palë të interesuara publike dhe private në të gjithë botën kanë mbështetur iniciativat 1: 1 në arsim. Në Shtetet e Bashkuara, shteti i Maine ishte i pari që pajisi çdo nxënës të klasës së 7-të dhe të 8-të dhe çdo mësues prej klasës së 7-të deri në 12-të në mbarë vendin me qasje personale në teknologjinë e të mësuarit (Valiente, 2010).

Është me rëndësi të përmendim iniciativat dhe veprimet konkrete të Qeverisë Amerikane për transformimin e arsimit në SHBA dhe adoptim të një modeli të ri të arsimit që do të përfshinte integrimin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor në shkolla që do përgadiste nxënësit e së ardhmes. Sipas (Ëatson, et al 2014) në vitin 2013, Presidenti i atëhershëm Barak Obama njoftoi iniciativën ConnectED, duke u zotuar të lidhë 99% të studentëve amerikanë me internet ëireless me shpejtësi të lartë në shkollat dhe bibliotekat e tyre deri në vitin 2018. Vendi ka bërë përparim të rëndësishëm në arritjen e këtij qëllimi, me rritje të përqindjës nga 30% në 2013 në 88% në 2016 (Arsimi Superhighëay 2017). Shumë shtete janë bashkuar gjithashtu në përpjekjet federale, duke marrë një rol aktiv në ndërtimin e një mjedisi mësimor të pasur me teknologji në shtetet e tyre (Education Superhighëay 2017; Ëatson et al. 2014). Integrimi i teknologjisë në shkolla jo vetëm që siguronte hyrje në internet, por gjithashtu përfshinte përdorimin e mjeteve dhe praktikave teknologjike, duke përfshirë kurse online, përdorimin e pajisjeve të ndryshme në klasa, vlerësim të bazuar në kompjuter dhe softuer adaptiv për nxënësit me nevoja të veçanta. Përfshirë kolektivisht si teknologji mësimore, kjo gamë e gjerë mjetesh dhe praktikash përfshin përdorimin dhe krijimin e proceseve dhe burimeve teknologjike të përshtatshme për të lehtësuar mësimin, angazhimin e nxënësve dhe përmirësimin e rezultateve të të nxënësve (Alliance for Excellent Education, 2011).

Këto iniciativa të Qeverisë Amerikane kishin sjellë ndryshimet e mëdha në arsimin Amerikan. Në një raport të Project Tomorrow (2015) u shfaqën të dhëna konkrete mbi realizimin e projektit kombëtar për futjen e teknologjisë në procesin edukativo arsimor. Të dhënat tregonin se kompjuterët, pajisjet e lëvizshme, si laptopë, smartphone dhe tableta po përmirësonin qasjen e nxënësve dhe arsimtarëve në internet. Studimi i Project Tomorrow (2015) zbuloi se 47% e arsimtarëve në shkollat fillore raportuan se nxënësit e tyre kishin qasje të rregullt në pajisjet e lëvizshme në klasat e tyre. Në aspektin e llojeve të pajisjeve që nxënësit përdorën për punë shkollore gjatë mësimit në shkollë, sondazhi zbuloi se 58% e nxënësve përdorën pajisjen e tyre, të ndjekur nga laptopët e shkollës (32%), Chromebook-et e shkollës (16%) dhe tabletat e shkollës (14 %) (Project Tomorrow, 2015).

Në linjë të njëjtë me Qeverinë Amerikane ishte edhe Qeverisë Britanike që me siguri duke u bazuar në suksesin e modelit Amerikan vendosën qëllime të ngashme sa i përket integritit të teknologjisë në arsim duke inicuar projekt për lidhje të shkollave të tyre me internet të shpejtë, si pjesë e projektit të tyre për modernizim të infrastrukturës teknologjike në shkollat e tyre deri në vitin 2033 (Department for Education, 2019).

Përfundimisht mund të konkludojmë se dixhitalizimi i klasave shkollore është fakt dhe veç më po ndodh nëpër shumë shkolla të Unionit Evropian dhe SHBA, por edhe në vende tjera të botës. Teknologjia në klasë është bërë e patjetërsueshme nëse dëshirojmë që nxënësit të përfitojnë dhe përparojnë. Prandaj, të gjitha përpjekjet e udhëheqësve arsimor në vendin tonë, në të gjitha nivelet, duhet të drejtohen në drejtim të kycjes së institucioneve arsimore sidomos atyre të arsimit fillor, në projekte të ndryshme, si vendore, po ashtu edhe në ato Evropiane, po ashtu edhe të SHBA dhe vendeve tjera të përparuara, për të pajisur shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut me teknologji më të avancuar si dhe me qasje në internet të shpejtë.

### **3.2 Efikasiteti i metodave të mësimdhënies të mbështetura me teknologji**

Në këtë nënkapitull do të shqyrtojmë literaturën e cila ka të bëjë me ndikimin e metodave të mësimdhënies dhe nxënies të mbështetura në pajisje digjitale në klasë dhe efektin që kjo metodologji ka në përmirësimin dhe avancimin e nxënies në shkollat fillore.

Janë bërë shumë studime për të vlerësuar ndikimin e metodave të mësimdhënies që janë bazuar në pajisjet teknologjike dhe burime të tjera për të rritur arritjet edukativo arsimore të fëmijëve në një varg fushash. Pra, ekzistojnë prova shkencore se pajisjet dixhitale, mjetet dhe burimet e ndryshme mbështetëse të procesit të mësimdhënies dhe nxënies kur përdoren në mënyrë efektive rrisin shpejtësinë dhe thellësinë e të mësuarit në shkencë dhe matematikë për nxënësit e moshës fillore dhe të mesme, por edhe në disa aspekte të shkrim-leximit (Social research 2015).

Në vazhdim do të shqyrtojmë disa studime duke filluar nga ai i Higgins et al (2012) që ofrojnë një përmbledhje të gjetjeve nga studimet me modele eksperimentale dhe quasi-eksperimentale, të cilat janë kombinuar në meta-analizat për të vlerësuar ndikimin e metodave të mësimdhënies të mbështetura në pajisje teknologjike në shkolla. Studimi i tyre është përmbledhje e 48 studimeve të cilat sintetizuan studimin empirik të ndikimit të metodave të mësimdhënies me mjete dhe burime dixhitale për arritjen e nxënësve të moshës shkollore (5-18 vjeç). Ata gjetën lidhmëri të qëndrueshme por me efekt më të vogël pozitiv midis të përdorurit e metodave mësimore të mbështetura në pajisje teknologjike dhe rezultatet e të nxënësve. Ndërsa, Harrison et al (2004) identifikuan gjetje statistikisht domethënëse, që ndërlidhin pozitivisht nivelet e larta të përdorimit të metodave mësimore të mbështetura në pajisje teknologjike me arritjet shkollore në çdo fazë shkollore në Angli. Më tutje, Somekh et al (2007) identifikuan një lidhje më të fortë midis niveleve të larta të përdorimit të metodologjisë mësimore të bazuar në teknologji dhe performancës së përmirësuar të shkollës. Ata zbuluan se shkalla e përmirësimit të testeve të bëra me anë të teknologjisë në lëndën e gjuhës angleze në mbarim të arsimit fillor ishte më i shpejtë sesa në fushat krahasuese ekuivalente. Sidoqoftë, Higgins et al (2012) pohojnë se përderisa këto studime tregojnë ndërlidhje pak më të lartë se mesatarja për përdorimin e metodave mësimore të bazuara në teknologji dhe

përmirësimit të të mësuarit të nxënësve ashtu kanë edhe nxënës që dallohen dukshëm në performancën akademike. Me siguri që shkollat që performojnë më mirë kanë më shumë të ngjarë të jenë më të pajisura me teknologji ose më të përgatitur për të investuar në teknologji ose më shumë të motivuar për të përdorur teknologjinë në procesin edukativo arsimor në shkollë.

Në vazhdim do të shohim rezultatet e një studimi të bërë nga Jewitt et al (2011). Këta kanë hulumtuar disa shkolla fillore dhe të mesme në Angli që ishin zbatues së metodologjive inovative të mësimdhënies dhe nxënies të mbështetura në teknologji informative. Përfundimin që studimi i tyre arriti mund të përmbledhet në disa pika si në vijim (Jewitt et al 2011):

- Metodatat inovative nëpërmjet teknologjisë që arsimtarët përdorën në procesin e mësimdhënies u dhanë nxënësve më shumë kohë për mësim aktiv në klasë si dhe jashtë klase.
- Udhëzimet e arsimtarëve për të përdorur pajisjet teknologjike në shtëpi për të vazhduar mësimin edhe jashtë klase dhe për bërjen e detyrave të shtëpisë mundësuan krijimin e hapësirave digjitale të vetë-drejtuar, si blog dhe forume, dhe qasje në lojëra me një përfitim mësimi;
- Arsimtarët duke përdorur burimet dixhitale krijuan hapësira dixhitale më të sigurta për vlerësimin formativ dhe dhënien e informatave kthyesë tek nxënësit.<sup>26</sup>

Nga studimet e përmendura më sipër, duket se teknologjitë dixhitale janë mjete të përshtatshme për të përmirësuar metodologjinë e mësimdhënies dhe nxënies dhe për të përmirësuar dukshëm nxënien. Kjo mbështetet edhe nga studimet dhe meta-analizën e bërë nga Laio et al (2007) të cilët hetuan efektet e mësimdhënies bazuar në teknologji dixhitale në shkollat fillore në Tajvan edhe atë në 11 lëndë të shkollave fillore. Studimet e tyre treguan se metodatat e mësimdhënies të bazuara në teknologji digjitale kanë efekt më të madh në arritjet akademike të nxënësve krahasuar me metodologjinë tradicionale (Laio et al, 2007). Në linjë të njëjtë dhe me gjetje identike janë edhe (Levin&Wadmany, 2008) të cilët bënë një studim trevjeçar në një shkollë. Ata hulumtuan dy aspekte, atë të pikëpamjeve të arsimtarëve mbi metodatat e mësimdhënies dhe nxënies bazuar në teknologji digjitale dhe në praktikatat e tyre më të mira në klasë. Studimi ka qenë eksplorues dhe me kohëzgjatje trevjecare dhe shqyrtoi pikëpamjet e gjashtë mësuesve mbi faktorët që ndikojnë në përdorimin e metodave mësimore bazuar në teknologjinë në klasë. Më saktë, studiuesit hulumtuan mësuesit e klasave 4, 5 dhe 6 për tre vjet, duke studiuar mësuesit si në grup dhe si studime të rasteve individuale. U analizua lidhja midis ndryshimeve që kanë ndodhur në pikëpamjet arsimore të mësuesve dhe praktikatat si rezultat i ekspozimit të tyre në mësimdhënie dhe mësimnxënie bazuar në teknologjinë dixhitale dhe pikëpamjet e tyre mbi faktorët që ndikojnë në integrimin e teknologjisë në metodologjinë inovative. Gjetjet e tyre treguan përmirësim të dukshëm të rezultateve të të mësuarit tek nxënësit që ishin në grupet të cilat u hulumtuan.

<sup>26</sup> <https://writeandimprove.com/>, platforma digjitale që ndihmon arsimtarët e gjuhës angleze të vlerësojnë shkrimin e nxënësve të tyre. Kjo platformë e krijuar nga Cambridge University Press vetëm jep nota dhe siguron informatë kthyesë për nxënësit.



Shtrirja e efektit mund të zvogëlohet nga niveli i aftësisë së mësuesve për të përdorur mjete dhe burime dixhitale të të mësuarit në mënyrë efektive për të arritur rezultatet e të nxënësve. Për të pasur efekt metodat mësimore të mbështetura në teknologji dhe si rrjedhojë për të rritur nivelin e arritjeve akademike të nxënësve duhet që mësuesit të aftësohen dhe të mësojnë mënyrën se si mjetet dhe burimet dixhitale mund të përdoren, mandej përshtatjen e qasjes së tyre ndaj metodologjisë së re të mësimdhënies së bazuar në teknologji si dhe të kuptojnë funksionimin e teknologjisë për të arritur rezultatet e pritura nga procesi i mësimdhënies dhe nxënies. Kjo vlen për të gjitha shkollat.

Duhet patjetër të përmendim edhe hulumtimet që në fakt mohojnë ndikimin e metodave të mësimdhënies bazuar në teknologji në arritjet akademike të nxënësve ose së paku sic thonë studiuesit e tillë ka shumë pak efekt në të nxënësve. Të tillë janë Dede, (2008), Jimmoyiannis, (2008), Tondeur et al, (2008), NEA, (2008), Project Tomorrow, (2011, 2014).

Në vazhdim do të numërojmë disa nga metodat më inovative të cilat i kanë krijuar mësuesit gjatë viteve të fundit dhe se çdo mësues i shkollës 21 duhet të njihet me këto metodologji që ndihmojnë në mësimdhënie dhe nxënie dhe bëjnë që shkollat të performojnë më mirë: (Realinfluencers, 2019):

1. **Klasë e rrokullisur (flipped classroom)** Një qasje pedagogjike inovative e cila dyfishon kohën e mësimit, pasi materialet arsimore studiohen nga nxënësit në shtëpi dhe më pas punohen në klasë (Realinfluencers, 2019). Nxënësit mund të shikojnë video të paravendosur në shtëpi, pastaj të vijnë në shkollë për të bërë detyrat e shtëpisë të pajisur me pyetje dhe të paktën disa njohuri të paraprake (Teach Thought Staff, 2020).

2. **Mësimi nëpërmjet projekteve** - Në thelb të saj, PBL lejon studentët të marrin njohuri dhe aftësi kryesore përmes zhvillimit të projekteve që i përgjigjen problemeve të jetës reale (Realinfluencers, 2019). Sipas Realinfluencers (2019) mësimdhënia e bazuar në projekte ose detyra të integruara, është sot garancia më e mirë didaktike për një zhvillim efektiv të aftësive kryesore, ndërsa gjithashtu merr njohuri për përmbajtjen e kurrikulës.

3. **Mësimi bashkëpunues - "Më të fortë së bashku"** - Ky koncept në fakt ka të bëjë me një mënyrë të thjeshtë të mësuarit bashkëpunues, një metodologji që mësuesit përdorin për të grupuar studentët së bashku dhe, kështu, ndikojnë në të mësuarit në një mënyrë pozitive.

4. **Gamification (mësimi nëpërmjet lojës)** Integrimi i mekanikës së lojës dhe dinamikës në mjediset e mësimit është praktikuar për një kohë të gjatë. Gjatë viteve të fundit për shkak të evolucionit të videolujërave kjo dukuri ka marrë një dimension të pashembullt, dhe është një nga më të përfolurit si një trend aktual dhe i ardhshëm i industrisë EdTech.

5. **Mësimi i bazuar në zgjidhjen e problemeve** - Mësimi i bazuar në zgjidhje të problemeve (PBL) është një proces ciklik mësimi i përbërë nga shumë faza të ndryshme, duke filluar me bërjen e pyetjeve dhe marrjen e njohurive që, nga ana tjetër, çon në më shumë pyetje në një cikël në rritje të kompleksitetit.

6. **Të menduarit e projektimit (Design Thinking)** - Kur zbatohet në klasë ky model bën të mundur që të identifikohen me saktësi më të madhe problemet individuale të secilit nxënës dhe të gjenerojnë në përvojën e tyre arsimore krijimin dhe inovacionin drejt kënaqësisë së të tjerëve.

Në fund do të numërojmë edhe disa sugjerime se si teknologjia ndihmon në procesin edukativo arsimor, gjegjësisht në përmirësimin e metodave mësimore për të arritur qëllimet arsimore. Në këtë drejtim mund të përmendim disa nga mjetet e bashkëpunimit në internet, siç janë (University of Washington - Center for Teaching and Learning, 2020):

- Google Apps, psh Google Meet, Zoom e tjera që lejojnë nxënësit dhe arsimtarët të komunikojnë në kohë reale dhe të ndajnë dokumente në internet.
- PoëerPoint u mundëson arsimtarëve të vendosin fotografi, diagrame, video dhe skedarë me rezolucion të lartë për të shtuar tekstin dhe përmbajtjen e ligjëratave verbale.
- Tabletat mund të lidhen me kompjuterë, projektues dhe cloud, në mënyrë që nxënësit dhe arsimtarët të komunikojnë përmes tekstit, vizatimeve dhe diagrameve.
- Mjetet e menaxhimit të lëndëve mësimore si Canvas lejojnë që arsimtarët të organizojnë të gjitha burimet që nxënësit kanë nevojë (p.sh. planprogramet mësimore, detyrat, leximet, kuizet në internet).
- Telefonat inteligjentë janë një mënyrë e shpejtë dhe e thjeshtë për të anketuar nxënësit gjatë orës së mësimi.
- Platforma Panopto, lejon arsimtarët të regjistrojnë leksione direkt nga kompjuteri i tyre, pa pajisje të hollësishme ose shtesë në klasë.

Si përfundim, mund të konstatojmë se ekzistojnë shumë metoda të mësimdhënies dhe nxënies të bazuara në teknologji dixhitale dhe platforma të ndryshme dixhitale që arsimtarët e shkollave fillore mund të përdorin për të arritur qëllimet e tyre në klasë. Po ashtu, mund të konstatojmë se nuk ekziston një metodë e vetme që do ta kishim dalluar dhe do e kishim sugjeruar për ta përdorur në klasë pasi nuk ka metodë të vetme më të mirë. Nga këtu del edhe përgjegjësia e gjithsecilit arsimtar dhe aftësitë e tyre profesionale që të dijnë se si dhe kur të përdorë të gjitha këto qasje të ndryshme inovative. Nuk ka asnjë mënyrë të vetme më të mirë të mësimdhënies dhe kjo është edhe më e vërtetë në shekullin XXI sesa në të kaluarën duke patur parasysh burimet e shumta digjitale. E vetmja gjë që ngel është që sot mësimdhënësit të dinë se si të kombinojnë metodat duke u bazuar në teknologjinë digjitale me kontekstin e mësimi dhe qëllimet e mësimdhënies. Po ashtu, sot mësimdhënësit duhet ekuilibruar rregullimin e jashtëm nga mësuesi dhe vetë-rregullimin nga nxënësi ku përgjatë kohës humb ekuilibri duke vënë peshën tek vetë-

rregullimi gjegjësisht tek aftësimi i nxënësit për të mësuar vetëm duke përdorur teknologjinë dixhitale dhe duke hulumtuar tematikat e mësuara paraprakisht.

### **3.3 Përfitimet e arsimtarëve dhe nxënësve nga përdorimi i teknologjisë në procesin edukativo arsimor**

Në nënkapitullin 3.2 rradhitëm disa nga mjetet dhe pajisjet teknologjike në klasë si dhe lloj lloj aplikacionesh të internetit dhe aplikacionesh të krijuara posaçërisht për të ndihmuar arsimtarët të bëjnë atë që bëjnë më së miri. Shumica e arsimtarëve që përdorin teknologjinë në klasë do të bien dakord se kohën e fundit nuk mund të paramendohet mësimdhënia pa u mbështetur në burimet teknologjike.

Krijuesit e politikave dhe studiuesit arsimor në tërë botën përmendin shumë përfitime nga të mësuarit nëpërmjet teknologjisë informative, të cilat përfshijnë rritjen e qasjes në burime të ndryshme, personalizimin e të mësuarit dhe sigurimin e ndihmës për nxënësit në procesin e të mësuarit (Bakia et al. 2012; Watson et al. 2013).

Të gjithë ne jemi dëshmitar se kohën e fundit si nxënësit ashtu edhe arsimtarët më së te përmirë përdorin lap topa, tableta dhe pajisje të tjera mobile për të ligjeruar si dhe për të mësuar. Në mënyrë të veçantë telefonat inteligjentë po bëhen një mjet gjithnjë e më i zakonshëm në klasë, dhe më shumë nxënës presin që të kenë informacione thelbësore në dispozicion në celular. Pra, pritjet e të dy palëve në shkollë janë që teknologjia digjitale tu mundësojë atyre përfitime të ndryshme si akademike apo profesionale, po ashtu edhe private.

Në vazhdim do të nxjerrim në pah ca përfitime që teknologjia u mundëson si arsimtarëve po ashtu edhe nxënësve në shkolla.

Sipas (Tierney, 2020) një nga përfitimet më të mëdha të përdorimit të teknologjisë në klasë është se kursen kohë. Një numër aplikacionesh janë krijuar për të ndihmuar mësuesit të marrin pjesë në mënyrë që detyra të mos marrë kohë. Mandej, nuk ka nevojë më arsimtari të përgadit aktivitete të printuara pasi nuk është më e nevojshme kur nxënësit mund të hyjnë në internet dhe të shohin aktivitetet e planifikuara nga arsimtari.

Më tej, përfitim tjetër është ‘vlerësimi’. Teknologjia digjitale mundëson interpretim të përgjigjeve dhe notim masiv të nxënësve si psh testimi nëpërmjet Google Docs ku pasi nxënësit të bëjnë testin përgjigjet i marrin menjëherë, si dhe rezultatet e testit u dërgohen menjëherë pasi të shtypin butonin ‘Dorëzo’.

Shumë aplikacione japin raporte arsimtarëve për statusin e e nxënësve në mënyrë që ata të mund të përcjellin përparimin e secilit nxënës. Këto raporte tregojnë gjithashtu fusha të përmirësimit, duke lejuar arsimtarët të identifikojnë nevojat e nxënësve gjatë të mësuarit në fillim të vitit. Përveç që e bën

notimin më të lehtë për arsimtarët, teknologjia i ndihmon nxënësit të marrin ndihmën dhe vëmendjen e nevojshme (Tierney, 2020).

Më tutje, interneti është plot e përplot me plane mësimore të gatshme që arsimtarë nëpër vende të shumta të botës i publikojnë online dhe kështu ua lehtësojnë punën atyre që kanë nevojë për plane mësimore. Interneti, po ashtu është plot frymëzim dhe ide nga arsimtarë të tjerë për përzgjedhje të aktiviteteve të ndryshme si dhe metodologji të zbatimit të atyre aktiviteteve duke përdorur teknologji informative në klasë. Ruajtja dhe shkëmbimi i mësimave në re (cloud) lejon mësuesit të hyjnë në mësim në çdo kohë, nga kudo.

Përvec kësaj, arsimtarët mund të përdorin Google Drive dhe aplikacione të tjera 'cloud' për redaktim dhe notim më të shpejtë. Kur studentët paraqesin punën e tyre në internet, mësuesit mund ta përdorin atë lehtësisht pa pasur nevojë të bëjnë letra. Kjo krijon një rrjedhë pune më domethënëse për rishikimin midis arsimtarëve dhe nxënësve sepse arsimtarët mund të shohin saktësisht se çfarë ndryshojnë nxënësit. Reja (cloud) u mundëson studentëve të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin edhe për detyra dhe projekte (Tierney, 2020).

Sipas (Tierney, 2020) mësuesit gjithashtu mund të përdorin sinjalizime elektronike dhe tekst automatik për të komunikuar me një numër të madh të prindërve në një çast. Dhe informacioni për vonesat dhe mbylljet e shkollave mund të dërgohen shpejt dhe me efikasitet me teknologji.

Teknologjia u mundëson nxënësve të lidhen me nxënës të tjerë në klasë si dhe me njerëz të tjerë në mbarë globin. Të mësuarit se si të përdorin mjetet dixhitale për të bashkëpunuar në projekte, përgatit nxënësit për pothuajse çdo karrierë. Pastaj, lidhja me nxënës në pjesë të tjera të botës nxit mësimin kulturor dhe u mëson nxënësve se si të punojnë me njerëz që janë të ndryshëm nga ata. Teknologjia i lidh nxënësit me klasa të tjera në vende të ndryshme të globit. Të mësuarit se si nxënësit e tjerë jetojnë, promovojnë mirëkuptimin kulturor dhe zvogëlojnë frikën nga ata që janë të ndryshëm (Tierney, 2020).

Më tutje, sipas Tierney (2020) uebfaqet në klasë janë aplikacione ku nxënësit mund të nxisin lidhjen mes nxënësve dhe të krijojnë një vend që ata të bashkëpunojnë në projekte në grup. Ata gjithashtu përfitojnë nga nxënësit duke krijuar një ndjenjë të përbashkët të përkatësisë dhe komunitetit. Uebfaqet, të cilat zakonisht janë të mbushura me punë të nxënësve, azhurnime në klasë dhe detyra, imitojnë atë që dëshironi të jeni pjesë e një forumi ose grupi në internet. Për shembull, Skype siguron një mënyrë për nxënësit që të zhvillojnë takime virtuale me shokët e klasës nga kudo në botë. Me Google Drive, studentët lehtë mund të ndajnë dhe modifikojnë projekte me njëri-tjetrin.

Interneti lidh nxënësit me arkivat nga e gjithë bota. Nxënësit mund të mësojnë rreth botës së tyre përmes imazheve, videove dhe arkivave të tekstit. Interneti gjithashtu mund të ndriçojë të kaluarën. Hyrja në arkivat historikë i bën mësimet e historisë më të rëndësishme dhe më tërheqëse (Tierney, 2020). Një profesor i gjeologjisë merr nxënësit e tij/ saj në një turne virtuale në Parkun Kombëtar

‘Grand Canyon’ në SHBA. Një mësues i historisë shëtit nxënësit e tij nëpër korridoret dhe historinë e Shtëpisë së Bardhë. Teknologjia lejon arsimtarët të heqin pengesat fizike të klasës, duke u ofruar nxënësve një mënyrë për të lidhur kurrikulën me botën reale (Panworld Education, 2017).

Meqenëse mësimi dixhital është shumë më interaktiv dhe i paharrueshëm sesa librat shkollor ose ligjëratat e njëanshme, ato ofrojnë një kontekst më të mirë, një sens më të madh të perspektivës dhe aktivitete më tërheqëse sesa metodat tradicionale të arsimit. Kjo lejon nxënësit të lidhen më mirë me materialin mësimor. Për më tepër, ata shpesh ofrojnë një mënyrë më interesante dhe përfshirëse për të tretur informacionet (Panworld Education, 2017).

Arsimimi Panworld (Panworld Education, 2017) ofron mjete të planifikimit të mësimi për arsimtarët, duke i bërë më të lehtë detyrat e tyre. Arsimtarët gjithashtu mund të bashkohen në komunitetet e mësimi profesional në internet për të bërë pyetje dhe shkëmbyer këshilla dhe të qëndrojnë të lidhur me një komunitet global të arsimtarëve.

Përveç arsimtarëve, prindërit mund të përdorin aktivitete interaktive për të inkurajuar interesin e fëmijës së tyre për të mësuar pasi lojërat e bëjnë procesin shumë më të këndshëm dhe interesant. Prindërit gjithashtu mund të eksplorojnë aktivitetet e të mësuarit në internet me fëmijën e tyre, të cilat mund të shërbejnë si një shtesë e asaj që ata po mësojnë në klasat e tyre. Mjetet dhe teknologjia e të mësuarit dixhital ofrojnë kënaqësi për fëmijët, si dhe përfitime të shumta në drejtim të zhvillimit të mirëqenies së një fëmije. Të gjithë përfitojnë me dixhitalizimin e të mësuarit (Panworld Education, 2017).

Ligjëratat tradicionale mund të ekzistojnë ende së bashku me mjetet dhe teknologjinë e mësimi, por materialet e ligjëratave duhet të sigurohen si plotësim i aktiviteteve në klasë dhe të zhvendosen në internet për studentët që të referohen jashtë klasës. Mësimi duhet të vazhdojë edhe pas mbarimit të orëve në shkollë. Koha në klasë përdoret më mirë për diskutimin e kurrikulës, përfshirjen në aktivitete me ekipe dhe përfundimin e projekteve në klasë. Duke i ndihmuar fëmijët të mendojnë jashtë mënyrave të tyre të të mësuarit, mësimi dixhital frymëzon kreativitetin dhe i lejon fëmijët të ndiejnë një ndjenjë të arritjes që inkurajon mësimin e mëtutjeshëm (Panworld Education, 2017).

Nxënësit që kanë problem me të kuptuarit e mësimi të caktuar mund të kërkojnë një video mësimore në internet. Videot ose përmbajtja e drejtpërdrejtë mund të ofrojnë një qasje alternative për një mendim dhe kuptim më të mirë të një koncepti ose një teme. Këto video mund të lejojnë një qasje interesante dhe interaktive për të mësuar që mund të tretet më lehtë (All Buyer Blog Articles, 2019)

Teknologjia jo vetëm që lejon arsimtarët të përgatisin ushtrime praktike në mënyrë produktive, por gjithashtu u lejon atyre të matin më mirë përparimin e nxënësve të tyre.

Nga këndvështrimi praktik, librat elektronikë u kursejnë nxënësve para dhe barra për të mbledhur në shtëpi një grumbull librash. Meqenëse shumica e nxënësve kanë një tabletë që mund të sjellin kudo, materiali dixhital i lëndës mësimore dhe librat janë të përshtatshëm.

Korrespondenca joefektive mes mësuesve dhe nxënësve mund të jetë pengesë për të mësuarit. Prandaj teknologjia lehtëson komunikimi mes arsimtarëve dhe nxënësve, pasi arsimtarët mund të postojnë detyra në çdo kohë dhe të japin informatë kthyesë si dhe nxënësit mund të dorëzojnë detyrat dhe të kërkojnë ndihmë dhe sqarime nga arsimtarët në çdo kohë edhe jashtë orarit shkollor.

Natyrisht, të mësuarit e vetë-udhëhequr është një tjetër avantazh i madh që nxënësit vlerësojnë me integrimin e teknologjisë në industrinë e arsimit. Përkundër faktit se ka disa nxënës që shpjetë kuptojnë konceptet e reja, ka të tjerë që duhet të lenë mënjatë kohë të konsiderueshme për të asimiluar një mendim. Nxënës të tillë janë të bekuar me mundësinë që teknologjia të jetë pjesë e jetës së tyre pasi ata tani ata mund të mbajnë ritmin me bashkëmoshatarët e tyre duke përdorur burimet teknologjike në internet për të mësuar ato koncepte të reja me ritmin e tyre dhe të ushtrojnë në shtëpi derisa të kuptojnë ato koncepte. Kjo gjë më parë nuk ka pasur gjasa të bëhet prandaj edhe shumë nxënës kanë ngecur në mësimet e tyre krahasuar me nxënësit që shpejtë mësojnë (All Buyer Blog Articles, 2019).

Duke patur parasysh këtë fakt që jo dy nxënës mësojnë në të njëjtën mënyrë me teknologjinë arsimtarët mund të adresojnë larminë në stilet e të mësuarit. Një rrjet angazhimi si 'Bluepulse' ndihmon arsimtarët të zbulojnë se cilat stile të mësimdhënies funksionojnë më mirë duke identifikuar nevojat e nxënësve bazuar në reagimet në kohë reale. Plani mund të përshtatet në çdo skenar të të mësuarit, përfshirë mësimin në distancë, duke lejuar arsimtarët të lidhen dhe të angazhohen me çdo nxënës, pavarësisht se ku janë.

Si përfundim mund të themi se përfitimet nga teknologjia digjitale janë të shumta. Në përdorim vetëm tre burime të cilat numëronin një numër të vogël të përfitimeve që arsimtarët dhe nxënësit mund të kenë nga përdorimi i mjeteve digjitale dhe internetit në mënyrën e duhur.

Prandaj, sa më parë që është e mundur, politikëbërësit në Republikën e Maqedonisë së Veriut duhet të mendojnë në drejtim të alokimit edhe më të madh të mjeteve buxhetore për investim në teknologjinë digjitale dhe furnizimin e të gjitha shkollave fillore me pajisje digjitale duke përfshirë edhe sigurimin e laptopëve për çdo nxënës në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### **3.4 Përdorimi i teknologjisë informative në klasë si mjet mësimor (përparësi dhe mangësi)**

Bota po bëhet një vend i shkëlqyeshëm dhe i përshtatshëm për të jetuar për shkak të avancimit teknologjik. Teknologjia po bën jetat tona më të mira dhe më të lehta, veçanërisht në fushat e shkencës, mjekësisë dhe arsimit. E sa i përket kësaj të fundit, shumë shkolla që e kanë kuptuar përparësitë që

teknologjia ka në procesin edukativo arsimor po shfrytëzojnë teknologjinë në mënyrë efektive dhe në kontekst të arsimit të avancuar nëpërmjet teknologjisë digjitale.

Në vazhdim do të shënojmë disa nga përparësitë që teknologjia sjell në arsim, gjegjësisht në procesin edukativo arsimor i cili ndodh në klasat e shkollave (Pedro, 2019):

1. Promovon të mësuarit e pavarur tek nxënësit
2. Përgatit nxënësit për të ardhmen
3. Ka potencial për të ulur çmimet e librave shkollorë dhe shkollimit
4. Lejon arsimtarët të krijojnë një mënyrë interesante për të arsimuar nxënësit -
5. Inkurajon zhvillimin e metodave të reja të mësimdhënies
6. Teknologjia u mundëson arsimtarëve të përfshin të gjithë katëgoritë e nxënësve në mësim, përfshirë ata që mësojnë ngadal ose ata nxënës që kanë nevojë të veçanta.
7. Nxënësit mund të praktikojnë aftësi bashkëpunimi duke u përfshirë në aktivitete të ndryshme në internet (Savvidis, 2020).
8. Duke përdorur teknologjinë në klasë, arsimtarët dhe nxënësit mund të zhvillojnë aftësi thelbësore për shekullin XXI (Savvidis, 2020).

Me siguri që ka edhe më tepër përparësi gjatë përdorimit të teknologjisë në shkollë. Dhe më tej duhet të kemi parasysh se si çdo gjë në këtë botë edhe teknologjia përveç përparësive ka edhe mangësitë e saja. Në vazhdim do të numërojmë disa nga mangësitë që gjetëm gjatë shqyrtimit të literaturës (Pedro, 2019):

1. Rezulton në mungesë interesi për të mësuar dhe studiuar. Për shkak se gjithçka është tani e arritshme në internet ose përmes të dhënave të ruajtura në një kompjuter ose pajisje mobile, nxënësit ka të ngjarë të zhvillojnë zakone të dobëta mësimi dhe një qëndrim dembel ndaj arsimit. Disa prej tyre madje mund të mendojnë se mund edhe ta shmangin shkollimin sepse mund të gjejnë përgjigje dhe mësimë në internet.
2. Ndërsa kompjutorët vërtetojnë se janë një mjet i paçmuar arsimor, ai gjithashtu mund të jetë një burim problemesh. Kjo është veçanërisht e vërtetë për nxënësit, të cilëve u mungojnë aftësitë e nevojshme për të maksimizuar funksionalitetet e një pajisjeje. Problemet teknike dhe keqfunksionimet e kompjuterit mund të shkaktojnë humbje të detyrave dhe materialeve të tjera, duke rezultuar në nivele të larta stresi, të cilat nxënësit nuk preferojnë të përjetojnë. Dallimi në shpejtësinë e internetit dhe aftësitë e një pajisje gjithashtu mund të çojë në vështirësi të caktuara që do të demotivojnë nxënësit. Shtoni kësaj gjëje që ata do të zbulojnë në internet, të cilat janë plotësisht të palidhura me shkollën dhe arsimin, dhe do të shpërqendrohen pa fund.

3. Konsumatorizmi na ka mësuar që teknologjitë, nga kompjuterët deri te pajisjet e lëvizshme, janë parë gjerësisht si mjete për tu argëtuar sesa për të mësuar. Librat shkollor, nga ana tjetër, shihen si mjete për të mësuar. Pra, midis një tablete dhe një libri shkollor, nxënësit ka të ngjarë të tërhiqen drejt mësimit kur lexojnë një libër, ndërsa ka të ngjarë të përdorin një tabletë për të luajtur lojëra ose të kalojnë kohën në media sociale.
4. Që arsimtarët të qëndrojnë në krah me teknologjinë e arsimit, ata do të duhet të aftësohen. Ata që kanë mësuar gjatë gjithë jetës së tyre duke përdorur metoda tradicionale, nuk mund të jenë shumë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve që aplikohen. Ata madje mund ta shohin atë si një kërcënim për sigurinë e tyre të punës dhe të shmangin teknologjinë krejtësisht. Në fakt, shumica e arsimtarëve besojnë se përdorimi i vazhdueshëm i teknologjisë dixhitale po ndikon në hapësirën e vëmendjes së një nxënësi dhe aftësinë e tij për të kryer detyra sfiduese. Megjithatë një besim i tillë është subjektiv, studiuesit, ekspertët dhe mësuesit të gjithë pajtohen që teknologjia ka ndryshuar mënyrën e mësimit të nxënësve.
5. Shpërqëndrimi i nxënësve - Telefonat inteligjentë kanë një reputacion të keq në klasë dhe ka pasur raste të forta për ndalimin e tyre në shkolla për shkak të keqpërdorimit të tyre. Hulumtimet tregojnë se kur nxënësit përdornin telefonat e tyre gjatë kohës së orës së mësimit, 42% të kohës që nxënësit kaluan në celularët e tyre inteligjentë në klasë, ishte për të shkruar tekst, të etet, ose angazhoheshin në mediat sociale dhe jo në mësim (Vieë Sonic Library, 2020).
6. Kushton shtrenjtë - Asgjë në këtë botë nuk është e lirë, dhe blerja e pajisjeve elektronike për një klasë është e shtrenjtë. Ndërsa nuk ka asnjë mënyrë për të shmangur shpenzimin e parave për modernizimin e një klase, të paktën është e mundur të maksimizohet kostoja totale e pronësisë duke instaluar pajisje me jetëgjatësi më të madhe dhe mirëmbajtje të zvogëluar (View Sonic Library, 2020).

Në fund mund të konstatojmë se përparësitë tejkalojnë mangësitë e përdorimit të teknologjisë në shkollë, gjegjësisht në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në klasë. Sfidat gjatë përvetësimit të teknologjisë nga ana e arsimtarëve dhe nxënësve me siguri se do vazhdojnë por rruga drejt digjitalizimit të shkollave duhet të vazhdojë. Qëllimi i arsimit të shekullit më të ri është të prodhojmë gjenerata të shkathta që do përqafojnë sfidat e së ardhmës dhe kjo gjë bëhet vetëm duke iu përshtatur avancimit teknologjik dhe duke përdorur atë në vendin ku përgaditen gjeneratat e ardhshme e ai vend quhet shkolla. Prandaj, të gjitha përpjekjet duhet fokusuar nga digjitalizimi i shkollave tona në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të mundur të mësuarit nëpërmjet teknologjisë digjitale. Në fund të fundit, arsimi ka të bëjë me të mësuarit, dhe të gjithë duhet të jemi të hapur për procesin e vazhdueshëm të përmirësimit që vjen me të.



### **3.5 Roli dhe sfidat e arsimtarëve dhe nxënësve në zbatimin e paradigms bashkëkohore të mësimdhënies**

Paradigma e re e mësimdhënies e cila bazohet në përdorimin e teknologjisë digjitale është ndryshimi më i madh që i ka ndodhë ndonjëherë arsimit. Sic përmendëm më lartë teknologjia ka përparësitë dhe mangësitë e saja kur përdoret në arsim. Dhe për vite e dekada të tëra politikëbërësit në nivele të ndryshme, drejtorët, arsimtarët, prindërit dhe nxënësit kanë peshuar përfitimet e mundshme të teknologjisë në arsim kundër rreziqeve dhe pasojave të tij.

Teknologjia mundëson eksperimentimin në procesin e mësimdhënies dhe nxënies duke demokratizuar klasën dhe duke angazhuar nxënësit më mirë në procesin edukativ arsimor.

Paradigma e re ose bashkëkohore e të mësuarit përmban më tepër elemente por ajo që e dallon atë nga paradigma tradicionale është mësimi aktiv. Mësimi aktiv i angazhon nxënësit dhe i nxit ata që të mësojnë nëpërmjet metodologjisë induktive, që me fjalë të tjera do të thotë që nxënësit duke identifikuar dhe duke vërejtur modele dhe struktura të ndryshme gjatë të mësuarit ose trajtimit të ndonjë teme mësimore në klasë vijnë deri te rregullat. Pra, mësimi aktiv u ndihmon nxënësve që të nxjerrin kuptim të thelluar të lëndës gjegjësisht të praktikojnë të mësuarit e thelluar (Adler, 1999:Belias et al, 2013).

Për më tepër, është argumentuar se metodat induktive si pjesë e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies rrisin konsolidimin dhe ruajtjen apo mbajtjen në mend të një mësimi, si dhe vlerësimi i performancës ndikon pozitivisht tek nxënësit në të ardhmen duke u mundësuar atyre shtigje më të mira në karrierë (Kelley et al.,1999: Dimitrios, 2003).

Ndërsa, Bonwell & Eison (1991:Dimitrios, 2003) kanë propozuar disa teknika për të mbështetur dhe promovojnë mësimin aktiv e ato janë:

- Përdorimi i mediave vizive gjatë ligjëratave (video, multimedia, slajde).
- Inkurajimi i studentëve për të marrë shënime gjatë ligjëratave.
- Përdorimi i kompjuterave gjatë mësimit.
- Inkurajimi i studentëve për të zgjidhur probleme gjatë studimit të rastit (pra studim rasti).
- Përdorimi i simulimeve, interpretimi i roleve dhe grafikëve të ndryshëm.
- Përdorimi i mësimit bashkëpunues.

Sipas Vrasidas (2010) përpjekjet për të integruar teknologjinë në arsim provokojnë një sërë përgjigjesh nga arsimtarët që shkojnë nga entuziazmi dhe skepticizmi deri tek frika dhe pasiguria. Një histori e gjatë e përdorimit të teknologjisë në arsim zbulon se reagimi i parë është përdorimi i teknologjisë së re në të njëjtat mënyra tradicionale si teknologjia e vjetër. Kurrikulat e vjetra dhe qasjet pedagogjike duhet të reformohen, dhe nëse është e nevojshme të zëvendësohen, për të përfituar nga mundësitë e

teknologjisë më të re digjitale. Hulumtimet kanë treguar që kompjuterët përdoren më rrallë në klasë apo shkolla sesa në organizata tjera. Në mënyrë që risitë në arsim të kenë sukses, kërkohet të zbatohen qasje sistematike dhe bashkëpunim i të gjitha palëve të interesit, përfshirë arsimtarët (Kuban, 2001; Vrasidas & Glass, 2004, 2005; Vrasidas, 2010).

Megjithë miratimin gjithnjë e më të gjerë të teknologjive në pothuajse çdo aspekt të arsimit fillor dhe sfidat e rëndësishme që po paraqiten gjatë përdorimit të teknologjisë në klasë po parandalojnë zbatimin e përhapur efektiv të paradigmes së re të mësimdhënies. Sipas studiuesve, megjithëse disa nga ato sfida janë sistematike dhe disa të lidhura me vetë teknologjitë, arsimtarët dhe drejtuesit e arsimit ndajnë gjithashtu fajin. "NMC Horizon Report: 2013 K-12 Edition", e vendosur së bashku nga Neë Media Consortium si pjesë e Projektit Horizon, identifikon çështjet kryesore që shfaqen në procesin e zbatimit të paradigmes së re të mësimdhënies duke përdorur hulumtime të ndryshme të bëra nga praktikues të njohur ndërkombëtarisht dhe ekspertë në tech. Ndër ato çështje janë sfidat që paraqesin kufizime të konsiderueshme në adoptimin e teknologjisë në arsim, sic janë (Nagel, 2013):

**Sfida 1:** Zhvillimi profesional i arsimtarëve për të përdorur teknologjinë në mënyrë të duhur efikase në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.

**Sfida 2:** Rezistenca ndaj ndryshimit të metodologjisë së mësimdhënies prej asaj tradicionale në atë të bazuar në teknologji, gjegjësisht rezistenca ndaj teknologjisë.

**Sfida 3** - Institucionet e arsimit fillor janë më të fundit në arsimin në distancë në shumicën e rasteve, por epidemia nxiti edhe këtë formë të përdoret në arsimin fillor.

**Sfida 4:** Lidhur me sfidën 3, modelet e ngurta të ligjërimit dhe të testimit nuk po i sfidojnë nxënësit të eksperimentojnë dhe të përfshihen në mësim joformal.

**Sfida 5:** Dështimet e të mësuarit të personalizuar, gjegjësisht arsimtarët e arsimit fillor duket se shohin nevojën për mësim të personalizuar por atyre nuk u jepen mjetet që u duhen për ta realizuar atë, ose mjetet adekuate thjesht nuk ekzistojnë.

**Sfida 6:** Dështimi i përdorimit të teknologjisë për të dhënë vlerësime efektive formative, gjegjësisht vlerësimin e vazhdueshëm.

Më tej sipas autorë të tjerë sfida tjera me të cilat arsimtarët ballafaqohen janë: (Bingimlas:2009)

#### **1. Mungesa e vetëbesimit për të përdorur teknologjinë digjitale në mësimdhënie**

Shumë hulumtime shfaqin mungesën e vetëbesimit si një sfidë me të cilën ballafaqohen arsimtarët për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie. Sipas Dawes (2001; Bingimlas, 2009) ky është një faktor që mund edhe të llogaritet si një pengesë me të cilën arsimtarët ballafaqohen kur ata duhet të përdorin teknologjinë në mësimdhënie.

2. **Mungesa e aftësisë së arsimtarëve për të përdorur teknologji digjitale në klasë** – Sipas (Becta, 2004, Pelgrum, 2001, Al-Oteawi, 2002, Albirini, 2006, Al-Alwani, 2005, Almohaissin, 2006: Bingimlas:2009) paaftësia e arsimtarëve për të përdorur teknologjinë informative në klasë është edhe një sfidë apo faktor që pengon zbatimin e paradigmës së re të mësimdhënies në klasë.
3. **Rezistenca ndaj ndryshimit të paradigmave të mësimdhënies nga ajo tradicionale në atë bazuar në teknologji** – Sipas hulumtimeve të shumta që janë bërë nëpër shkolla për të identifikuar faktorët që pengojnë zbatimin e paradigmës së re të mësimdhënies bazuar në teknologji informative në klasë qëndrimi dhe rezistenca e arsimtarëve ndaj ndryshimeve janë dy faktorët kryesor për mos përdorimin e teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në klasë (Cox et al, 1999a; Watson, 1999, Earle, 2002, Becta, 2004, Gomes, 2005, Schoepp, 2005, Bingimlas:2009).
4. **Mungesë e kohës** – Ekzistojnë studime që tregojnë se ka shumë arsimtarë që kanë aftësi dhe dije që të përdorin teknologjinë digjitale mirëpo nuk kanë kohë për të ligjeruar nëpërmjet teknologjisë, gjegjësisht për tu përgaditur duke kërkuar faqe të ndryshme të internetit apo për të përdorur pajisje të ndryshme teknologjike në klasë (Al-Alwani, 2005, Becta, 2004, Beggs, 2000, Schoepp, 2005, Sicilia, 2005: Bingimlas:2009).
5. **Mungesë e trajnimit adekuat për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie** – Sipas (Pelgrum, 2001, Albirini, 2006, Ozden, 2007, Toprakci, 2006, Beggs, 2000, Schoepp, 2005, Sicilia, 2005: Bingimlas:2009) mungesa e mundësive për trajnim është njëri ndër faktorët kryesor për mostrajnimin e arsimtarëve për të përdorur teknologjinë informative në klasë. Sipas Becta (2004: Bingimlas:2009) është me rëndësi që arsimtarët të trajnohen në zbatimin e paradigmës së re të mësimdhënies se sa vetëm në përdorimin e teknologjisë digjitale.
6. **Mungesë e qasjes në burime teknologjike** – Ka disa studime që nxjerrin në pah mungesën e qasjes në burime teknologjike përfshirë edhe ato në shtëpi si faktorë që pengon zbatimin e paradigmës së re të mësimdhënies bazuar në teknologji (Sicilia, 2005: Bingimlas:2009). Për shembull Sicilia (2005: Bingimlas:2009) në studimin e saj nxjerrë në pah se shumë arsimtarë të shumë shkollave janë ankuar për mungesë të kompjuterëve dhe se për të mundur ata që të përdorin një kompjuter në shkollë është dashur që të rezervojnë një parakohe, gjegjësisht disa ditë para. Po ashtu edhe më demotivuese për arsimtarët kishte qenë interneti i ngadalshëm, mospasja e qasjes në internet, mungesa e pajisjeve dixhitale në klasë, mungesa e softverave, etj (Sicilia (2005: Bingimlas:2009).
7. **Mungesë e mbështetjes teknike** – Pa mbështetje teknike dhe klasa pa pajisje të shumta teknologjike nuk mund të ketë zbatim efektiv të paradigmës së re të mësimdhënies bazuar në teknologji (Lewis, 2003: Bingimlas:2009). Sipas Pelgrum (2001: Bingimlas:2009) mungesa e

mbështetjes teknike në shkollat fillore dhe të mesme është pengesa kryesore e moszbatimit të paradigmës së re të mësimdhënies bazuar në teknologji.

Si përfundim mund të konstatojmë se zbatimi i paradigmës së re të mësimdhënies bazuar në teknologji është një proces i cili ka has, është duke has dhe do të has në pengesa edhe në të ardhmen. Ky proces nuk do jetë i lehtë e as i lirë, por është i patjetërsueshëm nëse jemi të interesuar për të avancuar arsimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe së paku tu afrohem sistemeve më të avancuara arsimore në të cilat teknologjia është inkorporuar thellë jo vetëm në objektet dhe kurrikulat e tyre shkollore por është ngulitur thellë në mendësinë e tyre dhe për ato vende më nuk mund të paramendohet arsimi pa mbështetjen e teknologjisë digjitale në klasë. Roli i arsimtarëve është të bëjnë përpjekje të përdorin ato pajisje që kanë në dispozicion dhe të bëjnë maksimumin për të zbatuar aq sa munden paradigmën e re të mësimdhënies. E sa i përket sfidave ato arsimtarët nuk mund t'i tejkalojnë vetëm pa ndihmën e autoriteteve shkollore, komunale dhe shtetërore.

#### **Kapitulli 4: Hulumtimi dhe analiza e të dhënave nga hulumtimi**

##### **4.1. Rezultatet nga hulumtimi: paraqitja grafike e rezultateve nga hulumtimi, interpretimi i pyetësorëve dhe intervistave**

Në Kapitullin e 4 do të analizojmë dhe interpretojmë të dhënat që kemi mbledhur nga pyetësorët dhe intervistat që kemi bërë me Drejtorët dhe stafin e shkollave fillore Bratstvo-Migjeni dhe Kirili dhe Metodij në komunën e Tetovës. Shfrytëzoj rastin të faleminderoj drejtorët, arsimtarët, nxënësit, anëtarët e këshillëve të shkollave, anëtarët e këshillit të prindërve, dhe administratorët e shkollave.


Analiza dhe interpretimi i të dhënave do jenë të ndara për të dy shkollat fillore. Së pari do të analizojmë dhe interpretojmë të dhënat që kanë dalë nga hulumtimi i bërë në shkollën fillore Bratstvo Migjeni e më pas do të analizojmë dhe interpretojmë të dhënat që kanë dalë nga hulumtimi i bërë në shkollën fillore Kirili dhe Metodij. Në fund do të bëjmë një krahasim mes dy shkollave fillore duke analizuar rezultatet nga analiza dhe interpretimi i të dhënave nga hulumtimet e bëra në të dy shkollat.

Do të filljmë me interpretimin e të dhënave nga hulumtimi i bërë me 25 arsimtarë në shkollën fillore Bratstvo-Migjeni. Duhet të potencojmë faktin që të dhënat janë mbledhur online pasi shkollat fizikisht ishin të mbyllura për shkak situatës me pandeminë e virusit Korona në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi kryesor i këtij pyetësi ishte të mblidhen të dhëna faktike mbi gjendjen aktuale në shkollat e komunës së Tetovës sa i përket zbatimit të paradigmes së re të mësimdhënies dhe nxënies bazuar në teknologjinë digjhitale në shkollat fillore të komunës së Tetovës nga ana e arsimtarëve. Në rastin konkret kemi mbledhur të dhëna nga arsimtarët e shkollës fillore Bratstvo-Migjeni.

Në pyetjen e parë të pyetësit kishim për qëllim të mësojmë më tepër për situatën me pajisjet kompjuterike në shkollën fillore Bratstvo-Migjeni si dhe përdorimin e tyre në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollë. Sic shihet në tabelën 1.1, më poshtë vetëm 16% e arsimtarëve të pyetur nëse kanë kompjutor në klasë dhe nëse i përdorin ato janë përgjigjur me pajtohem plotësisht/ pajtohem ndërsa 68% të anketuarve janë përgjigjur që nuk pajtohen plotësisht/ nuk pajtohen. Këto përgjigje janë indikatorë apo tregues që në fakt shkolla nuk posedon kompjutorë të mjaftueshëm në shkollë.

### 1.1 Kemi kompjutorë në secilën klasë dhe mund t'i përdorim ato në mësim




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket pyetjes rreth internetit në shkollë të dhënat nga tabela 1.2 më poshtë tregojnë që 56% e arsimtarëve të anketuar janë përgjigjur me pajtohem, ndërsa 28% nuk janë pajtuar që ka internet në

shkollë. Ka edhe të tillë që janë neutral dhe përqindja e tyre është 16%. Këto të dhëna prapë tregojnë që edhe nëse ka internet në shkollë me siguri nuk i plotëson kërkesat e të gjithë arsimtarëve, gjegjësisht numri i rezervuar i arsimtarëve dhe ata që nuk pajtohen, që nuk është numër i vogël, tregon që në fakt nuk përdoret internet për ndonjë arsye, ose është I ngadalshëm ose nuk kanë pajisje kompjuterike në klasa.


## 1.2 Kemi internet në shkollë dhe e përdorim atë në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket pajisjeve tjera në klasë sic janë projektorët dhe pajisjet tjera digjitale që eventualisht arsimtarët përdorin në mësimdhënie (tabela 1.3 më poshtë) prapë kemi përgjigje të ndara. Rreth 48% e arsimtarëve janë përgjigjur se pajtohen që kanë projektorë dhe pajisje tjera digjitale në klasë ndërsa 44% janë përgjigjur që nuk kanë projektorë apo pajisje tjera digjitale në klasë. 8% e të anketuarve kanë ngelur neutral.


## 1.3 Kemi projektorë dhe pajisje tjera teknologjike në secilën



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket përdorimit të platformave elektronike të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (tabela 1.4 më poshtë) shumica kanë dhënë përgjigje neutral, ndërsa 36% me siguri përdorin online platformat e Ministrisë së Arsimit ndërsa ka edhe të tillë që nuk pajtohen se përdorin këto platforma e që numri i tyre është 20%.


## 1.4 Kam përdorur në mësim platformat elektronike të Ministrisë së arsimit



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në tabelën 1.5 më poshtë shfaqen të dhënat nga pyetja nëse nxënësit parapëlqejnë mësimin nëpërmjet teknologjisë dhe sic edhe supozohet rezultatet janë pozitive edhe atë 72% të arsimtarëve të anketuar kanë pohuar pra janë pajtuar se nxënësit janë më aktiv dhe më të angazhuar kur përdoret teknologjia digjitale në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në klasë. Vetëm 8% e arsimtarëve nuk pajtohen me këtë dhe kjo nënkuptohet pasi sic vërejtëm edhe në pjesën teorike të këtij punimi gjithmonë ka arsimtarë që ngurrojnë të përdorin teknologjinë si dhe se ata kanë botëkuptime të vjetra mbi arsimin dhe nuk mendojnë se teknologjia mund të nxitë mësimin aktiv tek nxënësit. Por, përbindja e madhe e arsimtarëve që pajtohen me rolin e teknologjisë në mësimin aktiv të nxënësve është tregues se mentaliteti progresiv dhe në hap me kohën ekziston në shkollë por që duhet të punohet më tepër nga ana e Menaxhmentit të shkollës për tu ndihmuar këtyre arsimtarëve duke i furnizuar klasat me pajisje teknologjike si dhe duke u ndihmuar këtu arsimtarëve me trajnime të ndryshme të përdorin teknologjinë në punën e tyre të përditshme.

### 1.5 Nxënësit janë më aktiv dhe më të angazhuar kur përdorin teknologjinë në mësim (e preferojnë teknologjinë)




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.6 më poshtë tregon të dhënat e nxjerra nga pyetja se nëse arsimtarët janë të aftë për të përdorur teknologjinë në klasë dhe përgjigjet janë shumë positive pra dikund rreth 80% e arsimtarëve mundën të përdorin pajisjet digjitale në mësimdhënie, ndërsa 20% të arsimtarëve janë neutral. Sic mund

edhe të konkludojmë se pjesa dërmuese e arsimtarëve në shkollën Bratstvo-Migjeni janë të aftë për të përdorur pajisje të ndryshme teknologjike për të zbatuar mësimdhënien bazuar në teknologji digjitale.


### 1.6 Jam i aftë (kam njohuri dhe aftësi të mjaftueshme) të përdori teknologji informative në mësimdhënie



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket pyetjes nëse teknologjia në klasë është e patjetërsueshme në procesin edukativo arsmior në shkollë (shih tabelën 1.7) 56% e arsimtarëve pajtohen, ndërsa 20% nuk pajtohen. Mandje 24% e arsimtarëve janë neutral. Sido që të jetë, të dhënat shihet se janë të ndara dhe se në këtë pjesë Drejtoria e shkollës duhet të punojë më tepër për të inkurajuar stafin akademik të përdorë teknologjinë në mësimdhënie.

### 1.7 Përdorimi i teknologjisë në mësim është i patjetërsueshëm në shkollën tonë




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.8 më poshtë tregon të dhënat nga pyetja nëse arsimtarët mendojnë që metodat modern të bazuara në teknologji ngritin cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies. Nga kjo tabelë shihet se 64% e arsimtarëve mendojnë se metodat e mësimdhënies bazuar në teknologji ngritin cilësinë e nxënies tek nxënësit por edhe mënyrën se si arsimtarët ligjerojnë pra ngritin edhe cilësinë e mësimdhënies. Numër më i madh i arsimtarëve janë neutral (32%) ndërsa numër i vogël nuk pajtohen me këtë deklaratë (4%). Kjo po ashtu tregon faktin që arsimtarët vlerësojnë paradigmen e re të mësimdhënies bazuar në teknologji si metodologji më e mirë për të ngritur cilësinë e të mësuarit tek nxënësit.




## 1.8 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) ngrit cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.9 përmban një pyetje që është identike me atë paraprake të tabelës 1.8 dhe përgjigjet poshtë lartë janë identike. Ndoshta numri i arsimtarëve që janë përgjigjur pozitivisht në këtë rast është pak më i vogël dhe se numri i arsimtarëve që kanë ngelur neutral është rritur. Sidoqoftë, numri i atyre që nuk pajtohen me faktin që paradigm e re e mësimdhënies është më efikase se ajo tradicionale është shumë i vogël. Por, duhet të nënvizohet se numri i atyre arsimtarëve që pajtohen me efikasitetin e paradigmës së re të mësimdhënies nuk është edhe shumë i madh, pra në nivelin e duhur. Kjo mund të jetë për shkak të mungësës së pajisjeve teknologjike në shkollë dhe pamundësia e arsimtarëve për të përdorur metodologjinë e bazuar në teknologji gjë që do i jepte mundësi arsimtarëve të dallojnë efektet nga zbatimi i paradigmës së re të mësimdhënies bazuar në teknologji digjitale.

## 1.9 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) është më efikase se sa mësimdhënia tradicionale




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.10 më poshtë nxjerrë në pah rezultatet nga pyetja nëse përdorimi i teknologjisë motivon nxënësit më tepër dhe përgjigjet janë sin e vijim: 56% e arsimtarëve pajtohen, 4% nuk pajtohen, 40% janë neutral. Kjo përsëri tregon se Drejtoria e shkollës duhet motivuar së pari arsimtarët për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie që të mundën më pas arsimtarët të zbulojnë nëse nxënësit motivohen më

tepër kur arsimtarët e tyre përdorin paradigmen e re të mësimdhënies në klasë. Përqindja e madhe (40%) të arsimtarëve të anketuar e mbështet pohimin tonë të dhënë më lartë.


#### 1.10 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) motivon nxënësit të mësojnë më tepër



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Edhe tek tabela 1.11 më poshtë rezultatet janë identike me ato më lartë. Dikundi rreth 52% besojnë se nxënësit mund të kenë rezultate më të mira nga të mësuarit nëse mësimdhënia bazohet në përdorimin e teknologjisë në klasë. Vetëm 8% nuk pajtohen dhe përsëri një numër i madh pra 40% janë neutral.


#### 1.11 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) rrit rezultatet e të mësuarit



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.12 më poshtë tregon rezultatet nga pyetja në lidhje me metodën e re të mësimdhënies Flipped Classroom që ndihmon nxënësit të duplikojnë kohën e mësimit. Nga tabela më poshtë mund të shohim se vetëm 28% pajtohen që përdorin këtë metodë ndërsa 26% nuk pajtohen. Përqindja më e madhe është tek neutral pra 44% e arsimtarëve janë neutral.


#### 1.12 Mësimdhënia nëpërmjet klasës së rrokullisur (flipped classroom) është një metodë që përdorim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.13 më poshtë tregon rezultatet nga pyetja që ka të bëjë me kohën për përgaditje të mësimit nga ana e arsimtarëve kur përdorin teknologjinë në mësime. Rezultatet tregojnë se 52% nuk pajtohen që do të thotë se këta arsimtarë mendojnë se përgaditja e orëve mësimore nëpërmjet teknologjisë nuk u merr kohë shumë arsimtarëve. Ndërsa, 24% pajtohen pra mendojnë se përgaditja merr kohë më tepër prandaj edhe evtojnë mësime nëpërmjet teknologjisë në klasë.


### 1.13 Mësime nëpërmjet teknologjisë kërkon më tepër planifikim se ajo tradicionale prandaj nuk e përdorim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në tabelën 1.14 më poshtë kemi rrokullisur pyetjen 1.7 dhe pyetjen e njëjtë e kemi vendosur mbrapsht. Pra, tash është pritur që arsimtarët të përgjigjen nëse përdorimi i teknologjisë në shkollën e tyre nuk është i patjetërsueshëm pra Drejtori nuk kërkon nga ata që të përdorin teknologjinë në mësime dhe rezultatet janë si vijim: 56% nuk pajtohen që do të thotë se nga ata pritet që të përdorin teknologjinë në mësime, mandej 20% pajtohen që do të thotë se nga ata nuk pritet që të përdorin teknologjinë në mësime, dhe 24% janë neutral. Këtu del në pah nevoja për Drejtorinë që të jenë më aktiv në promovimin e mësimit nëpërmjet teknologjisë dhe futjes së paradigmes së re të mësimit në kurrikulat e shkollës gjë që do të bënte të patjetërsueshme për arsimtarët që të përdorin teknologjinë në punën e tyre të përditshme pra në procesin e mësimit dhe nxënies në shkollë.


### 1.14 Përdorimi i teknologjisë në shkollën tonë nuk është i patjetërsueshëm prandaj nuk e përdorim atë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në pyetjen e radhës Tabela 1.15 më poshtë që ka të bëjë me nevojën e trajnimit të stafit akademik për përdorimin e teknologjisë në klasë shihet qartë se një përqindje e madhe është përgjigjur që ka nevojë për trajnim 36% dhe 24% neutral. Ndërsa nuk është I vogël edhe numri I arsimtarëve që mendojnë se kanë dijet e nevojshme për të përdorur teknologjinë në klasë dhe se nuk kanë nevojë për trajnim. Rezultatet e kësaj pyetje drejtojnë kërkesën deri tek Drejtoria e shkollës për trajnime për arsimtarët për të aftësuar ata që të përdorin teknologjinë në mësim. Përveç kësaj, do të ishte mirë që të mendohet për trajnime të kombinuara (shih pjesën teorike më lartë) në fushën e mësimdhënies modern dhe përdorimin e teknologjisë në drejtim të mësimdhënies më cilësore në mësim. Arsimtarët të trajnohen jo për tu aftësuar në teknologjinë digjitale por për të zbatuar Paradigmën e Re të Mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të TIK (Teknologjisë Informative në Klasë).


### 1.15 Kam nevojë për trajnim për të përdorur teknologjinë informative në mësimdhënie



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.16 më poshtë tregon se 60% e arsimtarëve ndjehen rehat kur përdorin teknologjinë në mësimdhënie ndërsa vetëm një numër I vogël që është 12% nuk ndjehen rehat kur përdorin metodologjinë moderne në punën e tyre të përditshme, ndërsa 28% janë neutral. Kjo prapë ngrit nevojën për intervenim nga ana e Drejtorit për të motivuar arsimtarët të përdorin teknologjinë në klasë duke u mundësuar atyre si qasje në pajisje digjitale po ashtu edhe trajnime adekuate në zbatimin e paradigmes së re të mësimdhënies dhe nxënies.


### 1.16 Nuk ndjehem rehat të përdori teknologjinë në mësimdhënie prandaj aplikoj mësimdhënie tradicionale



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa i përket tabelës 1.17 më poshtë e që ka të bëjë me të dhënat në lidhje me pyetjen nëse infrastruktura teknologjike mundëson aplikim të paradigmes së re të mësimdhënies dhe nxënies rezultatet janë sin e vijim: 48% nuk pajtohen që do të thotë se afër gjysmës së numrit të arsimtarëve të anketuar mendojnë se infrastruktura teknologjike në shkollën e tyre është në nivel të duhur për të zbatuar mësimdhënie moderne bazuar në teknologji digjitale. Ndërsa pajtohen 32% mendojnë se infrastruktura teknologjike nuk plotëson kushtet për zbatim të mësimdhënies moderne. Edhe numri i atyre që janë neutral nuk është aspak i vogël 20% e arsimtarëve kanë ngelur neutral. Edhe këto të dhëna përsëri ndezin alarmin për proaktivitet më të madh nga ana e Drejtorit për sa i përket furnizimit të shkollës me teknologji më të re digjitale dhe përmirësim të infrastrukturës teknologjike aktuale. Gjegjësisht, fokusi i Drejtorit gjatë përgaditjes së buxheteve të vihet tek alokimi i mjeteve për teknologji informative në klasë në shkollën e tij/saj, ose të bëjnë kërkesat e nevojshme deri tek Organet locale apo Qendrore për të kërkuar ndihmë për të përmirësuar infrastrukturën teknologjike në shkollë.


### 1.17 Infrastruktura teknologjike në shkollën tonë nuk mundëson ligjeratat bazuar në teknologji



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.18 tregon përgjigjet e arsimtarëve në lidhje me kohën si factor që pengon arsimtarët për të përdorur teknologjinë digjitale në mësimdhënie. Dikund 60% nuk pajtohen se teknologjia mund tu marrë kohë, 32 janë neutral ndërsa 8% mendojnë se koha është faktori kryesor që pengon ata të përdorin teknologjinë digjitale në mësimdhënie.


### 1.18 Teknologjia na merrë kohë nga koha e mësimdhënies prandaj nuk e përdorim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.19 më poshtë tregon mendimin e arsimtarëve për sa i përket përkrahjes teknike që zyra e TIK në shkollë u siguron arsimtarëve gjatë përdorimit të teknologjisë digjitale në procesin mësimdhënies dhe nxënies. Sic shihet në tabelë më poshtë 56% pajtohen se ka përkrahje teknike (pra pak më tepër se gjysma e arsimtarëve të anketuar) ndërsa 20% nuk pajtohen që do të thotë se nuk ka përkrahje të duhur teknike për arsimtarët gjatë përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie. Numri neutral i arsimtarëve përsëri ngel I madh pra 24%. Këto të dhëna nxjerrin në pah nevojën për të rritur përkrahjen teknike për arsimtarët gjatë përdorimit të TIK në mësimdhënie.


### 1.19 Kemi përkrahje teknike gjatë përdorimit të TIK në rast të ndonjë problemi teknik



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.20 më poshtë tregon se sa arsimtarë mendojnë se ekziston trysni mbi arsimtarët nga ana e Drejtorit të shkollës për të përdorur teknologjinë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollë. Shihet qartë se 79% e arsimtarëve mendojnë se nuk ka asnjë trysni nga Drejtori i shkollës për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie, ndërsa 4% mendojnë se Drejtori bën trysni tek ata që të përdorin teknologjinë informative në mësimdhënie. Këtu duhet të nënvizojmë se pyetja ka të bëjë me përdorimin e teknologjisë në klasa fizike pra jo për këtë kohë të pandemisë kur arsimtarët janë të detyruar të përdorin teknologjinë pasi teknologjia tani është mjeti i vetëm i cili mundëson komunikim me nxënësit si dhe me kolegët e shkollës. Sidoqoftë, të dhënat tregojnë se Drejtori nuk bën trysni mbi arsimtarët për të

përdorur teknologjinë por me siguri që Drejtori gjen mënyra tjera për të nxitur arsimtarët të përdorin teknologjinë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.




**1.20**  
**Drejtori i shkollës bën tryzni mbi ne**

**të përdorim teknologjinë informative në klasë**

Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa i përket tabelës 1.21 më poashtë ajo ka të bëjë me të dhënat që mbledhëm në lidhje me përpjekjet e Drejtorit për të modernizuar teknologjinë informative në shkollë në mënyrë të vazhdueshme. Të dhënat tregojnë se pak më tepër se gjysma e arsimtarëve 56% pajtohen që Drejtori i shkollës vazhdimisht modernizon infrastrukturën teknologjike të shkollës, 20% nuk mendojnë ashtu dhe 24% janë neutral. Prapë, të dhënat janë të ndara që kërkon intervenim në këtë drejtim gjegjësisht kërkohet angazhim edhe më i madh nga ana e Drejtorit të shkollës për të modernizuar infrastrukturën teknologjike në shkollë.


### **1.21 Drejtori i shkollës vazhdimisht modernizon infrastrukturën teknologjike në shkollë**



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.22 më poshtë nxjerrë në pah përgjigjet e arsimtarëve për sa i përket angazhimit të Drejtorit në drejtim të sigurimit të zhvillimit profesional të arsimtarëve për përdorim të TIK në mësimdhënie. Të dhënat tregojnë se vetëm 20% e arsimtarëve pajtohen që kanë ndonjë trajnim për përdorim të TIK në mësim ndërsa 16% nuk pajtohen, dhe numri më i madh i atyre arsimtarëve që janë neutral është 64%. Cështja e përqindjes së madhe të atyre arsimtarëve që janë neutral në këtë pyetje mund të interpretohet në dy mënyra 1. Edhe nëse ekzistojnë trajnime arsimtarët nuk dërgohen në ato trajnime, ose 2. Nuk ka trajnime të vazhdueshme dhe prandaj arsimtarët nuk dërgohen. Prapë, do kishim sugjeruar që Drejtori i shkollës të bënë përpjekje më të mëdha për të siguruar trajnime për përdorim të TIK në mësimdhënie si Brenda shkollës ashtu edhe jashtë saj.

### 1.22 Drejtori i shkollës vazhdimisht na dërgon në trajnime për të përdorur TIK në institucione tjera




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në tabelën 1.23 më poshtë shfaqen të dhënat që tregojnë se Drejtori i shkollës nuk organizon trajnime të vazhdueshme në shkollë pasi vetëm 28% janë përgjigjur pozitivisht. Të tjerët ose janë përgjigjur negativisht ose janë neutral.

### 1.23 Drejtori vazhdimisht organizon trajnime për përdorim të teknologjisë në mësim






Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.24 më poshtë tregon se çfarë mendojnë arsimtarët për punën e vlerësimit nga ana e Drejtorit për sa i përket angazhimit të arsimtarëve në përdorim të teknologjisë gjatë procesit të mësimdhënies. Dikundi 40% e arsimtarëve vlersojnë se Drejtori gjatë vëzhgimit të mësimdhënies vlerëson pozitivisht angazhimin e arsimtarëve që përdorin teknologjinë në mësim, 85 nuk mendojnë ashtu ndërsa 52% janë neutral. Në këtë rast do kishim sugjeruar që në formularin e vlerësimit të ketë një grafë për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie që do vlerësoheshte gjatë vëzhgimit dhe që paraprakisht do njohtoheshin arsimtarët me këtë fushë vlerësimi që më pas ata të motivohen që të përdorin teknologjinë në mësim nga i cili aktivitetet do notoheshin me notë më të lartë. Kjo mënyrë edhe do detyronte në një mënyrë që arsimtarët të përgadisnin plane mësimi ku do inkuadronin teknologjinë në mësimdhënie.

#### 1.24 Drejtori i shkollës gjatë vëzhgimit të mësimin na vlerëson se si dhe sa përdorim teknologjinë në mësim




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket tabelës së fundit 1.25 më poshtë aty mund të shohim të dhënat që tregojnë se rreth 60% e arsimtarëve mendojnë se prindërit e nxënësve të tyre aprovojnë paradimën e re të mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë digjitale. Kat ë tillë që nuk mendojnë se prindërit e nxënësve të tyre parapëlqejnë

përdorimin e teknologjisë digjitale në msimdhënie dhe që fëmijtë e tyre të mësojnë nëpërmjet teknologjisë. Ndërsa 12% e arsimtarëve kanë ngelur neutral. Këtu del në pah nevoja për komunikim më të mirë me prindërit dhe informim të prindërve rreth aktiviteteve në shkollë. Sugjerojmë që të informohen prindërit rreth përparësive që sjell teknologjia digjitale në procesin e mësimdhënies dhe nxënies e në vecanti për faktin që hulumtimi teorik i këtij punimi nxorri në pah se përdorimi i teknologjisë në arsim duplikon kohën e të mësuarit tek nxënësit dhe se nxënësit duhet edukuar që të përdorin pajisjet e tyre digjitale për të vazhduar mësimin në shtëpi gjë që do ngrit nivelin e të nxënit tek nxënësit.

### 1.25 Prindërit mbështesin përdorimin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor në shkollën tonë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka


### Pyetësori për arsimtarët e shkollës fillore Kirili dhe Metodi

Për sa i përket shkollës fillore Kirili dhe Metodij në total 16 arsimtarë u anketuan. Shfrytëzoj rastin që edhe këta arsimtarë të i faleminderoj për bashkëpunimin.

Tani në këtë shkollë arsimtarët në pyetjen e parë të pyetësorit, tabela 1.26 më poashtë, që ka të bëjë me situatën me pajisjet kompjuterike në shkollën fillore Kirili dhe Metodi Tetovë si dhe përdorimin e pajisjeve kompjuterike në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollë 38% janë përgjigjur pozitivisht, 37% negativisht dhe 25% neutral. Përgjigjet pozitive, gjegjësisht përqindja e arsimtarëve që janë përgjigjur pozitivisht është më e lartë në këtë shkollë se sa tek shkolla Bratstvo Migjeni që kishte vetëm 16% të përgjigjeve pozitive, ndërsa 68% ishin negative. Gjë që tregon se së paku perceptioni i arsimtarëve në lidhje me numrin e pajisjeve kompjuterike në klasë është më i mirë se sa tek shkolla tjetër. Sidoqoftë, edhe në këtë shkollë ka nevojë për furnizim me kompjuterë në klasa pasi përqindja e

përgjigjeve është indikatorë apo tregues që në fakt edhe kjo shkolla nuk posedon kompjuterë të mjaftueshëm në shkollë që më pas arsimtarët të mund të përdorin ato në procesin e mësimdhënies.


### 1.26 Kemi kompjuterë në secilën klasë dhe mund t'i përdorim ato në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka


Për sa i përket pyetjes rreth internetit në shkollë të dhënat nga tabela 1.27 tregojnë që 75% e arsimtarëve në shkollën fillore Kirili dhe Metodi janë përgjigjur se ka internet në shkollë që përsëri është një përqindje më e lartë se sa në shkollën tjetër Bratstvo-Migjeni që përqindja ishte 56% e e arsimtarëve të anketuar. Ndërsa sa i përket arsimtarëve që janë përgjigjur që nuk pajtohen që kanë internet në shkollë është 25% që është pak më e ulët se sa tek shkolla tjetër që ishte 28%. Sa i përket atyre që janë neutral tek shkolla fillore Kirili dhe Metodi nuk kishte asnjë neutral përderisa te shkolla Bratstvo Migjeni përqindja e atyre neutral ishte 16%. Këto të dhëna tregojnë që shumica e arsimtarëve përdorin internetin në mësimdhënie ndërsa ka edhe të tillë që ndoshta për shkak të shpejtësisë apo ndërprerjeve të internetit nuk janë të kënaqur me internetin në shkollë. Sic pamë në pjesën teorike të këtij punimi shumë shtete të përparuara sic janë SHBA dhe Britani e madhe vec më kanë marrë masat e nevojshme për të rritur shpejtësinë e internetit në shkollat e tyre fillore. Prandaj, edhe këto rezultate parashtrojnë nevojën për veprime konkrete të autoriteteve shtetërore dhe lokale si dhe atyre të shkollës sic është Drejtori I shkollës për të siguruar internet me shpejtësi më të madhe dhe pa ndërprerje që do mundësonte përdorim pa problem të pajisjeve teknologjike në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollë.

### 1.27 Kemi internet në shkollë dhe e përdorim atë në mësim



Për sa i përket pajisjeve tjera në klasë sic janë projektorët dhe pajisjet tjera digjitale që eventualisht arsimtarët në shkollën Kirili dhe Metodi përdorin në mësimdhënie (tabela 1.28 më poshtë) kemi një numër të madh të përgjigjeve positive (75% e arsimtarëve) që dukshëm tejkalojnë përqindjen e arsimtarëve nga shkolla Bratstvo-Migjeni që ishte 48% e arsimtarëve që u përgjigjën pozitivisht, ndërsa 19% e arsimtarëve të shkollës Kirili dhe Metodi janë përgjigjur negativisht që bën këtë përqindje më të vogël se 44% që ishte përqindje negative nga shkolla Bratstvo Migjeni. Në këtë shkollë kemi 6% të arsimtarëve neutral përderisa tek shkolla tjetër ishte 8% e të anketuarve.


### 1.28 Kemi projektorë dhe pajisje tjera teknologjike në secilën



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket përdorimit të platformave elektronike të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (tabela 1.29 më poshtë) 61% e arsimtarëve të anketuar janë përgjigjur pozitivisht që është dyfishi i përqindjes nga shkolla tjetër që është 36%. Ndërsa ka edhe të tillë që nuk pajtohen se përdorin këto platforma e që numri i tyre është 14%, që është për 6 përqind më e vogël se sa përqindja e arsimtarëve nga shkolla tjetër që ishte 20%. Sa i përket arsimtarëve që janë neutral përqindja është 15%.


### 1.29 Kam përdorur në mësim platformat elektronike të Ministrisë së arsimit



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në tabelën 1.30 më poshtë shfaqen të dhënat nga pyetja nëse nxënësit parapëlqejnë mësimin nëpërmjet teknologjisë dhe sic edhe supozohet shumica dërmuese e arsimtarëve janë përgjigjur se pajtohen plotësisht/ pajtohen edhe atë me 93%. Këtu kemi prapë dallim me përgjigjet e arsimtarëve nga shkolla tjetër përbindja e të cilëve ishte 72% të arsimtarëve të anketuar të cilët kishin pohuar pra janë pajtuar se nxënësit janë më aktiv dhe më të angazhuar kur përdoret teknologjia digjitale në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në klasë. Në shkollën Kirili dhe Metodi asnjë arsimtar nuk është përgjigjur që teknologjia nuk i bën nxënësit më aktiv kur përdoret teknologjia në klasë. Pra, kjo është edhe një dëshmi se shkolla Kirili dhe Metodi kanë identifikuar përparësitë e teknologjisë në mësimdhënie dhe se vec më kanë filluar ta praktikojnë atë në punën e tyre të përditshme në masë të madhe. Tek shkolla tjetër kishte 8% të arsimtarëve që nuk pajtoheshin.


### 1.30 Nxënësit janë më aktiv dhe më të angazhuar kur përdorim teknologjinë në mësim (e preferojnë teknologjinë)



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.31 më poshtë tregon të dhënat e nxjerra nga pyetja se nëse arsimtarët janë të aftë për të përdorur teknologjinë në klasë dhe përgjigjet janë shumë positive, edhe atë 88% e arsimtarëve të anketuar pohuan se kanë dije dhe aftësi për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie që është për 8% më e lartë se në shkollën tjetër. 6% e arsimtarëve nuk pajtohen me këtë dhe 6% e arsimtarëve janë neutral. Edhe në këtë rast mund të konstatojmë se pjesa dërmuese e arsimtarëve të anketuar në këtë shkollë, Kiril dhe Metodij, janë të aftë për të përdorur pajisje të ndryshme teknologjike për të zbatuar mësimdhënien bazuar në teknologji digjitale.


### 1.31 Jam i aftë (kam njohuri dhe aftësi të mjaftueshme) të përdori teknologji informative në mësimdhënie



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në vazhdim të shohim rezultatet nga pyetja ‘nëse teknologjia në klasë është e patjetërsueshme në procesin edukativo arsmior në shkollën Kiril dhe Metodi’ (shih tabelën 1.32). Tabela më poshtë tregon se 69% e arsimtarëve pajtohen, ndërsa 6% nuk pajtohen. Prapë edhe në këtë pyetje shkolla Kirili dhe Metodi ka më tepër përgjigje positive pra dikund 13% më tepër arsimtarë janë përgjigjur pozitivisht, përderisa negativisht janë përgjigjur 16% më pak. Sa i përket arsimtarëve neutral përqindja është identike 245 me 24% në shkollën tjetër. Sido që të jetë, të dhënat shihet se nuk janë në nivelin e duhur që do të thotë se Drejtoria e shkollës duhet të punojë më tepër për të inkurajuar stafin akademik të përdorë teknologjinë në mësimdhënie.


### 1.32. Përdorimi i teknologjisë në mësim është i patjetërsueshëm në shkollën tonë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.33 (më poshtë) tregon të dhënat nga pyetja nëse arsimtarët mendojnë që metodat moderne të bazuara në teknologji ngritin cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën fillore Kiril dhe Metodi. Nga kjo tabelë shihet se 69% e arsimtarëve mendojnë se metodat e mësimdhënies bazuar në teknologji ngritin cilësinë e nxënies tek nxënësit, përqindje kjo që është e përafërt me shkollën Bratstvo-Migjeni por prapë me diferencë positive për 3%, gjegjësiht 64%. Ndërsa 12% nuk pajtohen përqindje kjo që është më e lartë se në shkollën tjetër që ishte 4%. Neutral janë 19% që është prapë më e vogël se në shkollën tjetër. Edhe pse përqindja nuk është shumë e madhe prapë mendojmë që arsimtarët e shkollës fillore Kiril dhe Metodi vlerësojnë paradigmen e re të mësimdhënies bazuar në teknologji si metodologji më e mirë për të ngritur cilësinë e të mësuarit tek nxënësit.


### 1.33 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) ngrit cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.34 përmban një pyetje që është identike me atë paraprake të tabelës 1.33 dhe përgjigjet e arsimtarëve në shkollën Kirili dhe Metodij janë 50% positive (pra gjysma) mendojnë se paradigme re e mësimdhënies është më e mirë se ajo tradicionale. Përqindja tregon se akoma arsimtarët preferojnë mësimdhënien tradicionale edhe pse përqindja e atyre që janë përgjigjur negativisht është 19%, por neutral janë 31%.


### 1.34 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) është më efikase se sa mësimdhënia tradicionale



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.35 më poshtë nxjerrë në pah rezultatet nga pyetja nëse përdorimi i teknologjisë motivon nxënësit më tepër dhe përgjigjet janë si në vijim: 81% e arsimtarëve të shkoollës fillore Kirili dhe Metodi pajtohen. Kjo përqindje është shumë më e madhe se përqindja e arsimtarëve në shkollën Bratsvto-Migjeni që ishte 56%, pra për 25% më e lartë. Asnjë arsimtarë nuk konteston faktin që paradigma e re e mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë motivon nxënësit ndërsa tek shkolla tjetër ishte 4%. Neutral në Kiril dhe Metodi janë 19% e arsimtarëve përderisa në shkollën tjetër ishte 40%. Kjo përqindje e lartë në Kiril dhe Metodi është tregues se Drejtoria e shkollës së bashku me arsimtarët kanë identifikuar metodologjinë moderne si metodologji më e mirë për të motivuar nxënësit që të mësojnë dhe të tregojnë rezultate më të mira në mësim.


### 1.35. Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) motivon nxënësit të mësojnë më tepër



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tek tabela 1.36 më poshtë rezultatet janë sin ë vijim: 69% e arsimtarëve në shkollën Kirili dhe Metodi besojnë se nxënësit mund të kenë rezultate më të mira nga të mësuarit nëse mësimdhënia bazohet në përdorimin e teknologjisë në klasë që e bën përqindjen më të madhe për 17% se sa përgjigjet positive nga shkolla Bratstvo-Migjeni që ishte 52%. Asnjë nuk është përgjigjur negativisht që prapë është përqindja më e vogël se tek shkolla tjetër që ishte 8% që nuk pajtoheshin. Neutral janë 31% që është për 9 më e vogël sesa shkolla tjetër që kishin 40% neutral.

### 1.36 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) rrit rezultatet e të mësuarit




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.37 më poshtë tregon rezultatet nga pyetja në lidhje me metodën e re të mësimdhënies Flipped Classroom që ndihmon nxënësit të duplikojnë kohën e mësimit. Nga tabela më poshtë mund të shohim se vetëm 44% njohin këtë metodë në krahasim me 28% e shkollës tjetër. Përgjigja negative është identike me shkollën tjetër dhe është 26% për 1% më e lartë. Në shkollën tjetër kishte 26% që nuk pajtohen. Përqindja e atyre që ngelën neutral ishte 31% që është më e vogël se sa shkolla tjetër që kishte 44% të arsimtarëve të anketuar.

### 1.37 Mësimdhënia nëpërmjet klasës së rrokullisur (flipped classroom) është një metodë që përdorim






Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.38 më poshtë tregon rezultatet nga pyetja që ka të bëjë me kohën për përgaditje të mësimit nga ana e arsimtarëve kur përdorin teknologjinë në mësime. Rezultatet tregojnë se 44% pajtohen se planifikimi merr më tepër kohë që është për 20% më e madhe se tek shkolla tjetër që ishte 24% e arsimtarëve të anketuar. Kjo do të thotë se këta arsimtarë mendojnë se duhet alokuar më tepër kohë për përgaditjen e orëve mësimore nëpërmjet teknologjisë. Ndërsa, 44% nuk pajtohen që është për 8% më e vogël se tek shkolla tjetër që ishte 52%. Pra kjo përqindje e arsimtarëve të anketuar mendojnë se përgaditja nuk u merr shumë kohë dhe që është tregues se preferojnë teknologjinë në mësime. Në këtë rast shkolla Bratstvo-Migjeni ka më tepër preferencë për të përdorur teknologjinë në përgaditje të mësimeve. Neutral janë vetëm 12%.

### 1.38 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë kërkon më tepër planifikim se ajo tradicionale prandaj nuk e përdorim




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në tabelën 1.39 më poshtë pyetja është nëse arsimtarët përgjigjen nëse përdorimi i teknologjisë në shkollën e tyre nuk është i patjetërsueshëm pra Drejtori nuk kërkon nga ata që të përdorin teknologjinë në mësime dhe rezultatet janë si vijim: 69% nuk pajtohen që do të thotë që është e patjetërsueshme përdorimi i teknologjisë në shkollën Kirili dhe Metodi. Në krahasim me shkollën Bratstvo-Migjeni përqindja është më e madhe për 13%, pra 56% atje nuk pajtohen. Mandej përqindja e atyre që u përgjigjen pozitivisht ishte 19% që është identike me shkollën tjetër që ishte 20% e arsimtarëve të anketuar. Neutral janë 12% ndërsa shkolla tjetër kishte 24% neutral. Ngjashëm me shkollën tjetër edhe këtu ka nevojë për intervenim nga ana e Drejtorit që të jetë më aktiv në promovimin e mësimeve nëpërmjet teknologjisë dhe futjes së paradigmes së re të mësimit në kurrikulat e shkollës gjë që do

të bëjnë të patjetërsueshme për arsimtarët që të përdorin teknologjinë në punën e tyre të përditshme pra në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollë.


### 1.39 Përdorimi i teknologjisë në shkollën tonë nuk është i patjetërsueshëm prandaj nuk e përdorim atë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në pyetjen e radhës Tabela 1.40 më poshtë që ka të bëjë me nevojën e trajnimit të stafit akademik për përdorimin e teknologjisë në klasë. Shihet qartë se një përqindje e madhe është përgjigjur që ka nevojë për trajnim 47% që është më e lartë se në shkollën tjetër që ishte 36%. Kjo mund të jetë tregues që arsimtarët e shkollës Kirili dhe METodi kanë nevojë për trajnim në përdorimin e teknologjisë në klasë. Nuk pajtohen 26% dhe 27% janë neutral. Rezultatet e kësaj pyetje drejtojnë kërkesën deri tek Drejtoria e shkollës për trajnime për arsimtarët për të aftësuar ata që të përdorin teknologjinë në mësim. Përveç kësaj, do të ishte mirë që të mendohet për trajnime të kombinuara (shih pjesën teorike më lartë) në fushën e mësimdhënies moderne dhe përdorimin e teknologjisë në drejtim të mësimdhënies më cilësore në mësim. Arsimtarët të trajnohen jo për tu aftësuar në teknologjinë digjitale por për të zbatuar Paradigmën e Re të Mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të TIK (Teknologjisë Informative në Klasë).


### 1.40 Kam nevojë për trajnim për të përdorur teknologjinë informative në mësimdhënie



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë - Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.41 më poshtë tregon se 69% e arsimtarëve të shkollës fillore Kirili dhe Metodi ndjehen rehat kur përdorin teknologjinë në mësimdhënie që është për 9% më e lartë se përqindja e arsimtarëve të anketuar në shkollën Bratstvo Migjeni e që ishte 60%. Ndërsa vetëm një numër I vogël që është 6% nuk ndjehen rehat. Këtu është për 6% përqindja e e arsimtarëve të anketuar më e vogël se sa në shkollën tjetër që ishte 12% e atyre që nuk ndjeheshin rehat kur përdorin metodologjinë moderne në punën e tyre të përditshme, ndërsa 25% janë neutral që është për 3 % më I vogël se përqindja në shkollën tjetër që ishte 28% neutral. Kjo prapë ngrit nevojën për intervenim nga ana e Drejtorit për të motivuar arsimtarët të përdorin teknologjinë në klasë duke u mundësuar atyre si qasje në pajisje digjitale po ashtu edhe trajnime adekuat në zbatimin e paradigms së re të mësimdhënies dhe nxënies.


#### 1.41 Nuk ndjehem rehat të përdori teknologjinë në mësimdhënie prandaj aplikoj mësimdhënie tradicionale



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa i përket tabelës 1.42 më poshtë e që ka të bëjë me të dhënat në lidhje me pyetjen nëse infrastruktura teknologjike mundëson aplikim të paradigms së re të mësimdhënies dhe nxënies rezultatet janë si në vijim: 38% që është për 10% më pakë se tek shkolla tjetër që ishte 48% nuk pajtohen që do të thotë se tek shkolla tjetër ishte afër gjysmës së numrit të arsimtarëve të anketuar që mendojnë se infrastruktura teknologjike në shkollën e tyre është në nivel të duhur për të zbatuar mësimdhënie moderne bazuar në teknologji digjitale. Ndërsa pajtohen 31% që është përqindje identike me shkollën tjetër që ishte 32% e që mendojnë se infrastruktura teknologjike nuk plotëson kushtet për zbatim të mësimdhënies moderne. Edhe numri I atyre që janë neutral nuk është aspak I vogël 31% e arsimtarëve të anketuar, për 11% më I madh se numri I arsimtarëve në shkollën tjetër që ishte 20% e arsimtarëve. Edhe këto të dhëna përsëri nderin alarmin për proaktivitet më të madh nga ana e Drejtorit për sa i përket furnizimit të shkollës me teknologji më të re digjitale dhe përmirësim të infrastrukturës teknologjike aktuale. Gjegjësisht, fokusi i Drejtorit gjatë përgaditjes së buxheteve të vihet tek alokimi I mjeteve për teknologji informative në klasë në shkollën e tij/saj, ose të bëjnë kërkesat e nevojshme deri tek Organet locale apo Qendrore për të kërkuar ndihmë për të përmirësuar infrastrukturën teknologjike në shkollë.


## 1.42 Infrastruktura teknologjike në shkollën tonë nuk mundëson ligjeratat bazuar në teknologji



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.43 tregon përgjigjet e arsimtarëve në lidhje me kohën si faktor që pengon arsimtarët për të përdorur teknologjinë digjitale në mësimdhënie. Dikund 80% e arsimtarëve janë përgjigjur që nuk u merrë kohë përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie që është për 20% më lartë se tek shkolla tjetër që ishte 60% e arsimtarëve të anketuar që nuk pajtohen se teknologjia mund tu marrë kohë. Asnjë nga arsimtarët nuk është deklaruar se teknologjia u merrë kohë që është për 8% më e vogël për qindja se tek shkolla tjetër, dhe neutral 20% që është për 12% më e vogël se tek shkolla tjetër që ishte 32%.


## 1.43 Teknologjia na merrë kohë nga koha e mësimdhënies prandaj nuk e përdorim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.44 më poshtë tregon mendimin e arsimtarëve për sa i përket përkrahjes teknike që zyra e TIK në shkollë u siguron arsimtarëve gjatë përdorimit të teknologjisë digjitale në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Sic shihet në tabelë më poshtë 82% e arsimtarëve pohojnë se kanë përkrahjen e nevojshme nga zyra e TI në shkollën Kiril dhe Metodij. Kjo përqindje është për 26% më e lartë se tek shkolla tjetër që ishte 56%. Vetëm 6% nuk pajtohen pra nuk janë të kënaqur me zyren e TI në shkollë, që është prapë për 14% më e vogël se tek shkolla tjetër që ishte 20% që nuk pajtohen. Numri neutral i arsimtarëve është 12% që është për 12% më e vogël se tek shkolla tjetër që ishte 24%. Këto të dhëna tregojnë se zyra e TI në shkollën Kiril dhe Metodij siguron përkrahjen e nevojshme teknike arsimtarëve për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie.


#### 1.44 Kemi përkrahje teknike gjatë përdorimit të TIK në rast të ndonjë problemi teknik



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka


Tabela 1.45 më poshtë tregon se sa arsimtarë mendojnë se ekziston trysni mbi arsimtarët nga ana e Drejtorit të shkollës për të përdorur teknologjinë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollë. Nuk pajtohen janë përgjigjur 44% e arsimtarëve që është për 35% më e vogël përqindja se në shkollën tjetër që ishte 79% e arsimtarëve që mendojnë se nuk ka asnjë trysni nga Drejtori i shkollës për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie. Pajtohen vetëm 19% që është për 15% më e lartë se në shkollën tjetër që ishte 4% e arsimtarëve të anketuar që mendojnë se Drejtori bën trysni tek ata që të përdorin teknologjinë informative në mësimdhënie. Të përsërisim edhe në këtë interpretim të të dhënave se këtu pyetja ka të bëjë me përdorimin e teknologjisë në klasa fizike pra jo për këtë kohë të pandemisë kur arsimtarët janë të detyruar të përdorin teknologjinë pasi teknologjia tani është mjeti i vetëm i cili mundëson komunikim me nxënësit si dhe me kolegët e shkollës. Sidoqoftë, të dhënat tregojnë se Drejtori nuk bën trysni mbi arsimtarët për të përdorur teknologjinë por me siguri që Drejtori gjen mënyra tjera për të nxitur arsimtarët të përdorin teknologjinë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.

#### 1.45. Drejtori i shkollës bën trysni mbi ne të përdorim teknologjinë informative në klasë



Sa i përket tabelës 1.46 më poshtë ajo ka të bëjë me të dhënat që mblodhëm në lidhje me përpjekjet e Drejtorit për të modernizuar teknologjinë informative në shkollë në mënyrë të vazhdueshme. Të dhënat tregojnë se pak më tepër se gjysma e arsimtarëve 57% pajtohen që Drejtori i shkollës Kirili dhe Metodi vazhdimisht modernizon infrastrukturën teknologjike të shkollës, 6% nuk pajtohen dhe 37% janë neutral. Prapë, të dhënat janë të ndara që kërkon intervenim në këtë drejtim gjegjësisht kërkohet angazhim edhe më i madh nga ana e Drejtorit të shkollës për të modernizuar infrastrukturën teknologjike në shkollën Kiril dhe Metodij.


#### 1.46 Drejtori i shkollës vazhdimisht modernizon infrastrukturën teknologjike në shkollë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.47 më poshtë nxjerrë në pah përgjigjet e arsimtarëve për sa i përket angazhimit të Drejtorit në drejtim të sigurimit të zhvillimit profesional të arsimtarëve për përdorim të TIK në mësimdhënie. Të dhënat tregojnë se 47% e arsimtarëve të anketuar pajtohen se dërgohen për trajnime nga ana e Drejtorit që është për 27% më e madhe se përqindja në shkollën tjetër që ishte 20%. Vetëm 13% nuk pajtohen që është e përafërt me shkollën tjetër që ishte 16%, dhe numri neutral është 27% që është shumë më e vogël se përqindja në shkollën tjetër që ishte 64%. Prapë, do kishim sugjeruar që Drejtori i shkollës të bënë përpjekje më të mëdha për të siguruar trajnime për përdorim të TIK në mësimdhënie si brenda shkollës ashtu edhe jashtë saj.


#### 1.47 Drejtori i shkollës vazhdimisht na dërgon në trajnime për të përdorur TIK në institucione tjera



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në tabelën 1.48 më poshtë shfaqen të dhënat që tregojnë se Drejtori I shkollës nuk organizon trajnime të vazhdueshme në shkollë pasi vetëm 19% e arsimtarëve të anketuar janë përgjigjur pajtohem që është për 9% më e vogël përqindja se tek shkolla tjetër që ishte 28%. Të tjerët ose janë përgjigjur (nuk pajtohem) negativisht (31%) gjegjësisht këta mendojnë se Drejtori organizon trajnime dhe neutral janë 50%.


#### 1.48. Drejtori vazhdimisht organizon trajnime për përdorim të teknologjisë në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.49 më poshtë tregon se çfarë mendojnë arsimtarët për punën e vlerësimit nga ana e Drejtorit për sa i përket angazhimit të arsimtarëve në përdorim të teknologjisë gjatë procesit të mësimdhënies. Dikundi 50% e arsimtarëve vlersojnë se Drejtori gjatë vëzhgimit të mësimdhënies vlerëson pozitivisht angazhimin e arsimtarëve që përdorin teknologjinë në mësim në shkollën Kirili dhe Metodij që është për 10% më e lartë, pra atje ishte 40%. 25% nuk pajtohen dhe neutral janë 25%. Në këtë rast do kishim sugjeruar që në formularin e vlerësimit të ketë një grafë për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie që do vlerësohenin përdorimin e teknologjisë nga ana e arsimtarëve gjatë ligjeratave. Kjo mënyrë edhe do detyronte në një mënyrë që arsimtarët të përgadisnin plane mësimi ku do inkuadronin teknologjinë në mësimdhënie.


#### 1.49. Drejtori i shkollës gjatë vëzhgimit të mësimin na vlerëson se si dhe sa përdorim teknologjinë në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket tabelës së fundit 1.50 më poshtë aty mund të shohim të dhënat që tregojnë se rreth 75% e arsimtarëve mendojnë se prindërit e nxënësve të tyre në shkollën Kirili dhe Metodij aprovojnë paradigmen e re të mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë digjitale. Asnjë nuk kundërshton këtë deklaratë, ndërsa neutral janë 25%. Në këtë shkollë prindërit janë me siguri më të informuar për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe se kanë informatë që prindërit parapëlqejnë që teknologjinë që fëmijtë e tyre e përdorin për cdo ditë ta përdorin për qëllime arsimore.

#### 1.50. Prindërit mbështesin përdorimin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor në shkollën



tonë

Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me arsimtarë – Përgaditi Fazlije Ceka




### Pyetësi për nxënësit e shkollës fillore Bratstvo – Migjeni

Sa i përket pyetësit për nxënësit e të dyja shkollave ai u përpilua me 25 pyetje dhe iu shpërnda nxënësve të të dyja shkollave. Qëllimi i pyetësit ishte që të mbledh të dhëna që do të sigurojnë informata në lidhje me situatën në shkollat e tyre për sa i përket infrastrukturës teknologjike në shkollat Bratstvo-Migjeni dhe Kirili dhe Metodij në komunën e Tetovës.

Në fillim do të analizojmë dhe do të interpretojmë të dhënat e mbledhura nga pyetësi me nxënësit në shkollën fillore Bratstvo – Migjeni. U anketuan 62 nxënës në këtë shkollë.

Sic mund të shohim nga Tabela 1.51 më poshtë në pyetjen nëse kanë kompjutorë në shkollën fillore Bratstvo – Migjeni 74% nga numri total i nxënësve të anketuar janë përgjigjur se nuk kanë kompjutorë në klasat e shkollës së tyre. Përqindja e atyre nxënësve që pajtohen, gjegjësisht që kanë dhënë përgjigje pozitive është vetëm 8%. Përqindja e nxënësve që kanë dhënë përgjigje neutral është 18%. Këto të dhëna janë indikator që situata në këtë shkollë për sa i përket kompjutorëve nuk është në nivelin e duhur, pra ka mungesë të kompjutorëve nëpër klasat e shkollës. Si pasojë e kësaj situatë me siguri që edhe arsimtarët janë në situatë të rëndë për të zbatuar paradigmen e re të mësimdhënies bazuar në teknologji në shkollën Bratstvo-Migjeni. Prandaj, nga kjo situatë mund të konstatojmë se ka nevojë për veprim urgjent për sa i përket prokurimeve të kompjutorëve në shkollë dhe furnizimin e klasave në shkollë me kompjutorë, bile bile ashtu sic mësuam edhe nga hulumtimi teorik Menaxhmenti i shkollës duhet urgjentisht të fus në kurrikulat shkollore përdorimin e teknologjisë në mësim dhe me këtë të bëjë të patjetërsueshëm furnizimin e klasave në shkollën Bratstvo Migjeni me kompjutorë. Hulumtimi teorik na siguroi informata të cilat përdoftonin tezën se mësimi nëpërmjet teknologjisë rrit nivelin e të mësuarit dhe dijeve të nxënësit prandaj edhe Menaxhmenti i kësaj shkolle duhet të rrit nivelin e përdorimit të teknologjisë në klasë për të rritur nivelin e të mësuarit dhe dijeve tek nxënësit e kësaj shkolle.


#### 1.51 Kemi kompjutorë në secilën klasë dhe arsimtarët i përdorin ato gjatë mësimdhënies :



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa ipërket pyetjes se a ka internet në shkollë dhe a përdoret I njejtë në mësim përsëri shohim një reagim të madh negativ nga ana e nxënësve, 65% prej të cilëve 31% aspak nuk pajtohen që ka internet në shkollë dhe se ai përdoret në mësim. Vetëm 21% pajtohen që ka internet dhe që I njejtë përdoret edhe për mësim. Kjo situatë është alarmante dhe kërkon veprim urgjent nga ana e Drejtorit të shkollës. Me siguri shkolla ka qasje në internet por duhet të ketë pajisje në klasë për të përdorur internetin në mësim.


### 1.52 Kemi internet në shkollë dhe e përdorim atë në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka


Edhe tek pyetja që nëse në klasat e shkollës Bratstvo Migjeni ka projektorë dhe pajisje tjera teknologjike prapë përgjigjet negative kalojnë prapë 50%, më saktë 56% (shih Tabelën 1.53 më poshtë) gjë që sinjalizon që duhet dicka të ndërmerret nga ana e Menaxhmentit. Vetëm 24% pajtohen ndërsa 19% janë neutral. Normal, këto pajisje varen shumë nga internet dhe kompjutorët. Nëse ato nuk janë në nivelin e duhur edhe këto sisteme nuk mund të përdoren në klasa. Prandaj, duhet të bëhet përpjekje maksimale që të sigurohet internet I shpejtë dhe pandërprerë si dhe të sigurohen kompjutorë për klasat e shkollës së paku që të mund të funksionojë I tërë sistemi teknologjik dhe me këtë edhe funksionimi I paradigmes së re të mësimdhënies bazuar në teknologji funksion ky që I takon arsimtarëve. Pra, sic u rrëdhiten gjërat arsimtarët ngelen të fundit prandaj besoj se pasi të rregullohen gjërat me infrastrukturën teknologjike në shkollë arsimtarët do bëjnë maksimumin të përcjellin trendet e praktikave më të mira botërore që është përdorimi I metodave më moderne të mësimdhënies që në fakt kohën e fundit po zbatohen nëpërmjet teknologjisë në klasë. Këto të dhëna normal bëjnë kërkesë deri tek Drejtori dhe Këshilli I shkollës që urgjentisht të marrin masa për ta përmirësuar infrastrukturën teknologjike në shkollë.

### 1.53 Kemi projektorë dhe pajisje tjera teknologjike në secilën klasë



Për sa i përket pyetjes rreth përdorimit të platformave elektronike të Ministrisë së arsimit 47% e nxënësve të anketuar kanë dhënë përgjigje negative, 19% pajtohen ndërsa 14% ishin neutral. Këto përgjigje i referohet gjendjes para se të fillohet me mësimin online dhe përdorimin e platformave të ndryshme që Ministria e Arsimit vëri në dispozicion. Duhet të theksohet fakti që Ministria morri të gjitha veprimet e duhura për ta vazhduar procesin edukativo arsimor në shkollat fillore në Maqedoninë e Veriut dhe me sukses përfundoi vitin shkollor 2019/2020 duke vënë në dispozicion shkollave të gjitha platformat teknologjike për të kryer punët pa ndërprerje të procesit edukativo arsimor në shkollat fillore.


#### 1.54 Përdorim në mësim platformat elektronike të Ministrisë së arsimit



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.55 më poshtë nxjerrë në pah përgjigjet e nxënësve për sa i përket mendimit të tyre nëse janë të aftë për përdorimin e teknologjisë informative dhe sic e shohim kemi marrë përgjigje positive prej 57% të nxënësve të anketuar, 22% janë neutral dhe 21% mendojnë se nuk kanë aftësi digjitale.


#### 1.55 Jemi të aftë për të përdorur teknologjinë gjatë mësimin, në vecanti platformat teknologjike të Ministrisë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket pyetjes nëse nxënësit teknologjia në klasë i bën më aktiv rreth 70% të nxënësve pohojnë faktin që teknologjia në fakt u ndihmon atyre që të mësojnë dhe i motivon ata në mësim. Përqindje e lartë që tregon edhe vetëdije teknologjike të lartë nga ana e nxënësve në shkollën Bratstvo Migjeni. Vetëm 14% mendojnë se teknologjia nuk i motivon ata që të mësojnë. Kjo është me siguri se jo secili nxënës ka qasje në pajisje teknologjike (fatkeqësisht) prandaj Drejtori dhe Këshilli I shkollës duhet menduar ndonjë strategji për tu mundësuar nxënësve të tyre qasje në pajisje teknologjike. Me siguri akoma ka ndonjë project për furnizim të nxënësve me lap top por edhe nëse nuk ka duhet inicuar projekte të tilla që tu mundësohet të gjithëve qasje në pajisje teknologjike/ kompjutorë.


#### 1.56 Mësimdhënia bazuar në teknologji na bën më aktiv në mësim prandaj e preferojmë atë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Përsëri një pyetje që ka të bëjë me lidhjen mes paradigmës së re të mësimdhënies dhe rezultateve të të mësuarit (sic vërejtëm nga hulumtimi teorik në shumë shkolla të UE dhe SHBA lidhja ishte funksionale pra hulumtimet dëshmonin se teknologjia u ndihmon nxënësve të mësojnë më mirë ose së paku ai ishte përcepti i nxënësve gjithandej) dhe sic shohim nga Tabela 1.57 74% të nxënësve të anketuar kanë pohuar se teknologjia atyre ju ndihmon të kuptojnë koncepte më mirë dhe të mësojnë më lehtë. Gjë që edhe shkenca sic pamë më lartë në hulumtimin teorik dëshmonte.


#### 1.57 Mësimdhënia bazuar në teknologji na mundëson të tregojmë rezultate më të mira në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në pyetjen nëse mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë është më e efektive sesa mësimdhënia tradicionale 50% e nxënësve sërish japin përgjigje pozitive ndërsa vetëm 27% japin përgjigje negative, dhe 23% janë neutral. Kjo përsëri tregon se përqindja e atyre që mendojnë se teknologjia ditëve të fundit po luan një rol shumë të madh në cdo fushë e në veçanti edhe në arsim. Por, duhet të edukohen gjeneratat por edhe të ndihmohen nxënësit që të kenë qasje në teknologji, në mësimdhënie nëpërmjet teknologjisë si dhe në trajnime të ndryshme për të përdorur teknologjinë. Teknologjia sic pamë nga hulumtimi teorik rrit kohën e të mësuarit edhe pas orarit të shkollës prandaj secili fëmijë duhet patur qasje në pajisje teknologjike si dhe qasje në mësimdhënie nëpërmjet teknologjisë duke përdorur platforma të ndryshme elektronike si Google Classroom, Zoom, Google Meet, Google Docs etj.


### 1.58 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë është më e efektive se sa mësimdhënia tradicionale



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka


Sa i përket metodës Flipped Classroom sic shihet në Tabelën 1.59 shumë nxënësi nuk kanë dijeni për këtë metodë që do të thotë se ose nuk e kanë përdorur në shkollë ose edhe kur e kanë përdorur arsimtarët nuk ua kanë sqaruar se për çfarë metode bëhet fjalë. Sidoqoftë, përqindja e nxënësve që janë përgjigjur pozitivisht është 23%, ndërsa negativisht 47% dhe të tjerët kanë ngelur neutral. Është një metodë që përdoret dhe që rekomandohet të përdoret nga ekspertë të ndryshëm të mësimdhënies si dhe të ekspertëve të udhëheqjes në arsim sic është Michael Fullan (shih në brendi të punimit). Prandaj, inkurajohen drejtoriati dhe arsimtarët të promovojnë këtë metodë e cila mund të ndihmojë nxënësve të tyre që të kuptojnë koncepte të ndryshme më lehtë duke duplikuar kohën e mësimit për të kuptuar konceptet e ndryshme më mirë.

### 1.59. Metoda bashkëkohore ‘klasa e rrokullisur’(flipped classroom)përdoret nga ana e arsimtarëve



Në pyetjen rreth posedimit të telefonave të mencur nga ana e nxënësve shihet qartë që jo cdo nxënës ka mundësi për të blerë pajisje teknologjike dhe kjo dukuri po përsëritet edhe në këtë pyetje. Fatkeqësisht, kjo dukuri është e zakonitë në vendin tonë dhe kjo dukuri duhet të menaxhohet mirë. Normal, që menaxhimi i kësaj dukurie kërkon pjesëmarrje të më tepër palëve të interesit e sidomos Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut por jo vetëm. Kjo dukuri duhet trajtuar edhe nga Qeveria e shtetit por edhe nga komunat, dhe më pas edhe Këshillat e shkollës dhe Drejtoritë e shkollave. Sidoqoftë, pikënisja është në shkollë dhe Drejtoria e shkollës duhet inicuar projekte për të ndihmuar nxënësit e tyre për t'i pajisur ata me teknologji digjitale që të mund edhe ata të kyqen në mënyrë aktive në mësimin aktiv nëpërmjet teknologjisë informative. Sa më shpejtë që bëjmë këtë më shpejtë do të kyqemi në shoqërinë e dijes së shekullit 21 ku jeta pa teknologji nuk mund as të paramendohet. Le të marrim masa që sa më shpejtë të mundësojmë shkollat tona të përgadisnin nxënësit për mbijetesën në shekullin 21, shekullin e bumit teknologjik.


#### 1.60 Posedoj një telefon të mençur të cilin e përdori për cdo ditë në shtëpi



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Pyetja në tabelën 1.61 më poshtë tregon se 73% e nxënësve kanë një lap top në shtëpi dhe e përdorin atë sipas nevojës, ndërsa 11% kanë thënë që nuk kanë asnjë lap top në shtëpi dhe 6% janë neutral. Kjo përsëri tregon se shumica e nxënësve janë të përgaditur për të përdorur teknologjinë në mësim mirëpo duke patur parasysh se kemi edhe përgjigje negative kjo gjë nxit veprime në drejtim të përfshirjes së të gjithë nxënësve në qasje të barabartë në mësimdhënie nëpërmjet teknologjisë që kërkon kushtin e pasjes së qajes në pajisje teknologjike. Arsimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe individual (ky është arsimi I së ardhmes). Cdo nxënës duhet të ketë qasje të barabartë në arsim cilësor dhe në paradigmen e re të mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë.

#### 1.61 Posedoj një lap top në shtëpi dhe e përdori atë sipas nevojës



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Edhe Tabela 1.62 tregon qartë preferencën e nxënësve të shkollës Bratstvo Migjeni për të mësuar nëpërmjet metodave moderne të mësimdhënies. Projekti është njëra nga ato metoda dhe nxënësit kanë shprehur kënaqësi nga përdorimi i kësaj metode të re të mësimdhënies. Rreth 83% janë shprehur se ndjejnë kënaqësi kur mësojnë nëpërmjet projekteve, vetëm 6% nuk u pëlqen kjo mënyrë dhe kjo me siguri prapë ka të bëjë me nxënës të cilët kanë nevojë për mësim të personalizuar gjegjësisht kanë nevojë për ndihmë. Këto raste duhet identifikuar dhe menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundur.


#### 1.62 Me kënaqësi i bëj projektet shkollore nëpërmjet teknologjisë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.63 më poshtë tregon të dhënat që kanë të bëjnë me mendimin e nxënësve sa i përket përdorimit të teknologjisë në shkollën e tyre. Rezultatet janë sin e vijim: 42% janë shprehur se pajtohen se teknologjia është e patjetërsueshme në shkollë gjë që të con të mendosh se në fakti teknologjia është përditshmëri në këtë shkollë por me siguri që kushtet ndonjëherë e bënë të vetën dhe nuk mundëson që kjo gjë të avancohet. Mandje 31% janë të mendimit se arsimtarët nuk e kanë patjetër të përdorin teknologjinë në klasë. Ka një përqindje të madhe që janë neutral pra 27%. Sidoqoftë, sic përmendëm edhe më lartë rekomandohet që Drejtori i shkollës së bashku me Këshillin e Shkollës të fusin përdorimin e teknologjisë informative në klasë në kurrikulat e tyre dhe të marrin masat e nevojshme për të furnizuar të gjitha klasat me kompjutorë si dhe të ndihmohen nxënësit që nuk kanë pajisje teknologjike në shtëpi të sigurojnë atë nëpërmjet projekteve qeveritare apo locale.


### 1.63 Teknologjia në shkollën tonë nuk është e patjetërsueshme prandaj nuk e përdorim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.64 më poshtë nxjerrë në pah faktin që pjesa dërmuese e nxënësve të intervistuar kanë aftësi të përdorin kompjutorin që të shkruajnë email dhe të komunikojnë nëpërmjet rrjeteve sociale. Kjo përdëfton tezën tonë që paradigme re e mësimdhënies dhe nxënies është e patjetërsueshme pasi kemi të bëjmë me nxënës të gjeneratës Z që teknologjinë e kanë përditshmëri dhe kjo gjë duhet përdorur për të kthyer teknologjinë në përfitim për nxënësit.

### 1.64 Dij të shkruaj email (të dërgoj dokumente) dhe të komunikoj në rrjetet sociale




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.65 përmban një pyetje që mbështet mësimin tradicional dhe rezultatet janë sic shohim pozitiv tek rreth 58% të nxënësve ndërsa vetëm 15% nuk e preferojnë këtë. Kjo mund të jetë indikator që nxënësit janë mësuar të mësojnë në mënyrë tradicionale dhe nuk kanë aspak problem për të mësuar nëpërmjet metodave tradicionale.

### 1.65 Mësimdhënia tradicionale është më e mirë dhe më me kuptim






Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket nevojës për trajnim për të përdorur teknologjinë digjitale sic shihet në Tabelën 1.66 më poshtë 47% janë shprehur se nuk kanë një nevojë të tillë, ndërsa 31% janë shprehur se kanë nevojë për trajnim. Kjo nxjerrë nëpah edhe nevojën për të menaxhuar edhe këtë segment nga ana e Drejtorisë së Shkollës si dhe Këshillit të Shkollës, por edhe të Këshillit të Prindërve. Këtu bashkëpunimi me prindërit do të ishte një mënyrë më e mirë për ta menaxhuar këtë segment.


#### 1.66 Më duhet trajnim për të përdorur teknologjinë në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka


Tabela 1.67 më poshtë shfaq të dhënat e mbledhura për sa i përket perceptimit të nxënësve në lidhje me infrastrukturën teknologjike në shkollë nëse mundëson mësimdhënie modern apo jo dhe përgjigjet janë sin e vijim: 45% mendojnë se infrastruktura teknologjike mundëson zbatim të metodologjisë së re të bazuar në teknologji, nuk pajtohen 10% dhe 45% janë neutral (pra neutral në këtë rast mendojmë se janë të gjithë ata nxënës që në fakt nuk e dinë se a ka apo jo infrastrukturë të duhur shkolla për të zbatuar metodologjinë e re të mësimdhënies në shkollën e tyre.

#### 1.67 Infrastruktura teknologjike në shkollë nuk mundëson mësimdhënien të bazuar në teknologji



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.68 më poshtë nxjerrë në pah të dhënat që tregojnë se 37% e nxënësve pajtohen se për shkak se teknologjia u merrë kohë arsimtarëve dhe prandaj ata e shmangin përdorimin e tyre në klasë, ndërsa 39% nuk pajtohen. Pra, këta mendojnë se koha nuk është faktor i mospërdorimit të teknologjisë.




#### 1.68. Teknologjia u merrë kohë arsimtarëve nga koha e mësimdhënies prandaj nuk e përdorin

Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Nëse i referohemi të gjitha tabelave më sipër dhe interpretimit të të dhënave nga ato tabela do vijmë në konkluzionin që vetë nxënësit kanë ardhur gjatë dhënies së përgjigjes së pyetjes në Tabelën 1.69 më poshtë. Vetëm 34% pohojnë se arsimtarët e tyre përdorin teknologjinë informative në klasë gjatë ligjeratave të tyre, 39% nuk pajtohen, dhe shumë të tjerë janë neutral. Kjo ngrit alarmin për Drejtorinë e shkollës për të marrë të gjitha masat për të përmirësuar këtë gjendje të përshkruar nga përgjigjet e nxënësve.


#### 1.69 Arsimtarët përdorin shpesh teknologjinë gjatë ligjeratave të tyre



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Përgjigjet e nxënësve në këtë pyetje poshtë lartë janë identike me përgjigjet që kishin dhënë arsimtarët paraprakisht dhe kjo bën që të rekomandojmë angazhim më të madh të Drejtorit për të siguruar mbështetje teknike gjatë përdorimit të teknologjisë në klasë pasi ajo është shumë e nevojshme në raste kur ka problem teknike e ndodh të ketë shpesh nëpër institucione arsimore. Të dhant në Tabelën 1.70 më poshtë tregojnë se vetëm 28% pajtohen të ketë mbështetje teknike, 31% kanë mendim negative pra nuk pajtohen dhe 31% janë neutral.


#### 1.70. Kemi përkrahje teknike gjatë përdorimit të teknologjisë në rast të ndonjë problemi teknik



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa i përket pyetjes rreth modernizimit të teknologjisë në shkollën Bratstvo Migjeni rezultatet janë sin ë vijim: Vetëm 27% mendojnë se shkolla ka teknologji moderne, ndërsa 39% mendojnë se shkolla nuk posedon teknologji modern, dhe 34% janë neutral. Këto rezultate të Tabelës 1.71 më poshtë cojnë në konstatim se Drejtori duhet të merrë masa të kërkojë ndihmën e autoriteteve shtetërore për ta furnizuar shkollën me pajisje modern të teknologjisë informative në klasë.


#### 1.71 Drejtori i shkollës vazhdimisht modernizon infrastrukturën teknologjike në shkollë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Rezultatet nga pyetja rreth trajnimeve të arsimtarëve nga ana e drejtorit të shkollës tregojnë se shumica janë neutral gjë që tregon se nxënësit nuk kanë njohuri mbi këtë çështje. Vetëm 22% mendojnë se Drejtori I dërgon arsimtarët në trajnime për përdorim të teknologjisë. Dikund 41% e nxënësve të anketuar mendojnë se drejtori nuk I dërgon arsimtarët në trajnime. Sidoqoftë, me siguri që shumë arsimtarë dijnë të përdorin teknologjinë por cdoherë ka vend për më tepër njohuri mbi përdorimin e teknologjisë në pedagogji prandaj edhe trajnimet nuk guxojnë të mungojnë në këtë drejtim.

#### 1.72 Drejtori i shkollës vazhdimisht i dërgon arsimtarët në trajnime për të përdorur teknologjinë




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Kjo pyetje është e ngjashme me atë paraprake dhe ka të bëjë më tepër me organizimin e trajnimeve Brenda shkollës dhe përgjigjet janë sin ë vijim: 50% nuk pajtohen se organizohen trajnime në shkollë, 21% pajtohen dhe 29% neutral. Sërisht rekomandojmë të organizohen trajnime të vazhdueshme pasi sic mësuam edhe nga hulumtimi teorik shumë drejtorë të shkollave të UE dhe SHBA e kishin bërë rutinë çështjen e trajnimeve brenda dhe jashtë shkollave të tyre për të aftësuar dhe riaftësuar dhe mësuar arsimtarët për përdorim të teknologjisë më të re në mësimdhënie. Pra, trajnimet Brenda shkollës mund të organizohen edhe nga specialistët e teknologjisë informative në shkollë dhe mund të mos kushtojë fare. Edhe pse, ekzistojnë edhe trajnime Brenda shkollës me të ftuar nga jashtë specialiste të TI dhe mund të

kushtojë dicka por prapë jo shumë pasi rezultatet nga ato trajnime do vërehen në performancën e arsimtarëve gjatë përdorimit të TIK në mësimdhënie.


### 1.73 Drejtori vazhdimisht organizon trajnime në shkollë për arsimtarët se si të përdorin teknologjinë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa i përket vëzhgimit të mësimdhënies dhe vlerësimit të performancës së arsimtarëve 26% e nxënësve mendojnë se Drejtori gjatë vëzhgimit vlerëson edhe përdorimin e teknologjisë në klasë nga ana e arsimtarit, 42% nuk mendojnë ashtu dhe 32% janë neutral. Sidoqoftë, ashtu sic përmendëm më lartë vlerësimi duhet të përfshijë edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie që mësimdhënësit t'i kushtojnë më tepër vëmendje përdorimit të teknologjisë në mësim dhe të ligjerojnë nëpërmjet teknologjisë për t'i bërë ligjeratat e tyre më tërheqëse dhe më interesante për nxënësit.

### 1.74 Drejtori i shkollës gjatë vëzhgimit të mëimit i vlerëson arsimtarët se si dhe sa përdorin teknologjinë në mësim




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Përgjigje më të saktë rreth mendimit të prindërve rreth përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie mund të japin vetëm nxënësit pasi ata janë në kontakt të vazhdueshëm me prindërit dhe harmonizojnë

mendimet e tyre. Në këtë kontekst, tabela 1.75 më poshtë tregon mendimet e nxënësve rreth kësaj çështjeje: 66% e nxënësve mendojnë se prindërit mbështesin përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, 13% nuk e mbështesin dhe 21% janë neutral. Pasi që shumica e nxënësve janë përgjigjur pozitivisht kjo do të thotë se ekziston një përkrahje e madh nga prindërit që fëmijët e tyre teknologjinë që e kanë përditshmëri dhe e përdorin për lojë ta përdorin edhe për mësim pasi me siguri që prindërit janë të vetëdijshëm për fuqinë që teknologjia posedon si burim mësimi.

### 1.75 Prindërit mbështesin përdorimin e teknologjisë në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Bratstvo Migjeni Tetovë në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka


#### Pyetësori për nxënës të shkollës fillore Kirili dhe Metodi

Në vazhdim do të analizojmë dhe do të interpretojmë të dhënat e mbledhura nga pyetësori me nxënës të shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë. Pyetësori ishte i njëjtë sic ishte ai për shkollën tjetër Bratstvo Migjeni, pra përmbante 25 pyetje identike. U anketuan 96 nxënës në këtë shkollë.

Sic mund të shohim nga Tabela 1.76 më poshtë në pyetjen nëse kanë kompjutorë në shkollën fillore Kirili dhe Metodi 57% pohojnë se nuk kanë kompjutorë në klasat e shkollës së tyre. Edhe pse përqindja e nxënësve të shkollës Kirili dhe Metodi është më e vogël se e asaj të shkollës Bratstvo që ishte 74% nga numri total i nxënësve të anketuar prapë se prapë kjo përqindje tejkalon pragun e 50% të nxënësve të anketuar dhe sinjalizon që nxënësit konsiderojnë se nuk ka mjaftueshëm pajisje kompjuterike në shkollën e tyre. Përqindja e atyre nxënësve që pajtohen, gjegjësisht që kanë dhënë përgjigje pozitive është vetëm 21% që është më e madhe krahasur me shkollën që ishte vetëm 8% por prapë se prapë përqindja ngel e vogël. Përqindja e nxënësve që kanë dhënë përgjigje neutral është 22%. Këto të dhëna janë indikator që situata në këtë shkollë për sa i përket kompjutorëve nuk është në nivelin e duhur, pra ka mungesë të kompjutorëve nëpër klasat e shkollës. Si pasojë e kësaj situatë me siguri që edhe arsimtarët janë në situatë të rëndë për të zbatuar paradigmen e re të mësimdhënies bazuar në teknologji në shkollën Kirili dhe Metodi. Prandaj, nga kjo situatë mund të konstatojmë se ka nevojë për veprim urgjent të Drejtorit të shkollës për sa i përket prokurimeve të kompjutorëve në shkollë dhe furnizimin e klasave në shkollë me kompjutorë, bile bile ashtu sic mësuam edhe nga hulumtimi teorik Menaxhmenti i shkollës duhet urgjentisht të fus në kurrikulat shkollore përdorimin e teknologjisë në mësim dhe me këtë të bëjë të

patjetërsueshëm furnizimin e klasave në shkollën Kirili dhe Metodi me kompjutorë. Sic përmendëm më sipër hulumtimi teorik na siguroi informata të cilat përdëftonin tezën se mësimi nëpërmjet teknologjisë rrit nivelin e të mësuarit dhe dijeve të nxënësit prandaj edhe Menaxhmenti i kësaj shkolle duhet të rrit nivelin e përdorimit të teknologjisë në klasë për të rritur rezultatet e të mësuarit dhe dijeve tek nxënësit e kësaj shkolle.


#### 1.76 Kemi kompjutorë në secilën klasë dhe arsimtarët i përdorin ato gjatë mësimdhënies :



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa ipërket pyetjes në lidhje me internetin në shkollë përsëri shohim një përqindje të mirëfilltë (40%) e nxënësve mohojnë të kenë internet në shkollë dhe të përdorin të njëjtin në mësim. Kjo përqindje është më e vogël se tek shkolla paraprake që ishte 65%. 39% të nxënësve pajtohen që ka internet në shkollë dhe se i njëjti përdoret në mësim. Kjo situatë del të jetë më e mirë në shkollën fillore Kirili dhe Metodi se sa në shkollën Bratstvo Migjeni edhe pse edhe në këtë shkollë të dhënat tregojnë që kërkohet përmirësim në këtë aspekt.


#### 1.77 Kemi internet në shkollë dhe e përdorim atë në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Edhe tek pyetja që nëse në klasat e shkollës Kirili dhe Metodi ka projektorë dhe pajisje tjera teknologjike prapë përgjigjet negative arrijnë 42% të nxënësve (shih Tabelën 1.78 më poshtë). Rreth 47% të nxënësve të anketuar pohojnë se ka projektorë dhe pajisje tjera digjitale në klasa. Kjo përqindje është dyfish më e lartë se tek shkolla paraprake që ishte vetëm 24% gjë që bën këtë shkollë më të avancuar në aspektin teknologjik.


### 1.78. Kemi projektorë dhe pajisje tjera teknologjike në secilën klasë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket pyetjes rreth përdorimit të platformave elektronike të Ministrisë së arsimit 40% e nxënësve të anketuar kanë dhënë përgjigje positive dhe 35% kanë dhënë përgjigje negative, 25% janë neutral (shih tabelën më 1.79 poshtë. Këtu përgjigjet janë të ndara dhe numerikisht të përafërta që tregon se me siguri ka përdorim të platformave elektronike nga ana e Ministrisë së Arsimit edhe atë tani me zhvendosjen e mësimdhënies online me siguri ka përdorim të platformave elektronike të Ministrisë së Arsimit.

### 1.79 Përdorim në mësim platformat elektronike te Ministrisë së arsimit




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.80 më poshtë nxjerrë në pah përgjigjet e nxënësve për sa i përket mendimit të tyre nëse janë të aftë për përdorimin e teknologjisë informative dhe sic e shohim kemi marrë përgjigje positive prej 56% të nxënësve të anketuar që është pothuajse identike me npërgjigjet e nxënësve të shkollës paraprake që ishte 57%. Përgjigje negative kanë dhënë 25% të nxënësve që është për 4% (prapë shumë afër) më e lartë se tek shkolla paraprake. Sic mund të konstatojmë nxënësit konsiderojnë se kanë aftësi për të përdorur teknologjinë në mësim në të dy shkollat.

### 1.80 Jemi të aftë për të përdorur teknologjinë gjatë mësim, në vecanti platformat teknologjike të Ministrisë






Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket pyetjes nëse nxënësit teknologjia në klasë I bën më aktiv rreth 60% të nxënësve pohojnë faktin që teknologjia në fakt u ndihmon atyre që të mësojnë dhe i motivon ata në mësim. Përqindje e lartë që tregon edhe vetëdije teknologjike të lartë nga ana e nxënësve në shkollën Kirili dhe Metodi. Vetëm 15% mendojnë se teknologjia nuk i motivon ata që të mësojnë. 25% të nxënësve janë neutral. Poshtë lartë rezzultatet janë identike me shkollën paraprake. Duhet punaur më tepër që të gjithë nxënësit të shijojnë përfitimet e teknologjisë në mësim.


#### 1.81 Mësimdhënia bazuar në teknologji na bën më aktiv në mësim prandaj e preferojmë atë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Përsëri një pyetje që ka të bëjë me lidhjen mes paradigmës së re të mësimdhënies dhe rezultateve të të mësuarit (sic vërejtëm nga hulumtimi teorik në shumë shkolla të UE dhe SHBA lidhja ishte funksionale pra hulumtimet dëshmonin se teknologjia u ndihmon nxënësve të mësojnë më mirë ose së paku ai ishte percepti i nxënësve gjithandëj) dhe sic shohim nga Tabela 1.82 63% të nxënësve të anketuar kanë pohuar se teknologjia atyre ju ndihmon të kuptojnë koncepte më mirë dhe të mësojnë më lehtë. Gjë që edhe shkenca sic pamë më lartë në hulumtimin teorik dëshmonte. Duhet theksuar se përqindja e përgjigjeve positive në shkollën paraprake ishte më e lartë pra 74%.


### 1.82 Mësimdhënia bazuar në teknologji na mundëson të tregojmë rezultate më të mira në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në pyetjen nëse mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë është më e efektshme sesa mësimdhënia tradicionale përgjigjet janë të ndara 35 pozitive kundrejt 34% negative. Ka akoma një numër të madh të nxënësve që preferojnë metodat tradicionale të mësimdhënies dhe kjo është me siguri për shkak se metodat e reja të bazuara në teknologji nuk gjejnë zbatim të madh për shkak kushteve në shkollat fillore.

### 1.83 Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë është më e efektshme se sa mësimdhënia tradicionale




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa i përket metodës Flipped Classroom sic shihet në Tabelën 1.84 shumë nxënës nuk kanë dijeni për këtë metodë që do të thotë se ose nuk e kanë përdorur në shkollë ose edhe kur e kanë përdorur arsimtarët nuk ua kanë sqaruar se për çfarë metode bëhet fjalë. Sidoqoftë, përqindja e nxënësve që janë përgjigjur pozitivisht është 38%, ndërsa negativisht 32% dhe të tjerët kanë ngelur neutral (30%). Është një metodë që përdoret dhe që rekomandohet të përdoret nga ekspertë të ndryshëm të mësimdhënies si dhe të ekspertëve të udhëheqjes në arsim sic është Michael Fullan (shih në brendi të punimit). Prandaj, inkurajohen drejtoriat dhe arsimtarët të promovojnë këtë metodë e cila mund të ndihmojë nxënësve të

tyre që të kuptojnë koncepte të ndryshme më lehtë duke duplikuar kohën e mësimi për të kuptuar konceptet e ndryshme më mirë.


#### 1.84. Metoda bashkëkohore “klasa e rrokullisur”(flipped classroom)përdoret nga ana e arsimtarëve



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Në pyetjen rreth posedimit të telefonave të mencur nga ana e nxënësve shihet qartë që përqindja e atyre nxënësve që janë përgjigjur pozitivisht është shumë e lartë 82%, pork a edhe të tillë që nuk kanë (5%). Sic përmenda më lartë jo cdo nxënës ka mundësi për të blerë pajisje teknologjike dhe kjo dukuri po përsëritet edhe në këtë pyetje. Fatkeqësisht, kjo dukuri është e zakonitë në vendin tonë dhe kjo dukuri duhet të menaxhohet mirë. Normal, që menaxhimi I kësaj dukurie kërkon pjesëmarrje të më tepër palëve të interest e sidomos Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut por jo vetëm. Kjo dukuri duhet trajtuar edhe nga Qeveria e shtetit por edhe nga komunat, dhe më pas edhe Këshillat e shkollës dhe Drejtoritë e shkollave. Sidoqoftë, pikënisja është në shkollë dhe Drejtoria e shkollës Kirili dhe Metodi duhet inicuar projekte për të ndihmuar nxënësit e tyre për t’I pajis ata me teknologji digjitale që të mund edhe ata të kyqen në mënyrë active në mësimin aktiv nëpërmjet teknologjisë informative. Sa më shpejtë që bëjmë këtë më shpejtë do të kyqemi në shoqërinë e dijes së shekullit 21 ku jeta pa teknologji nuk mund as të paramendohet. Le të marrim masa që sa më shpejtë të mundësojmë shkollat tona të përgadisnin nxënësit për mbijetesën në shekullin 21, shekullin e bumit teknologjik.

#### 1.85 Posedoj një telefon të mençur të cilin e përdori për cdo ditë në shtëpi



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Pyetja në tabelën 1.86 më poshtë tregon se pjesa dërmuese e nxënësve (82%) kanë një lap top në shtëpi dhe e përdorin atë sipas nevojës, ndërsa 11% kanë thënë që nuk kanë asnjë lap top në shtëpi dhe 7% janë neutral. Kjo përsëri tregon se shumica e nxënësve të shkollës Kirili dhe Metodi janë të përgaditur për të përdorur teknologjinë në mësim mirëpo duke patur parasysh se kemi edhe përgjigje negative kjo gjë nxit veprime në drejtim të përfshirjes së të gjithë nxënësve në qasje të barabartë në mësimdhënie nëpërmjet teknologjisë që kërkon kushtin e pasjes së qajës në pajisje teknologjike. Arsimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe individual (ky është arsimi I së ardhmes). Cdo nxënës duhet të ketë qasje të barabartë në arsim cilësor dhe në paradigmen e re të mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë.


#### 1.86 Posedoj një lap top në shtëpi dhe e përdori atë sipas nevojës



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Edhe Tabela 1.87 tregon qartë preferencën e nxënësve të shkollës Kirili dhe Metodi për të mësuar nëpërmjet metodave moderne të mësimdhënies. Projekti është njëra nga ato metoda dhe nxënës të cilët kanë shprehur kënaqësi nga përdorimi i kësaj metode të re të mësimdhënies. Rreth 82% identike me shkollën Bratsvo (83%) janë shprehur se ndjejnë kënaqësi kur mësojnë nëpërmjet projekteve, vetëm 5% nuk u pëlqen kjo mënyrë dhe kjo me siguri prapë ka të bëjë me nxënës të cilët kanë nevojë për mësim të personalizuar gjegjësisht kanë nevojë për ndihmë. Këto raste duhet identifikuar dhe menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundur.


#### 1.87 Me kënaqësi i bëj projektet shkollore nëpërmjet teknologjisë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.88 më poshtë tregon të dhënat që kanë të bëjnë me mendimin e nxënësve sa i përket përdorimit të teknologjisë në shkollën e tyre. Rezultatet janë sin ë vijim: 22% janë shprehur se pajtohen se teknologjia është e patjetërsueshme në shkollën e tyre. Mandej 37% janë të mendimit se arsimtarët nuk e kanë patjetër të përdorin teknologjinë në klasë. Ka një përqindje të madhe që janë neutral pra 41%. Sidoqoftë, sic përmendëm edhe më lartë rekomandohet që Drejtori I shkollës së bashku me Këshillin e Shkollës të fusin përdorimin e teknologjisë informative në klasë në kurrikulat e tyre dhe të marrin masat e nevojshme për të furnizuar të gjitha klasat me kompjutorë si dhe të ndihmohen nxënësit që nuk kanë pajisje teknologjike në shtëpi të sigurojnë atë nëpërmjet projekteve qeveritare apo locale. Si dhe të vendosin në formularët e vëzhgimeve grafë për përdorim të teknologjisë gjë që do detyronte arsimtarët të përdorin teknologjinë në mësimdhënie.


### 1.88 Teknologjia në shkollën tonë nuk është e patjetërsueshme prandaj nuk e përdorim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.89 më poshtë nxjerrë në pah faktin që 92% e nxënësve të intervistuar kanë aftësi të përdorin kompjutorin që të shkruajnë email dhe të komunikojnë nëpërmjet rrjeteve sociale. Kjo përdëfton tezën tonë që paradigm e re e mësimdhënies dhe nxënies është e patjetërsueshme pasi kemi të bëjmë me nxënës të gjeneratës Z që teknologjinë e kanë përditshmëri dhe kjo gjë duhet përdorur për të kthyer teknologjinë në përfitim për nxënësit. Vetëm 3% nuk janë pajtuar që mund të interpretohet edhe si një alert për drejtorinë e shkollës që të shohë se a mundet disi të ndihmohen nxënësit që nuk kanë mundësi të kenë pajisje teknologjike në shtëpi dhe prandaj edhe mund të kenë mungesë të dijes për përdorimin e pajisjeve teknologjike. Duhet të hetohet ajo pjesë e vogël e nxënësve dhe të trajtohen në mënyrën më të mirë të mundur.


### 1.89 Dij të shkruaj email (të dërgoj dokumente) dhe të komunikoj në rrjetet sociale



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.90 përmban një pyetje që mbështet mësimin tradicional dhe rezultatet janë sic shohim pozitiv tek rreth 55% të nxënësve ngjashëm me shkollën tjetër që kishte 58% të nxënësve të anketuar, ndërsa vetëm 17% nuk e preferojnë këtë. Kjo mund të jetë indikator që nxënësit janë mësuar të mësojnë në mënyrë tradicionale dhe nuk kanë aspak problem për të mësuar nëpërmjet metodave tradicionale.


### 1.90 Mësimdhënia tradicionale është më e mirë dhe më me kuptim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Për sa i përket nevojës për trajnim për të përdorur teknologjinë digjitale sic shihet në Tabelën 1.91 më poshtë 62% janë shprehur se nuk kanë një nevojë të tillë që bën një përqindje pak më të lartë se tek nxënësit e shkollës tjetër që ishte 47%, ndërsa 14% janë shprehur se kanë nevojë për trajnim. Situata del pak më e mirë me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi se Bratstvo Migjeni.


### 1.91 Më duhet trajnim për të përdorur teknologjinë në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Tabela 1.92 më poshtë shfaq të dhënat e mbledhura për sa i përket perceptcionit të nxënësve në lidhje me infrastrukturën teknologjike në shkollë nëse mundëson mësimdhënie modern apo jo dhe përgjigjet janë si në vijim: 17% mendojnë se infrastruktura teknologjike mundëson zbatim të metodologjisë së re të bazuar në teknologji, 29% pajtohen se nuk mundëson dhe 54% janë neutral (pra neutral në këtë rast mendojmë se janë të gjithë ata nxënës që në fakt nuk e dinë se a ka apo jo infrastrukturë të duhur shkolla për të zbatuar metodologjinë e re të mësimdhënies në shkollën e tyre). Pra, vetëm një numër i vogël i nxënësve konsideron se infrastruktura teknologjike e shkollës është në nivelin e duhur për të zbatuar paradigmen e re të mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë informative.


### 1.92 Infrastruktura teknologjike në shkollë nuk mundëson mësimdhënien të bazuar në teknologji



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënës të shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka


Tabela 1.93 më poshtë nxjerrë në pah të dhënat që tregojnë se 38% e nxënësve pajtohen se për shkak se teknologjia u merrë kohë arsimtarëve ata e shmangin përdorimin e teknologjisë në klasë, ndërsa 42% nuk pajtohen. Përqindja është shumë e përafërt me përqindjen e nxënësve të anketuar në shkollën tjetër. Pra, mendimet e nxënësve janë të ndarë, disa besojnë se për shkak kohës arsimtarët nuk përdorin teknologjinë ndërsa të tjerët nuk ndajnë atë mendim. Kat e tillë që janë neutral, 20%.

### 1.93 Teknologjia u merrë kohë arsimtarëve nga koha e mësimdhënies prandaj nuk e përdorin



Nëse i referohemi të gjitha tabelave më sipër dhe interpretimit të të dhënave nga ato tabela do vijmë në konkluzionin që vetë nxënësit kanë ardhur gjatë dhënies së përgjigjes së pyetjes në Tabelën 1.94 më poshtë. Vetëm 32% pohojnë se arsimtarët e tyre përdorin teknologjinë informative në klasë gjatë ligjeratave të tyre, 39% nuk pajtohen. Interesant që përgjigjet pothuajse janë të njëjta të këtyrë nxënësve krahasuar me nxënësit e shkollës tjetër. Pra, kemi nxënës të zgjuar dhe shumë të sinqertë. Mirëpo, kjo nga ana tjetër ngrit alarmin për Drejtorinë e shkollës për të marrë të gjitha masat për të përmirësuar këtë gjendje të përshkruar nga përgjigjet e nxënësve.

#### 1.94 Arsimitarët përdorin shpesh teknologjinë gjatë ligjeratave të tyre




Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Përgjigjet e nxënësve në këtë pyetje në tabelën 1.95 më poshtë janë identike me përgjigjet që kishin dhënë arsimtarët paraprakisht dhe kjo bën që të rekomandojmë angazhim më të madh të Drejtorit për të siguruar mbështetje teknike gjatë përdorimit të teknologjisë në klasë pasi ajo është shumë e nevojshme në raste kur ka problem teknike e ndodh të ketë shpesh nëpër institucione arsimore. Të dhant në Tabelën 1.95 më poshtë tregojnë se vetëm 33% nuk pajtohen se kanë përkrahjen e duhur teknike që është indikator për mungesë të mbështetjes teknike në shkollë.

#### 1.95 Kemi përkrahje teknike gjatë përdorimit të teknologjisë në rast të ndonjë problemi teknik






Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa i përket pyetjes rreth modernizimit të teknologjisë në shkollën Kirili dhe Metodi rezultatet janë sin ë vijim: 45% mendojnë se Drejtori I shkollës vazhdimisht modernizon teknologjinë informative në shkollën Kirili dhe Metodi (pothuajse përqindje e dyfishtë me përqindjen e nxënësve që janë përgjigjur njëjtë në shkollën Bratstvo Migjeni), ndërsa 23% mendojnë se kjo gjë nuk ndodh, dhe 32% janë neutral. Këto rezultate të Tabelës 1.96 më poshtë cojnë në konstatim se Drejtori ka vepruar vazhdimisht në drejtim të modernizimit të teknologjisë në shkollë dhe kjo gjë është vërejtur edhe nga nxënësit.


#### 1.96 Drejtori i shkollës vazhdimisht modernizon infrastrukturën teknologjike në shkollë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Rezultatet nga pyetja rreth trajnimeve të arsimtarëve nga ana e drejtorit të shkollës tregojnë se shumica janë neutral gjë që tregon se nxënësit nuk kanë njohuri mbi këtë çështje. Vetëm 31% mendojnë se Drejtori I dërgon arsimtarët në trajnime për përdorim të teknologjisë. Dikund 36% e nxënësve të anketuar mendojnë se drejtori nuk I dërgon arsimtarët në trajnime. Sidoqoftë, me siguri që shumë arsimtarë dijnë të përdorin teknologjinë por cdoherë ka vend për më tepër njohuri mbi përdorimin e teknologjisë në pedagogji prandaj edhe trajnimet nuk guxojnë të mungojnë në këtë drejtim. Sidoqoftë, përqindja e nxënësve që janë përgjigjur pozitiv është indikator se Drejtori ka vepruar në këtë drejtim.


### 1.97 Drejtori i shkollës vazhdimisht i dërgon arsimtarët në trajnime për të përdorur teknologjinë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Kjo pyetje është e ngjashme me atë paraprake dhe ka të bëjë më tepër me organizimin e trajnimeve brenda shkollës dhe përgjigjet janë si në vijim: 38% nuk pajtohen se organizohen trajnime në shkollë, 24% pajtohen dhe 38% neutral. Kjo tregon se nxënësit nuk kanë vërejtur ndonjë aktivitetet në shkollë në lidhje me trajnimin e arsimtarëve për të përdorur TIK në mësimdhënie. Sërisht rekomandojmë të organizohen trajnime të vazhdueshme pasi sic mësuam edhe nga hulumtimi teorik shumë drejtorë të shkollave të UE dhe SHBA e kishin bërë rutinë çështjen e trajnimeve brenda dhe jashtë shkollave të tyre për të aftësuar dhe riaftësuar dhe mësuar arsimtarët për përdorim të teknologjisë më të re në mësimdhënie. Pra, trajnimet brenda shkollës mund të organizohen edhe nga specialistët e teknologjisë informative në shkollë dhe mund të mos kushtojë fare. Edhe pse, ekzistojnë edhe trajnime brenda shkollës me të ftuar nga jashtë specialiste të TI dhe mund të kushtojë dicka por prapë jo shumë pasi rezultatet nga ato trajnime do vërehen në performancën e arsimtarëve gjatë përdorimit të TIK në mësimdhënie.


### 1.98 Drejtori vazhdimisht organizon trajnime në shkollë për arsimtarët se si të përdorin teknologjinë



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Sa i përket vëzhgimit të mësimdhënies dhe vlerësimit të performancës së arsimtarëve 34% e nxënësve mendojnë se Drejtori gjatë vëzhgimit vlerëson edhe përdorimin e teknologjisë në klasë nga ana e arsimtarit, 39% nuk mendojnë ashtu dhe 37% janë neutral. Sidoqoftë, ashtu sic përmendëm më lartë vlerësimi duhet të përfshijë edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie që mësimdhënësit t'i kushtojnë më tepër vëmendje përdorimit të teknologjisë në mësim dhe të ligjerojnë nëpërmjet teknologjisë për t'i bërë ligjeratat e tyre më tërheqëse dhe më interesante për nxënësit.


#### 1.99 Drejtori i shkollës gjatë vëzhgimit të mësimi i vlerëson arsimtarët se si dhe sa përdorin teknologjinë në mësim



Të dhënat janë nxjerrë nga pyetësorët me nxënësit e shkollës fillore Kirili dhe Metodi në Tetovë – Përgaditi Fazlije Ceka

Përgjigje më të saktë rreth mendimit të prindërve rreth përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie mund të japin vetëm nxënësit pasi ata janë në kontakt të vazhdueshëm me prindërit dhe harmonizojnë mendimet e tyre. Në këtë kontekst, tabela 1.100 më poshtë tregon mendimet e nxënësve rreth kësaj çështjeje: 71% e nxënësve mendojnë se prindërit mbështesin përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, 13% nuk pajtohen me këtë pohim dhe 16% janë neutral. Pasi që shumica e nxënësve janë përgjigjur pozitivisht kjo do të thotë se ekziston një përkrahje e madhe nga prindërit që fëmijët e tyre teknologjinë që e kanë përditshmëri dhe e përdorin për lojë ta përdorin edhe për mësim pasi me siguri që prindërit janë të vetëdijshëm për fuqinë që teknologjia posedon si burim mësimi.

#### 1.100. Prindërit mbështesin përdorimin e teknologjisë në mësim



## **Analiza dhe interpretimi i të dhënave nga intervistat me drejtorët**

Drejtori i shkollës fillore Kirili dhe Metodi thotë se sot jeta pa teknologji as që mund të paramendohet. Por, shfrytëzimi i teknologjisë ka anët positive dhe negative. Teknologjia u ndihmon në vecanti nxënësve në mësim pasi pajisjet teknologjike u sigurojnë atyre cdo informatë për të cilën ata kanë nevojë. Por, nëse teprohet me përdorim ndikon negativisht.

Sipas drejtorit shkolla ka mjaft teknologji dhe arsimtarët e përdorin atë aq sa është e nevojshme dhe sipas përmbajtjeve mësimore.

Sipas drejtorit shkolla ka ËIFI arsimtarët kanë lap topët e tyre dhe klasat janë të pajisura me projektorë. Komunikimi me stafin bëhet sipas nevojës, ndërsa me prindër dhe institucione tjera me anë të telefonit, emailit, etj.

Sipas drejtorit shumica e arsimtarëve përdorin TIK në procesin e mësimdhënies dhe nxënies me përjashtim të disa arsimtarëve.

Shkolla ka aftësi financiare për të blerë teknologji të re në shkollë.

Sipas drejtorit të shkollës gjenerata më e re e nxënësve janë më të avancuar në teknologji dhe se mësimi klasik për ta është i bezdisshëm. Ata pra preferojnë mësimin nëpërmjet teknologjisë.

Përdorimi i iteknologjisë në mësim është nevojë e kohës prandaj përdorimi i teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies duhet intensifikuar.

Sipas drejtorit arsimtarët kanë pasur disa trajnime interne pra në shkollë për të krijuar përmbajtje elektronike që jo gjithnjë të marrin ato të gatshme nga internet. Disa nga ato vegla janë: STORY BIRO, LINOIT, GOO ANIMATE etj.

Sipas drejtorit të shkollës shkolla ka përkrahës teknik arsimtaren e informatikës si dhe një administrator të jashtëm që mirëmbajnë pajisjet teknologjike në shkollë.

Sipas drejtorit të shkollës metodat më të reja të mësimdhënies që ligjeratat i bëjnë shumë interesante, zbavitëse, dhe arrihet qëllimi i orës mësimore. Metodatat janë Bingo Ylli i Tregimit, Pesëvargëshi, Stop, Prizma, Diagrami i Venit, T-Tabela, e shumë metoda të tjera.

Sipas drejtorit të shkollës gjatë vëzhgimit drejtori i vlerëson arsimtarët se a përdorin teknologjinë në mësim pasi në formular ekziston pyetje se a përdorin arsimtari TIK në mësim.

## **Analiza dhe interpretimi i të dhënave nga intervistat me anëtarët e këshillit të Shkollës Fillore Kirili dhe Metodi**

Tre anëtarët e Këshillit të shkollës fillore Kirili dhe Metodi vlerësojnë se teknologjia luan një rol shumë të madh në arsim. Sipas tyre nxënësit nëpërmjet teknologjisë zhvillojnë aftësitë e tyre hulumtuese, creative dhe fantazinë e tyre. Por ata vlerësojnë se tek nxënësit më të dobët prania e arsimitarit për ndihmë është e patjetërsueshme. Tre anëtarët e Këshillit të shkollës vlerësojnë se arsimitari është i domosdoshëm dhe luan rolin kryesor në klasë. Sipas tyre njeriu nuk është robot dhe elementin shpirtëror nuk e plotëson asnjë lloj teknologjie.

Anëtarët e këshillit përdorin teknologjinë për arsye se vlerësojnë se rrit cilësinë e mësimdhënies, lehtëson punën e arsimitarit, rritet vizualiteti, efektet jepen në mënyrë më të përsosur

Sipas anëtarëve të Këshillit mungesa e plotësimit të infrastrukturës teknologjike pasi duhen shumë investime si dhe problemet me internetin në shkollë.

Sa i përket bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit apo OJQ në lidhje me investimet në infrastrukturën teknologjike në shkollë anëtarët e Këshillit nuk kanë informata.

Anëtarët e Këshillit vlerësojnë angazhimin e drejtorit të shkollës I cili mundohet të fusë në përdorim teknologjinë në mësimdhënie dhe nxënie në së paku 30% të planit mësimor por nga ana tjetër kërkojnë që të vazhdohet edhe më tej me investime në teknologji dhe përmirësimin e kushteve në shkollë.

Trajnimet bëhen sipas nevojës që kanë.

Sa i përket TI përkrahjes teknike anëtarët e Këshillit nuk kishin info apo deklaronin se arsimitarja e informatikës u ndihmon kur kanë nevojë.

Anëtarët e Këshillit mendojnë se metodat e reja të bazuara në teknologji vërtet kanë ndihmuar në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies. Njëri anëtar thotë që gërvshëtimi I të vjetrës me të rejën jep rezultate edhe më të mira.

Në fund anëtarët kërkojnë më tepër pjesëmarrje në projekte për të përmirësuar infrastrukturën teknologjike në shkollë, avancimin e kuadrit arsimor, përmirësim të kushteve në shkollë për të qenë në hap me kohën.

## **Analiza dhe interpretimi i të dhënave nga intervistat me arsimtarët**

Të dhënat e mbledhura nga intervistat me arsimtarët tregojnë se shumica e arsimtarëve janë të mendimit që teknologjia luan rol pozitiv në procesin e mësimdhënies dhe nxënies dhe prandaj duhet t'i kushtohet më tepër vëmendje përdorimit të saj në arsim. Ka edhe të tillë që mendojnë se teknologjia ndikon negativisht në arsim por numri arsimtarëve që mendojnë kështu është i vogël (2 nga 10 arsimtarë të intervistuar).

Sa i përket përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies të gjithë arsimtarët e intervistuar pohojnë se përdorin teknologjinë në mësimdhënie duke dhënë arsye të ndryshme si psh disa u përgjigjën që teknologjia ua bënë jetën më të lehtë, disa që është e nevojshme të përdoret në arsim, mësimi bëhet më interaktiv si dhe për shkak të ecurisë më të mirë të procesit të mësimdhënies dhe nxënies por a edhe të tillë që thuan se janë të detyruar.

Sa i përket pajisjeve teknologjike që arsimtarët përdorin në mësimdhënie dhe se ato pajisje a janë personale apo të shkollës shumica e arsimtarëve janë përgjigjur që përdorin lap top personal dhe të shkollës, kompjutorë të shkollës, si dhe projektorë dhe smartboards.

Për sa i përket platformave elektronike arsimtarët janë përgjigjur pozitivisht. Ata pohojnë se përdorin Edmodo, Zoom, Skype etj. Këto platforma me siguri përdorin tani kur mësimi mbahet online.

Sa i përket metodave mësimore që arsimtarët përdorin në procesin e mësimdhënies dhe nxënies arsimtarët numërojnë metodat sin ë vijim: Kuize, Prezantime, Interaktive, Punë në grupe, You Tube, Metoda komunikimi, Të menduarit kritik me anë të Cluster (grumbullim idesh), Diskutim, Hulumtim, Krahësim, Vetëvlerësim, Bashkëpunim në laboratorin e kompjutorëve në shkollë etj.

Për sa i përket efikasitetit të metodave modern vis a vis metodave tradicionale 80% e arsimtarëve pohojnë se metodat moderne janë më efikase (shumë më efikase) se sa ato tradicionale por 20% e mendojnë të kundërtë që metodat tradicionale akoma janë më efikase se ato modern të bazuar në teknologji.

Sa i përket bashkëpunimit kolegjal në drejtim të përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies 80% e arsimtarëve janë përgjigjur që kanë një lloj bashkëpunimi disa thuan në nivel të lartë disa tëmesëm por a edhe të tillë që mendojnë se ky bashkëpunim është deri dikund (20%).

Sa i përket efikasitetit të teknologjisë në mësim shumica e arsimtarëve janë të mendimit që efektiviteti i teknologjisë në mësim është prej i mesëm deri tek i lartë por ka edhe të tillë prapë 20% që mendojnë se nuk ka efekt përdorimi i teknologjisë në mësim.

Për sa i përket pajisjeve elektronike në shkollë arsimtarët kanë shënuar këto pajisje sin ë vijim: SmartBoard (tabela elektronike), cabinet laboratorik (informatike), projektorë, lap top. Dy arsimtarë deklaruan se pajisje ka në shkollë por nuk punojnë. Po ashtu ata thonë se nuk kanë presion për të përdorur të njejtat.

Sa i përket përfitimeve nga përdorimi i teknologjisë arsimtarët pohojnë se teknologjia u ndihmon atyre për t'i bërë ligjeratat më interactive, ka më tepër bashkëpunim mes arsimtarëve dhe nxënësve por edhe vetëm mes nxënësve. Disa arsimtarë deklaruan se ligjeratat nëpërmjet teknologjisë për nxënësit janë më tërheqëse ata pra kënaqen kur përdoret teknologjia në mësim si dhe janë më të vëmendshëm kur përdoret teknologjia në mësim. Sfida është se disa arsimtarë nuk dinë të përdorin teknologjinë dhe kolegët e tyre u ndihmojnë atyre.

Arsimtarët janë dërguar për trajnim nga ana e shkollës si dhe Ministrisë së Arsimit për Kahoot, Microbit, Përdorim të projektorëve. Kishte edhe arsimtarë (20%) që kanë deklaruar se nuk kanë pasur asnjë trajnim.

Sa i përket ndihmës që trajnimi u ka dhënë arsimtarëve pothuajse të gjithë që kishin qenë në trajnime janë përgjigjur pozitivisht.

Në pyetjen se a është i detyrueshëm zhvillimi profesional arsimtarët deklaruan që po edhe pse kishte arsimtarë që thonin se vullnetarisht kanë shkuar në trajnim për përdorim të teknologjisë.

Për sa i përket specialistit për mbështetje teknologjike disa nga arsimtarët nuk kanë njohuri që ekziston një person i tillë në shkollë pasi nuk kanë marrë ndihmë nga ai person nëse ekziston, të tjerët thuan që arsimtari I informatikës u ndihmon atyre dhe të tjerët thuan që ka person që u ndihmon pa specifikuar se kush është ai person gjegjësisht në çfarë pozite është ai person në shkollë. Të tjerë thonë se kanë njohuri dhe nuk kanë nevojë për ndihmë.

Sa i përket drejtorit arsimtarët thuan se ai ka bërë investime në teknologji por që nuk i detyron ata të përdorin teknologjinë në mësim. Kat ë tillë që deklarojnë se drejtori kërkon që teknologjia të përdoret por më së shumti deklarojnë që drejtori mbështet arsimtarët dhe i nxit ata të përdorin teknologjinë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Drejtoria e përkrah përdorimin e teknologjisë dhe drejtori ka konkuruar në disa projekte për ta furnizuar shkollën me teknologji si tabela intelegjente, mirobita, projektorë, etj.

Në fund arsimtarët kanë deklaruar se teknologjia u ka ndihmuar si arsimtarëve po ashtu edhe nxënësve në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.

### **Analiza dhe interpretimi i të dhënave nga intervistat me anëtarët e këshillit të prindërve të shkollës fillore Migjeni**

Shumica e anëtarëve të Këshillit të prindërve mendojnë se teknologjia pozitivisht ndikon në procesin e mësimdhënies. Ata pohojnë se fëmijtë e tyre përdorin teknologjinë në shtëpi për të mësuar dhe hulumtuar duke qenë që bëjnë projekte në shkollë. Sa i përket pajisjeve teknologjike fëmijtë në shtëpi posedojnë lap top, tablet, PC, Mobil. Ka edhe të tillë që nuk kanë as lap top e as PC (kompjutor). Platformat Classroom, Edmodo etj përdorin si platforma elektronike për mësim. Këshilli I prindërve vlerëson lartë komunikimin me arsimtarët por a të tillë që thonë se nuk kanë ndonjë bashkëpunim të duhur.

Për sa i përket efikasitetit të paradigmes së re të mësimdhënies dhe nxënies anëtarët e Këshillit të prindërve mendojnë se tash në kohë pandemie është përdorur teknologjia shumë por që derisa fëmijtë kanë qenë në shkollë kjo gjë është bërë më rrallë.

Sa i përket pajisjeve ata mendojnë se klasat nuk kanë kompjuterë por vetëm kabinetin e informatikës. Po ashtu ka edhe internet.

Puna e drejtorit vlerësohet lartë. Ata thonë se drejtori është i lëmisë së teknologjisë informative kështu që ai favorizon përdorimin e teknologjisë në mësim. Ka edhe të tillë që nuk kishin info për punën e drejtorit.

Të bëhet furnizimi i shkollës me teknologji digjitale përkatëse, të ketë internet të mirë, reforma në programet shkollore, depolitizimi i arsimit.

### **Analiza dhe interpretimi i të dhënave nga intervistat me TI specialistin në SHF Kirili dhe Metodi**

Teknologjia ndikon pozitivisht në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Po ashtu aftësimi i nxënësve për të përdorur teknologjinë po ashtu u ndihmon nxënësve që në shkollimin e mëtejshëm të tyre në gjimnaz dhe fakultet të jenë më të përgaditur për të përdorur teknologjinë për mësim. Në shkollën fillore Kirili dhe Metodi specialisti i TI nuk ka detyrë të ndara për mbështetje teknike të rrjeteve dhe pajisjeve teknologjike në shkollë por në fakt është arsimtarë i Informatikës që ndihmon arsimtarët kur ka nevojë si dhe mirëmban një kabinet me 20 monitorë dhe dy njësi qendrore në të cilat kanë të instaluar Windows 7 dhe 3 printerë të tjerë në zyre të cilët i mirëmban. Por, për këtë punë personi nuk paguhet, pra nuk ka për detyrë vetëm pjesën e TI në shkollë, por punon edhe si arsimtar. TI specialisti pohon që arsimtarët me kënaqësi përdorin teknologjinë pasi ata konsiderojnë se teknologjia atyre u ndihmon në mësimdhënie si dhe nxënësve në nxënie më cilësore. Sa i përket trajnimeve, arsimtari nuk ka për detyrë të trajnojë arsimtarët e tjerë në shkollë por me kënaqësi siguron mbështetje teknike kur kërkohet nga arsimtari i informatikës. Po ashtu arsimtari i informatikës pohon se edhe pse konsideron se arsimtarët janë të aftë për të përdorur teknologjinë ata kanë nevojë edhe për trajnime. Specialisti i TI në shkollë pohon se përdorin platformat e Ministrisë së Arsimit si dhe marrin pjesë në projekte.

### **Analiza dhe interpretimi i të dhënave nga intervistat me TI specialistin në SHF Migjeni**

Teknologjia ndikon pozitivisht në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Për dallim nga shkolla Kirili dhe Metodi specialisti i TI në shkollë fillore Migjeni ka për detyrë të mirëmbajë sistemet teknologjike në shkollë si dhe ka detyrën e Administratorit. Sipas administratorit Shkolla fillore Migjeni posedon shumë pajisje teknologjike si psh në 3 kabineta të shkollës ka pajisje kompjuterike, internet, EFI, Softuere, Tabela Inteligjente, Projektor. Sfidë e vetme është që teknologjia po avancohet shpejtë e ne me aq sa mundemi dhe sipas planit po furnizohemi me teknologjinë më moderne. Administratori konsideron se teknologjia në mësimdhënie dhe nxënie është e domosdoshme pasi për çdo pyetje teknologjia siguron përgjigjen e duhur si dhe librat që ata përdorin janë në formë elektronike. Pothuajse të gjithë arsimtarët e SHF Migjeni përdorin teknologjinë në procesin e mësimdhënies. Trajnime ka pasur edhe për nxënësit psh



për Meet and Code si dhe Micro Bit. Në shkollë është krijuar Grupi i kodimit në të cilin janë të angazhuar disa arsimtar dhe nxënës. Sa i përket trajnimit të vazhdueshëm të arsimtarëve administrator është përgjigjur që nuk është i përfshirë aty. Si shkollë janë të kyqur në ERASMUS si dhe disa arsimtarë përdorin EDUINO, EDMONDA ZOOM si dhe Microsoft Teams. Këto janë platforma që tani në situatën e krijuar arsimtarët në fakt janë të detyruar të përdorin për të vazhduar procesi edukativo arsimor pa ndërprerje. Shumica e arsimtarëve kanë njohuri për përdorim të teknologjisë në mësimdhënie. Ka kërkesë për mbështetje teknike nga ana e arsimtarëve. Trajnimi është i duhur për disa arsimtarë.

### **Intervista me anëtarin e Këshillit të Shkolës Fillore Migjeni**

Përgjigje e marrur nga anëtari i Këshillit të kësaj shkollë ishin shumë profesionale. Së pari anëtari deklaroi se teknologjia në shkollën Migjeni është në nivelin e duhur por që ajo të përdoret në mënyrën më të mirë teknologjia duhet të jetë pjesë e programeve (kurrikulës) që më pas ajo të jetë e detyrueshme për tu përdorur në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Po ashtu për të qenë e mundur përdorimi efikas në mësimdhënie dhe nxënie teknologjia duhet të jetë e avancuar si pajisjet ashtu edhe internet dhe softërat e ndryshëm teknologjik në shkollë. Sipas anëtarit teknologjia ua kursen kohën arsimtarëve gjegjësisht koha e mësimit duplifkohet (ngjashëm me deklaratat e Michael Fullan), nxënësit kontrollohen më shpesh dhe më mirë për njohuritë e tyre si dhe njohuritë e nxënësve dalin jashtë kornizave të librave dhe kjo e bën nxënien më cilësore. Në kohën kur librat janë pothuajse në gjendje të mjerueshme teknologjia është ajo e cila u ndihmon më së shumti nxënësve prandaj kjo shkollë përdor teknologjinë në maksimum. Shkolla është e pajisur me shumë teknologji si internet, mjete audiovizuale, kompjutorë, cabinet të informmatikës, projektorë etj. Për sa i përket sfidave së pari internet duhet të përmirësohet të jetë më i mirë dhe më i shpejtë (ngjashëm me projektet e SHBA dhe Britanisë së Madhe). Nxënësit e adhurojnë teknologjinë në mësim. Anëtarët e këshillit lavdëruan drejtorin e shkollës se ai është me profesion nga fusha e teknologjisë informative, prandaj edhe bën maksimumin për të ndihmuar arsimtarët që të përdorin teknologjinë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies si dhe bën maksimumin për ta furnizuar shkollën me teknologji informative më të avancuar (ngjashëm me gjetjet tona teorike ku shumë autorë pohojnë se drejtorët të cilët kanë njohuri për përdorim të teknologjisë më tepër bëjnë përpjekje për të futur teknologjinë në mësimdhënie pra ia dinë rëndësinë teknologjisë prandaj bëjnë të pamundërën që shkolla të bëhet teknologjike i gjithë procesi arsimor të rrjedh me anë të teknologjisë). Siaps anëtarëve të këshillit drejtori bën aktivitete të shumta dhe mbështet edhe teknikisht arsimtarët duke nxitur ata që vazhdimisht të përdorin teknologjinë në mësimdhënie dhe nxënie dhe rezultatet e tij janë po ashtu të mira. Anëtari pohon se sa i përket furnizimit të shkollës ata së bashku me drejtorin bëjnë të pamundërën që ta furnizojnë shkollën me teknologji më të re por kjo varet edhe nga buxheti i shkollës. Për sa i përket bashkëpunimit me Ministrinë në projekte sipas anëtarit nuk ka ndonjë dobi nga Ministrija, pak ka dobi nga OJQ dhe më së

shumti mbështeten në forcat e tyre pra buxhetin e shkollës duke menaxhuar mjetet në mënyrën më të mirë të mundur.

Përfitimet nga teknologjia janë të shumta për nxënësit e kësaj shkollë sipas nëtarit të këshillit të shkollës. Nxënësit marrin njohuri jashtë librave të cialt janë me përmbajtje të vjetra dhe jashtë kontesktit kohor në krahasim me trendet botërore. Sa I përket zhvillimit profesional organizohen punëtori për përdorim të teknologjisë. Sipas Këshilltarit të shkollës shkolla nuk ka specialist të TI pasi Ministrija nuk parasheh ashtu vendi të punës.

Efikasitetin e metove të bazuara në metodologji këshilltari e vlerëson shkëlqyeshëm nëse duam të jemi në hap me kohën. Reformat në arsimin fillor janë të nevojshme dhe depolitizim I arsimit. Sipas këshilltarit mësimi duhet të zhvillohet në një ndrim (me siguri mendon në mësim tërëditor) e jo në dy apo tre ndrime nëse duam cilësi.

#### **4.2. Përfundimi nga analiza e të dhënave**

Në pjesën e përfundimit nga analiza e të dhënave do të numërojmë disa nga gjetjet në dy shkollat fillore të komuës së Tetovës, Bratstvo Migjeni dhe Kirili dhe Metodi. Do të nisim me rradhë sipas rradhitjes së pyetjeve në pyetësor:

- Shkollat kanë internet, (jo aq cilësor dhe jo aq të shpejtë), por për shkak të mungesës së pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve tjera nëpër klasa interneti pak përdoret për qëllime arsimore, gjegjësisht në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Edhe pse, shkolla Kiril dhe Metodi sipas gjetjeve nga intervistat dhe pyetësorët dallohet dukshëm në përdorimin e teknologjisë informative në klasë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Po ashtu kjo shkollë ka edhe pajisje teknologjike më shumë se shkolla Migjeni.
- Mungojnë projektorë dhe pajisje tjera teknologjike nëpër klasa, prandaj edhe zbatimi i paradigmes së re të mësimdhënies nuk bëhet në mënyrën dhe dinamikën e nevojshme. Më saktë, shkolla fillore Kiril dhe Metodi kishte më tepër projektorë se sa shkolla fillore Bratstvo-Migjeni.
- Nxënësit në numër shumë të madh në të dy shkollat fillore parapëlqejnë përdorimin e teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies.
- Arsimtarët e të dy shkollave (pjesa dërmuese e tyre) vlerësojnë pozitivisht rolin e teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies dhe mendojnë se intensifikimi i përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie do sjellte rezultate më të mira nga të mësuarit tek nxënësit.

- Një numër i vogël i arsimtarëve në të dy shkollat konsiderojnë që mësimdhënia tradicionale akoma jep rezultate të mira dhe nuk duhet të eksperimentohet me teknologjinë në mësimdhënie dhe nxënie.
- Shumë arsimtarë, por pothuajse të gjithë nxënësit në të dy shkollat konsiderojnë veten të aftë për të përdorur teknologjinë dixhitale. Edhe pse mendimi i tyre është se duhet të organizohen trajnime për përdorim të teknologjisë në mësim.
- Sa i përket përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies të gjithë arsimtarët e intervistuar pohojnë se përdorin teknologjinë në mësimdhënie duke dhënë arsye të ndryshme si psh disa u përgjigjën që teknologjia ua bënë jetën më të lehtë, disa që është e nevojshme të përdoret në arsim, mësimi bëhet më interaktiv si dhe për shkak të ecurisë më të mirë të procesit të mësimdhënies dhe nxënies pork a edhe të tillë që thuan se janë të detyruar.
- Sa i përket pajisjeve teknologjike që arsimtarët përdorin në mësimdhënie dhe se ato pajisje a janë personale apo të shkollës shumica e arsimtarëve janë përgjigjur që përdorin lap top personal dhe të shkollës, kompjutorë të shkollës, si dhe projektorë dhe smartboards.
- Për sa i përket platformave elektronike arsimtarët janë përgjigjur pozitivisht. Ata pohojnë se përdorin Edmondo, Zoom, Skype, Meet, Eduino etj. Këto platforma me siguri përdorin tani kur mësimi mbahet online.
- Sa i përket metodave mësimore që arsimtarët përdorin në procesin e mësimdhënies dhe nxënies arsimtarët numërojnë metodat sin ë vijim: Kuize, Prezantime, Interaktive, Punë në grupe, You Tube, Metoda komunikimi, Të menduarit kritik me anë të Cluster (grumbullim idesh), Diskutim, Hulumtim, Krahësim, Vetëvlerësim, Bashkëpunim në laboratorin e kompjutorëve në shkollë etj.
- Për sa i përket efikasitetit të metodave modern vis a vis metodave tradicionale 80% e arsimtarëve pohojnë se metodat moderne janë më efikase (shumë më efikase) se sa ato tradicionale por 20% e mendojnë të kundërtë që metodat tradicionale akoma janë më efikase se ato modern të bazuar në teknologji.
- Sa i përket bashkëpunimit kolegjal në drejtim të përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies 80% e arsimtarëve janë përgjigjur që kanë një lloj bashkëpunimi disa thuan në nivel të lartë disa të mesëm pork a edhe të tillë që mendojnë se ky bashkëpunim është deri dikund (20%).
- Sa i përket efikasitetit të teknologjisë në mësim shumica e arsimtarëve janë të mendimit që efektiviteti i teknologjisë në mësim është prej i mesëm deri tek i lartë por ka edhe të tillë prapë 20% që mendojnë se nuk ka efekt përdorimi I teknologjisë në mësim.
- Për sa i përket pajisjeve elektronike në shkollë arsimtarët kanë shënuar këto pajisje sin ë vijim: SamrtBoard (tabela elektronike), cabinet laboratorik (informatike), projektorë, lap top. Dy

arsimtarë deklaruan se pajisje ka në shkollë por nuk punojnë. Po ashtu ata thonë se nuk kanë presion për të përdorur të njejtat.

- Sa i përket përfitimeve nga përdorimi i teknologjisë arsimtarët pohojnë se teknologjia u ndihmon atyre për t'i bërë ligjeratat më interactive, ka më tepër bashkëpunim mes arsimtarëve dhe nxënësve por edhe vetëm mes nxënësve. Disa arsimtarë deklaruan se ligjeratat nëpërmjet teknologjisë për nxënësit janë më tërheqëse ata pra kënaqen kur përdoret teknologjia në mësim si dhe janë më të vëmendshëm kur përdoret teknologjia në mësim. Sfidë është se disa arsimtarë nuk dinë të përdorin teknologjinë dhe kolegët e tyre u ndihmojnë atyre.
- Një numër i konsiderueshëm i nxënësve në të dy shkollat mendojnë se zbatimi i paradigmes së re, pra mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë do t'u ndihmonte atyre që të mësojnë më shumë dhe më me efikasitet.
- Drejtorët nuk i detyrojnë arsimtarët si dhe nuk bëjnë trysni për të përdorur teknologjinë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies por i inkurajon ata të përdorin teknologjinë sipas mundësive në shkollë. Edhe pse vërejtëm që drejtori i shkollës fillore Migjeni pasi është vetë nga lëmia e Informatikës më tepër inkurajon përdorimin e teknologjisë në mësim edhe pse edhe drejtori i shkollës Kirili dhe Metodi i inkurajonin arsimtarët të përdorin teknologjinë informative në klasë në ato kushte të cilat janë.
- Drejtorët e shkollave dhe Këshillat e shkollave akoma nuk e kanë futur teknologjinë në kurrikulat shkollore ose jo në masë të madhe. Por ata kërkojnë që kjo gjë të ndodhë sa më shpejtë dhe shkollat të pajisen me sa më tepër pajisje teknologjike sa është e mundur. Pamundësitë financiare sfidojnë këto projekte dhe plane por ata konsiderojnë se duhet kjo gjë të bëhet për të mirën e nxënësve pasi nxënësit sipas tyre parapëlqejnë mësimin modern nëpërmjet teknologjisë.
- Drejtorët edhe përkundër sigurimit të disa trajnimeve për përdorim të teknologjisë në mësimdhënie arsimtarët konsiderojnë se ka hapësirë për trajnime më të shpeshta si jashtë ashtu edhe brenda shkollave. Shumë arsimtarë konsiderojnë se nuk kanë trajnimeve të vazhdueshme dhe efikase për të përdorur metodat më të reja në mësimdhënie bazuar në teknologji, gjegjësiht ka pak dhe kjo gjë duhet intensifikuar.
- Më tepër se gjysma e arsimtarëve mendojnë se infrastruktura teknologjike nuk i plotëson kushtet për zbatim të paradigmes së re të mësimdhënies dhe nxënies bazuar në teknologji digjitale.
- Ekziston përpjekja e drejtorëve për modernizim të infrastrukturës teknologjike në të dy shkollat por kjo nuk është në nivel të duhur, e sidomos mungojnë pajisjet nëpër klasa atje ku edhe pritët që teknologjia të përdoret për çdo ditë në procesin edukativo arsimor.
- Drejtorët vlerësojnë pozitivisht angazhimin e arsimtarëve për të përdorur teknologjinë digjitale në procesin e mësimdhënies dhe nxënies pasi janë shumë të vetëdijshëm dhe vlerësojnë lartë rolin që

ka paradigma e re e mësimdhënies dhe nxënies bazuar në teknologjinë informative në klasë, gjeçjesisht vlersojnë efikasitetin e metodologjisë më të re bazuar në teknologji si dhe rolin e teknologjisë që ka në arsim.

- Asnjëra nga shkollat nuk kanë specialist të Teknologjisë Informative por arsimtarët e informatikës ndihmojnë arsimtarët e tjerë (sipas anëtarit të këshillit Ministrija nuk parasheh kësioj pozite në shkollë. Intervista me Adminsitratorin e Shkollës Fillore Migjeni siguroi të dhëna të cilët pohojnë që këtë funksion e kryen administratori.

## **2. Kufizimet**

Në këtë punim magjistrature si studim rasti janë përdorë vetëm dy shkolla fillore të komunës së Tetovës me madhësi të mostrës, sipas të dhënave të lartëpërmendura. Po ashtu, në këtë tezë është përdorë vetë-raportimi itë dhënave. Gjetjet e studimit janë bazuar në të dhënat e dala nga dy instrumentë siç janë: pyetësorët dhe intervistat me palët e interesit, që i kemi përmendur më lartë në punim. Po ashtu, ky studim do të përqëndrohet vetëm në palët e interesit përbrenda shkollave fillore pa përfshirë këtu administratorët komunal dhe ato shtetëror.

## **7.Përfundimi**

Drejtorët e shkollave luajnë një rol të rëndësishëm në ndryshimin e paradigmave të mësimdhënies. Situata aktuale në shkollat ku është kryer hulumtimi, ka nxjerrë na pah dallime për sa i përket zbatimit të paradigmës së re të mësimdhënies të bazuar në teknologji. Njëra shkollë ka siguruar një infrastrukturë më të zhvilluar si rezultat i së cilës është edhe përdorimi më i shpeshtë i teknologjisë në procesin edukativo-arsimor. Megjithatë, ka patur edhe faktorë të jashtëm që kanë parandaluar veprimet ekskluzive të drejtorëve në shkollat përkatëse në bërjen e detyrave të tyre drejtuese në shkollë. Ndonjëherë, faktorët e jashtëm kanë penguar zhvillimin dhe vijimin normal të aktiviteteve në shkollë.

Drejtorët edhe përkundër sfidave të ndryshme, duke qenë të vetëdijshëm për rolin e tyre që kanë në arritjet e nxënësve, kanë bërë maksimumin që të sigurojnë një ambient të mirëfilltë për zhvillim të mirë të procesit edukativo-arsimor. Ata me një menaxhim autonom kanë arritur që të sigurojnë kushte solide në shkollat e tyre për të siguruar zhvendosje të metodologjisë së mësimdhënies tradicionale në atë të mbështetur në teknologji.

Rëndësia që ka teknologjia sot në jetën e gjithësecilit, ka kontribuar në menaxhimin e çështjes së mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollat e tyre, në mënyrën më të mirë të mundur, edhe përkundër faktit se Ministria e Arsimit dhe institucionet tjera shtetërore e komunale nuk sigurojnë mjete të nevojshme për krijimin e një infrastrukture të pasur teknologjike në shkollat e tyre. Përkundër vështirësive, drejtorët

mundohen të sigurojnë mësimdhënie të bazuar në teknologji pasi vlerësojnë se pa të procesi edukativo arsimor nuk do të japë rezultatet e pritura.

Sa i përket zhvillimit profesional të arsimtarëve për të përdorur teknologjinë informative në procesin e mësimdhënies dhe të nxënës, drejtorët kanë pasur disa iniciativa dhe kanë siguruar trajnime, por kjo nuk ka mjaftuar dhe se ka nevojë për trajnime shtesë dhe të vazhdueshme që arsimtarët të mund të përdorin teknologjinë më të re në procesin edukativo-arsimor në shkolla.

Vlen të theksohet se shkollat janë të pajisura me teknologji dixhitale, kompjuterë me gjithë qasjen në internet, kabinete të informatikës, projektorë nëpër klasa (edhe pse jo të gjitha klasat), *SmartBoards* (jo shumë shkolla), printer[ të lidhur me internet.

Sa i përket përdorimit pothuajse të të gjithë arsimtarët e përdorin teknologjinë në mësimdhënie (80%) ndërsa vetëm 20 (%) akoma kanë dilemma. Teknologjia në të dy shkollat përdoret sipas planit dhe kurrikulës edhe pse të shkolla 'Kirili dhe Metodi' për shkak të kushteve më të mira përdoret më shpesh. Shumë arsimtarë në përgjigjet e tyre thonin se përdornin lap topat e tyre pasi klasat nuk kanë kompjuterë.

Hulumtimi teorik nxorri në pah të dhëna që tregojnë se shkollat më të përparura me teknologji siguronin kompjuterë për secilën klasë dhe secilin nxënë. Pastaj internet të shpejtë dhe softuare të avancuar. Më pas klasa të pajisura me teknologji dixhitale të shumta (Brody, 1995; (Alliance for Excellent Education, 2011, Savvidis, 2020, Project Tomorrow (2015) Department for Education, 2019; Valiente, 2010).

Sa i përket metodave bashkëkohore të mësimdhënies që arsimtarët përdorin në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në të dy shkollat provat që gjetjet nga hulumtimi në dy shkollat nxorren në pah metodat si në vijim: kuize nëpërmjet *google forms*, prezantime me anë të *powerpoint*-it, aktivitete interaktive, punë në grupe, metoda komunikimi, të menduarit kritik me anë të cluster (grumbullim idesh), diskutim, hulumtim, krahasim, vetëvlerësim, bashkëpunim në laboratorin e kompjuterëve në shkollë et, mësimi nëpërmjet projekteve, mësimi bashkëpunues, etj.

Drejtorët e të dy shkollave fillore e njohin rolin që teknologjia në ditët e sotit luan në arsim dhe për atë shkak nxisin arsimtarët që të përdorin teknologjinë në mësimdhënie. Teknologjia ndikon pozitivisht në procesin e mësimdhënies dhe të nxënës dhe se po ashtu ata thonë që sot pa teknologji as që mund të paramendohet e ardhmja e arsimit cilësor.

Pjesa dërmuese e arsimtarëve mendonin se teknologjia është e patjetërsueshme pasi që nxënësit e tanishëm janë më të motivuar kur përdoret teknologjia në mësimdhënie dhe mësojnë më mirë dhe më shumë. Arsimtarët janë deklaruar se teknologjia është pjesë e jetës së tyre dhe se ata janë shumë të vetëdijshëm për rolin që ka teknologjia në arsim, prandaj edhe e përdorin teknologjinë që të jenë të suksesshëm në procesin e mësimdhënies dhe nxënies që t'u ndihmojnë nxënësve të tyre të arsimohen në mënyrën më të mirë të mundshme dhe t'i përgadisnin ata për të ardhmen. Pra, arsimtarët e vlerësojnë

pozitivisht rolin e teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies dhe mendojnë se intensifikimi i përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie do sjellte rezultate akoma më të mira në shkollat e tyre.

Nxënësit në numër shumë të madh parapëlqejnë përdorimin e teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies pasi ata konsiderojnë se teknologjia atyre u ndihmon në mësim. Një numër i konsiderueshëm i nxënësve mendojnë se zbatimi i paradigmes së re, pra mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë, do t'u ndihmonte atyre që të mësojnë më shumë dhe më me efikasitet.

Ndërsa, sa i përket hipotezave të këtij punimi të magjistraturës, të cilat i vendosëm në fillim të këtij punimi, ky studim ka dhënë prova të mjaftueshme që mbështesin këto hipoteza.

## **1. Rekomandimet**

### **Duke u bazuar në konkluzionet e këtij punimi, do të japim rekomandimet si në vijim:**

Nevojiten ndryshime dhe reforma të vazhdueshme në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, duke zbatuar paradigmen e re të mësimdhënies të bazuar në teknologji.

Është i nevojshëm zhvillimi profesional i drejtorëve dhe arsimtarëve në përdorimin e teknologjive më të avancuara në klasë dhe trajnimi i arsimtarëve në pedagogjinë dixhitale (përdorim të teknologjisë për mësimdhënie dhe nxënie).

Duhet të përmirësohet infrastruktura teknologjike në shkollat fillore në Maqedoninë e Veriut në vazhdimësi dhe sipas trendeve dhe praktikave më të mira botërore. Pra, mbetet si rekomandim i domosdoshëm përpjekja maksimale e drejtorëve që të integrojnë teknologjinë informative në shkolla, duke furnizuar çdo klasë me pajisje teknologjike dhe çdo nxënës me nga një *lap top* dhe të përdoret Google Docs dhe Google Classroom për detyra të shtëpisë dhe konsultime me arsimtarët.

Rekomandohet që drejtorët e shkollave të formojnë komisione drejtuese të TIK në të dy shkollat e hulumtuara (por jo vetëm), të cilët mund të ndihmojnë në procesin e menaxhimit të zhvillimit të planeve të tyre për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike në shkollat fillore dhe monitorimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të zbatimit të atyre planeve si dhe zhvillimin e strategjive për integrimin e TIK në kurrikulat e shkollave. Në kontekst të këtij plani, duhet të parashihet edhe kërkesa për internet të shpejtë në shkolla. Dhe, normal si çdo projekt tjetër do të ketë nevojë për inkuadrim të një pike në plan i cili do parasheh zhvillimin profesional të arsimtarëve për të përdorur teknologjinë më të avancuar në drejtim të përmirësimit të performancës së përgjithshme të shkollës. Në çdo variant, rekomandimi sugjeron përfshirje të më tepër palëve të interesit duke përfshirë këtu edhe autoritetet qendrore dhe lokale shtetërore por edhe komunitetin e biznesit si dhe prindërit. Edhe ky rekomandim bazohet në gjetjet nga hulumtimi teorik të cilët mund t'i gjeni në brendi të këtij punimi.

Duke patur parasysh se nxënësit e moshës deri në 15 vjeç në Maqedoninë e Veriut shënuan rezultate më të ulëta se sa mesatarja e shteteve të OECD=së në lexim, matematikë dhe shkencë<sup>27</sup> rekomandojmë urgjentisht që këto lëndë të modernizohen gjegjësisht të aplikohen softuere të ndryshëm në mësimdhënien e këtyre lëndëve. Zbatimi i TIK për këto lëndë të jetë në klasë dhe shtëpi nëpërmjet platformave elektronike si Google Classroom, Google Docs, etj. (Referenca Shkollat e Neë York-ut Kapitulli 2).

Ministria e Arsimit dhe Shkencës të krijojë vend të ri të punës nëpër shkollat fillore të Maqedonisë së Veriut për specialistë të teknologjisë informative, i cili do të kujdesej për përkrahjen teknike të arsimtarëve gjatë përdorimit të kësaj teknologjie, por edhe trajnimin e vazhdueshëm të drejtorëve, arsimtarëve dhe stafit tjetër të shkollës, si dhe identifikimin e nevojave teknologjike në shkollat fillore dhe këshillimin e drejtorëve të shkollave për furnizim të caktuar të pajisjeve teknologjike në shkolla sipas nevojave kurrikulare dhe jashtë kurrikulare.

Qeveria të furnizojë të gjitha shkollat fillore me pajisje më të avancuara teknologjike, internet të shpejtë, softuerë të avancuar, kompjuterë në secilën klasë, kompjuterë (*lap top*) për secilin nxënës dhe pajisje më të avancuara teknologjike në klasë, sipas nevojave të shkollave dhe sipas praktikave më të mira botërore.

---

<sup>27</sup> [https://www.oecd.org/pisa/publications/PISA2018\\_CN\\_MKD.pdf](https://www.oecd.org/pisa/publications/PISA2018_CN_MKD.pdf) Programme for International Student Assessment (PISA) results from PISA 2018.



## 8. Bibliografia

- Alliance for Excellence Education (2011), Monthly Archives: March 2011, Al-Harthy Ėaleed Amer Salim, (2016), 'Principles and Practice of Educational Management among Private Colleges in Muscat City', Sultanate of Oman, Mohamed V University, Rabat, Morocco, Head of Languages Department at Oman Tourism College, Oman, 2016
- Bates, Anthony Ėilliam (Tony) (2016), 'Teaching in a Digital Age,' licensed under a Creative Commons Attribution-Non Commercial 4.0, International License, except ěhere otherěise noted. ISBN 978-0-9952692-0-0
- Beare Hedley, Calděell Brian J., and Millikan Ross H., (2018), Creating an excellent school' Routledge Library Editions: Educationa Management, Some Neě Management Techniques, First published in 1989 by Routledge, This edition first published in 2018, by Routledge 2 Park Square, Milton Park, Abingdon, Oxon OX14 4RN and by Routledge 711 Third Avenue, Neě York
- Belias, D., Sdrolas I., Kakkos S., Athanasios N., Koustelios A. (2013), 'Traditional Teaching Methods Vs. Teaching Through The Application Of Information And Communication Technologies In The Accounting Field': Quo Vadis? European Scientific Journal 9(28):73-101, February 2013,
- Bingimlas, Khalid Abdullah, (2009), Barriers to the successful integration of ICT in teaching and learning environments: A revieě of literature, RMIT, University Bandura, VIC, Australia, Revieěed 17 March 2008, accepted 24 March 2009, Euroasia Journal of Mathematics and Technology Education, 2009, 5(3), 235-245
- Broky, Philip, J, (1995), Teaching Planning and Management Handbook, A Guide for School District Educational Technology Leaders, St. Luis Public Schools, Educational Technology Publications, Engleěood Cliffs, Neě Jersey
- Brooks, Martin G. and Brooks, Jacqueline Grennon (1999), 'The Courage to Be Constructivist', The Constructivist Classroom Pages 18-24, November 1999 | Volume 57 | Number 3
- Bush, Tony, Bell, Les, Bolam Ray, Glatter Ron, Ribbins, Peter 'Educational Management, Redefining theory, Policy and Practice', 1999
- Bush, Tony (2009), 'Leadership and Management Development in Education', SAGE Publications Ltd, 1 Oliver's Yard, 55 City Road, London EC1Y 1SP,
- Bush, Tony (2011), Theories of Educational Leadership and Management, 4<sup>th</sup> edition, SAGE Publication Ltd, London
- Bush, Tony (2015), 'Understanding instructional leadership' First Published July 2, 2015 Editorial, <https://doi.org/10.1177/1741143215577035>, Article information, Free Access, Article Information, Volume: 43 issue: 4, page(s): 487-489, Article first published online: July 2, 2015; Issue published: July 1, 2015,

Bush, Tony & Glover Derek, (2003) 'School Leadership: Concepts and Evidence, A review of the literature carried out for NCSL by Tony Bush and Derek Glover of The University of Reading, National College for School Leadership, Full Report, Spring 2003

Carey Jeëtt, Eëilma Clark & Christina Hadjithoma-Garstka (2011) The use of learning platforms to organise learning in English primary and secondary schools, *Learning, Media and Technology*, 36:4, 335-348, DOI: 10.1080/17439884.2011.621955

Crane, Connie, M., (2005), 'Teacher perceived impact of technology on elementary classrooms and teaching', A Dissertation presented to the Faculty of the Graduate School University of Missouri-Columbia, In Partial Fulfillment of the Requirements for the Degree Doctor of Education, Dr. Dan Cockrell, Dissertation Supervisor Dr. Jerry Valentine, Dissertation Supervisor, July 2005,

DiBenedetto, O. (2005 , June). Does technology influence teaching practices in the classroom? Paper presented at the National Educational Computing Conference 2005 , Philadelphia, PA.

Department for Education (2019), Realising the potential of technology in education: A strategy for education providers and the technology industry,

Dimitrios B., Labros S., Nikolaos K., Maria Larissa G. K., Koustelios A. (2003), 'Traditional teaching methods vs. Teaching through the application of information and communication technologies in the accounting field: Quo Vadis?' Economics Dept. of Business Administration, Technological Education Institute of Thessaly, Trikala- Greece

Doersch, D. (2002). Put me in, coach! *Learning and Leading with Technology*, 30(3), 46–49., Google scholar.

Dunham, Christie, (2012), "Principals Roles and Responsibilities in Technology Integration in Rural Georgia" *Electronic Theses & Dissertations*. 786. Georgia Southern University, 2012

Esplin, Nathan, "Utah Elementary School Principals' Preparation as Technology Leaders" (2017)

European Commission (2013), 'Shaping Europe's digital future', REPORT / STUDY 14 March 2019, 2nd Survey of Schools: ICT in Education

Fullan Michael G., (1993) 'The Professional Teacher - Eëhy Teachers Must Become Change Agents', *Educational Leadership*, Volume 50 Number 6 March 1993

Fullan, Michael, (2020), 'Technology, the new pedagogy and flipped teaching', përditësimi i fundit, 15/03/2020

Fullan, Michael (2002), 'Principals as Leaders in a Culture of Change', Ontario Institute for Studies in Education University of Toronto, Paper prepared for Educational Leadership, Special Issue, May 2002, Revised March 12, 2002

Fullan, Michael (2016), 'The new meaning of educational change', fifth edition, published simultaneously by Teachers College Press, 1234, Amsterdam Avenue, New York, and by the Ontario Principals' Council, 180 Dundas, Toronto, Canada, Governments, pgs 209-215

Gates, Bill, (2005), National Education Summit on High Schools, Bill Gates gave remarks at 2005

Ginsburg, Mark (2011), EQUIP2 State-of-the-Art Knowledge Series in Education "A Guide to Education Project Design Based on a Comprehensive Literature and Project Review", USAID, 2011

Gupta, Priyanka, (2016), "Role of School Leaders", Roles & Responsibilities of a School Leader in Technology Integration, 9 October 2016

Hallinger, Philip, (2005), 'Instructional Leadership and the School Principal: A Passing Fancy that Refuses to Fade Away', September 2005 Leadership and Policy in Schools 4(3), DOI: 10.1080/15700760500244793,

Hallinger, Philip, (2010), 'Developing Instructional Leadership' In book: Developing Successful Leadership, DOI: 10.1007/978-90-481-9106-2\_5, June 2010

Kamenetz, Anya (2009), "How Web-Savvy Edupunks Are Transforming American Higher Education

Khlaif, Z.N., Farid, S. Transforming learning for the smart learning paradigm: lessons learned from the Palestinian initiative. Smart Learn. Environ. 5, 12 (2018)

Keane, Therese, William F. Keane, Aaron S. Blicblau, (2013), "The Use of Educational Technologies to Equip Students with 21st Century Skills" Swinburne University, Australia, X World Conference on Computers in Education July 2-5, 2013; Toruń, Poland,

Keane, Theresa, Catherine Lang, Chris Pilgrim, (2012), "Pedagogy! iPadology! Netbookology! Learning with Mobile Devices",

Kinshuk, Dr Nian-Shing, Chen Nian-Shing, Cheng-I-Ling, Cheng-Sie, Eai Sylvia Chee, Sie Eai Sylvia Chee, 'Evolution Is not enough: Revolutionizing Current Learning Environments to Smart Learning Environments', February 2016, DOI: 10.1007/s40593-016-0108-x,

Kivunja, Charles (2015), 'Exploring the Pedagogical Meaning and Implications of the 4Cs " Super Skills " for the 21 st Century through Bruner's 5E Lenses of Knowledge Construction to Improve Pedagogies of the New Learning Paradigm', School of Education, The University of New England, Armidale, Australia Email: ckivunja@une.edu.au Received 23 January 2015; accepted 12 February 2015; published 17 February 2015 Copyright © 2015 by author and Scientific Research Publishing Inc. This work is licensed under the Creative Commons Attribution International License (CC BY). <http://creativecommons.org/licenses/by/4.0> February 2015 Creative Education 6(02):224-239, DOI: 10.4236/ce.2015.62021, License CC BY 4.0/

Knoeppel, Robert C. (2005), 'Measuring Teacher Quality: Continuing the Search for Policy-Relevant Predictors of Student Achievement' Paper originally presented at the annual conference of the University Council for Educational Administration, Nashville, TN, November, 2005

Levin, T. & Eadmany, R. (2008). Teachers' Views on Factors Affecting Effective Integration of Information Technology in the Classroom: Developmental Scenery. *Journal of Technology and Teacher Education*, 16(2), 233-263. Eaynesville, NC USA

Light Daniel and Pierson Elizabeth (2013), 'The Impact of School Technology Infrastructure on Teachers' Technology Integration A Survey in Thirteen Countries', Article in *Ubiquitous Learning: An International Journal* · January 2013, DOI: 10.18848/1835-9795/CGP/v05i04/40376

Maxcell, John, (2017), "The 5 Levels of Leadership", Proven Steps to Maximize Your Potential, Summary, 8500 East 159th Street, Overland Park, KS 66223, 913.814.7223, [www.VisitGraceChurch.com](http://www.VisitGraceChurch.com), last update 4 Jul 2017,

Ming-Hung Lin, Huang-Cheng Chen, Kuang-Sheng Liu (2017), A Study of the Effects of Digital Learning on Learning Motivation and Learning Outcome, Tung-Fang Design Institute, TAIËAN, OPEN ACCESS EURASIA, *Journal of Mathematics Science and Technology Education* ISSN: 1305-8223 (online) 1305-8215 (print) 2017 13(7):3553-3564 DOI 10.12973/eurasia.2017.00744a, Received 18 October 2016 ▪ Revised 22 February 2017 ▪ Accepted 19 March 2017

Muijs, D., & Reynolds, D. (2011). *Effective Teaching: Evidence and Practice* (3rd ed.). Los Angeles, CA: Sage.

Nagel David, (2013), '6 Technology Challenges Facing Education', *Ed Tech Trends*, Nees 06/04/13

Nagel David, (2014), 'Competencies in Teaching, Learning and Educational Leadership in the Digital Age' edited by J. Michael Spector, Dirk Ifenthaler, Demetrios G. Sampson, Pedro Isaias

National Science Board (2018), *Science & Engineering Indicators 2018*, 'Science and Engineering Indicators 2018

OECD (2011). *PISA 2009 Results: Students On Line: Digital Technologies and Performance* (Vol. VI). OECD: Paris, France.

OECD (2010a). *Are the New Millennium Learners Making the Grade? Technology Use and Educational Performance in PISA 2006*. OECD: Paris, France.

OECD (2010), *Inspired by Technology, Driven by Pedagogy*, OECD Publishing, Chapter 10

University of Washington - Center for Teaching and Learning, (2020),

Panworld Education, 'BENEFITS OF DIGITAL LEARNING OVER TRADITIONAL EDUCATION METHODS', Blog, March 23, 2017

Parsons Jim, Beauchamp Larry (2012), 'Leadership in Effective Elementary Schools: A Synthesis of Five Case Studies', *US-China Education Review B* 8 (2012) 697-711, Earlier title: *US-China Education Review*, ISSN 1548-6613, University of Alberta, Canada

Pedro, Arnold De, (2019), 'Top 10 Advantages and Disadvantages of Technology for Education Aug 5, 2019

Preedy Margaret, Ron Glatter and Rosalind Levancic (2004), 'Educational management-Strategy, quality and resources', Open University Press, McGroë-Hill Education, McGroë-Hill House, Shoppenhangers Road, Maidenhead, Berkshire, SL6, 2QL, United Kingdom

Realinfluencers, Redacción (2019), '8 methodologies that every 21st century teacher should know 9th May 2019

Savvidis, Pano, (2020), 'Top 6 benefits of using technology in the classroom', *Affordable and Outstanding School Websites & Mobile Apps* school websites and mobile apps Join over 4,000 schools in the UK that use School Jotter websites, mobile apps and educational software. Copyright © 2020

Sigri, Unsal, (2010), 'The paradigm shift in educational management: An evaluation of distributed learning as future approach', January 2010, *Turkish Online Journal of Educational Technology* 9(2):205-211,

Silva, E. (2008), "Measuring skills for the 21st century". 1-18. Retrieved from

Schleicher, A. (2012), Ed., *Preparing Teachers and Developing School Leaders for the 21st Century: Lessons from around the World*, OECD Publishing

Social Research (2015), 'Literature Review on the Impact of Digital Technology on Learning and Teaching CHILDREN, EDUCATION AND SKILLS', ICF Consulting Services Ltd, November 2015

Tatnall, A., Visscher, A.J., Finegan, A., O'Mahony, C. (Eds.) (2009), 'Evolution of Information Technology in Educational Management', 2009

Tierney Kimberley (2020), 'How Technology in the Classroom Is Shaping the Future of Education', Jan 14, 2020

Sinnema, Claire E.L.& Robinson, Viviane. M. J. (2007), 'The Leadership of Teaching and Learning', *Implications for Teacher Evaluation*, The University of Auckland, New Zealand

Starr, Linda, (2009), 'The Administrator's Role in Technology Integration', Article published in *Education World®*, Copyright © 2009, Education World, Updated 09/23/2009

Tatnall, Arthur, & Pitman, Allan, (2002) 'Information Technology and Control in Educational Management, January 2002, DOI: 10.1007/978-0-387-35689-1\_7, SourceDBLP, paper presented at the Conference: Management of Education in the Information Age: The Role of ICT, IFIP TC3/EG3.7 Fifth Working Conference on Information Technology in Educational Management (ITEM 2002), August 18-22, 2002, Helsinki, Finland The Definition Of The Flipped Classroom

TeachThought Staff, 'The Definition Of The Flipped Classroom', January 16, 2014 - Updated on January 6, 2020 in Learning

UNESCO (2003b). Towards policies for integrating information and communication technologies into education.

Valiente, Oscar (2010), "1-1 in Education: Current Practice, International Comparative Research Evidence and Policy Implications", OECD Education Working Papers, No. 44.

Vieë Sonic Library (2020), '5 Disadvantages of Technology in the Classroom (And How to Overcome Them)', February 25, 2020

Vrasidas, Charalambos, Irineos Pattis, Petros Panaou, Maria Antonaki, Christiana Aravi, Lucy Avraamidou, Katerina Theodoridou 'Teacher Use of ICT: Challenges and Opportunities, CARDET – University of Nicosia, Proceedings of the 7th International Conference on Networked Learning 2010, Edited by: Dirckinck-Holmfeld L, Hodgson V, Jones C, de Laat M, McConnell D & Ryberg T 439 ISBN 978-1-86220-225-2

Æiburg, K.M (1997). 'The dance of change: Integrating technology in classrooms.

Computers in the Schools,' by Howarth Press Inc, Volume 13, No ½, 1997

Æallace Foundation Report, (2013), 'The school principal as leader: Guiding schools to better teaching and learning', Expanded Edition, January 2013

Æatson, John; Pape, Larry; Murin, Amy; Gemin, Butch; Vashaë, Lauren, (2014), 'Keeping Pace with K-12 Digital Learning: An Annual Review of Policy and Practice. Eleventh Edition', Evergreen Education Group, <https://eric.ed.gov/?id=ED558147>

Æright, S. P., Horn, S. P., & Sanders, E. L. (1997). Teacher and classroom context effects on student achievement: Implications for teacher evaluation. Journal of Personnel Evaluation in Education, 11(1), 57–67. <https://doi.org/10.1023/A:1007999204543>

Zajazi, Tahir, (1997), Pedagogjia e arsimit I, Logos-A, Shkup

Zajazi, T. (2003), Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies, Shkup, 2003

Мерки и заклучоци од 26-та Седница на Влада на Република Северна Македонија-  
<https://vlada.mk/covid19#ministries>

Linqe nga interneti

<https://www.ukessays.com/essays/education/traditional-versus-modern-methods-of-effective-teaching-education-essay.php>

ICT in Schools, PROMOTING THE QUALITY OF LEARNING, Inspectorate Evaluation Studies, 2008 Department of Education and Science, ISBN-0-0000-0000-X, Designed by Slick Fish Design,

Dublin Printed by Brunsöick Press, Dublin, Published by, Evaluation Support and Research Unit Inspectorate, Department of Education and Science, Marlborough Street, Dublin  
<https://ëëë.education.ie/en/Publications/Inspection-Reports-Publications/Evaluation-Reports-Guidelines/ICT-in-Schools-Inspectorate-Evaluation-Studies.pdf>

Ëhy teachers need to improve their ICT skills, <https://ëëë.ics.ie/neës/ëhy-teachers-need-to-improve-their-ict-skills>

## 9. SHTOJCAT

### Shtojca 1

Shkolla fillore ‘BRATSTVO-MIGJENI’ Tetovë, Drejtori i shkollës , 2020

I nderuar drejtor:

Nëpërmjet kësaj letre dëshiroj të kërkoj mbështetjen tuaj gjatë kryerjes së pjesës praktike të tezës sime të magjistraturës me temë: “Menaxhimi i paradigmave të mësimdhënies bashkëkohore mbështetur në teknologjinë e komunikimit në arsimin fillor në komunën e Tetovës” të cilën po e bëj në UEJL, në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit, programin Master në Menaxhim dhe udhëheqje të arsimit. Më saktë, këtë letër po ua dërgoj me qëllim të marrjes së lejes suaj për të kryer hulumtimin që është pjesë e tezës sime të magjistraturës në shkollën tuaj.

Në vazhdim dëshiroj të ju informoj se unë planifikoj të bëj ca intervista me Ju si Drejtor I shkollës, ndonjë anëtar të Këshillit të shkollës suaj, anëtarëve të këshillit të prindërve, specialistin e teknologjisë informative në shkollën tuaj, si dhe të shpërndaj ca pyetësorë arsimtarëve dhe nxënësve të shkollës suaj.

Ju lutem të gjeni të bashkangjitur pyetjet e intervistës me drejtorët, pyetjet e intervistës me anëtarët e këshillit të shkollës, pyetjet e intervistës me anëtarët e këshillit të prindërve, pyetjet e intervistës me specialistin për teknologji informative në klasë (TIK), pyetësorët për arsimtarë dhe pyetësorë për nxënës që do të shpërndahen të gjithë palëve të shkollës suaj.

Pjesëmarrja në këtë hulumtim do të kërkojë një angazhim shumë të vogël në kohë për ju dhe stafin tuaj si dhe për nxënësit. Mund të ju siguroj që përgjigjet do të mbeten konfidenciale. Përgjigjet do të kombinohen për të siguruar statistika përshkruese.

Ju lutemi ndihmoni për të siguruar që anketimet të përfundohen dhe të kthehen në kohën e duhur, pasi mbledhja e të dhënave të sakta dhe të plota do të jetë thelbësore për suksesin e këtij studimi.

Pas përfundimit të këtij studimi, shkolla mund të kërkojë një raport të plotë për këto rezultate. Pjesëmarrja dhe mbështetja juaj vlerësohet shumë. Nëse keni ndonjë pyetje, mund të kontaktoni Fazlije Ceka , numri I telefonit mobil: 071 330 133.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj!

Me respekt!

## **Shtojca 2 - Pyetje për intervistë me drejtorët e shkollave**

Ju kisha lutur që të na jepni disa informata rreth mendimit tuaj për ndikimin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor në shkollën tuaj si dhe efikasiteti i mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë në rezultatet e të nxënit. Ju Faleminderit paraprakisht!

1. A mendoni se teknologjia ndikon pozitivisht apo negativisht në procesin edukativo arsimor në shkollat fillore në përgjithësi, si dhe në shkollën tuaj në vecanti? Si ndikon teknologjia në të mësuarit e nxënësve të klasave të 6, 7, 8, dhe 9?
2. A përdorni teknologji në shkollën tuaj, gjegjësisht në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën tuaj? Nëse po, pse keni vendosur të përdorni teknologji? Nëse jo, pse nuk e përdorni atë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën tuaj?
3. Cfarë infrastrukture keni instaluar juve në shkollën tuaj? Kur i keni sjell ato në shkollën tuaj dhe si i përdorni ato? Cilat pajisje teknologjike ju përdorni në shkollën tuaj? A komunikoni nëpërmjet teknologjisë me të punësuarit tuaj (email, etj) apo edhe me palët tjera të interesit (prindër, komunë, ministri, etj)?
4. Cilat veprime keni ndërmarë për modernizimin e infrastrukturës teknologjike në shkollën tuaj?
5. Cilat janë sfidat tuaja për modernizimin e infrastrukturës teknologjike në shkollën që ju drejtoni? A është kostoja e madhe për të mirëmbajtur dhe për të zhvilluar më tej infrastrukturën e TIK në shkollën ku punoni? Apo edhe sfida të tjera si joaftësia apo jovullnetshmëria e arsimtarëve për të përdorur teknologjinë apo edhe tjera sipas jush.
6. Cilat janë mundësitë tuaja financiare si shkollë për të furnizuar shkollën me teknologji? A vareni nga komuna, ministrija, etj? Ju lutem nje sqarim!
7. Cilat janë përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies?
8. Si e perceptoni rolin tuaj si drejtor për të integruar teknologjinë në shkollën tuaj? A keni bashkëpunim konkret me Ministrinë e arsimit të RVM për të integruar platformat elektronike të ministrisë në shkollën tuaj? A keni bashkëpunim me organizata joqeveritare në drejtim të



furnizimit të shkollës me teknologji dhe trajnimit të stafit për të përdorur të njëjtat? Me cilat institucione shtetërore bashkëpunoni për të siguruar resurset teknologjike në shkollën tuaj?

9. Cilat lloje të aktiviteteve të zhvillimit profesional të përqendruara në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie keni ndërmarrë ju si drejtor? Cfarë aktivitete keni ndërmarrë në 2 vitet e fundit? Apo i keni dërguar arsimtarët në ndonjë trajnim për përdorim të teknologjisë?
10. A keni zyrtarë specialist për përkrahje të teknologjisë informative në shkollë dhe cfarë detyrash ka ai/ ajo?
11. Në ç'masë ekziston bashkëpunimi i arsimtarëve në kontekst të përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën tuaj?
12. A bashkëpunoni me shkollat tjera në fushën e zbatimit të teknologjisë në procesin edukativo arsimor?
13. Si do ta vlerësonit efikasitetin e metodave moderne të mësimdhënies të bazuara në teknologji në procesin edukativo arsimor (mësimdhënie dhe nxënie) dhe rezultatet e të mësuarit të nxënësve nga këto metoda moderne? Cilat metoda nëpërmjet teknologjisë i konsideroni si më efektive dhe a iu sugjeroni arsimtarëve të i përdorin këto?
14. Gjatë vëzhgimit të mësimdhënies (arsimtarëve) a i vlerësoni arsimtarët për integrim të teknologjisë në zhvillimin e atij mësimi apo jo? A qëndron në formularin e vëzhgimit ndonjë pyetje për përdorim ose jo të teknologjisë në mësim?

Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj! Me respekt!

### **Shtojca 3 - Pyetje për intervistë me specialistët e teknologjisë informative në shkollat fillore**

Ju kisha lutur që të na jepni disa informata rreth mendimit tuaj për ndikimin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor në shkollën tuaj si dhe mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë. Po ashtu, edhe për detyrat tuaja për sa i përket përkrahjes teknike të mësimdhënësve për tu aftësuar dhe për të mbajtur ligjeratat nëpërmjet teknologjisë. Ju faleminderit paraprakisht!

1. A mendoni se teknologjia ndikon pozitivisht apo negativisht në procesin edukativo arsimor në shkollat fillore në përgjithësi, si dhe në shkollën ku ju punoni në vecanti? Si ndikon teknologjia në të mësuarit e studentëve sipas jush si ekspert i teknologjisë informative?
2. A mund të na thoni se cfarë detyrash keni në këtë shkollë juve si specialist i TI?
3. Cilat pajisje teknologjike ju mirëmbani në shkollën tuaj? Numëroni ato ju lutem! Si dhe sa copë ka në përgjithësi? Cfarë infrastrukture keni instaluar juve në shkollën ku punoni? Si i mirëmbani? Në sa klasa keni instaluar teknologji dhe cfarë lloji?
4. Cilat janë sfidat tuaja për modernizimin e infrastrukturës teknologjike në shkollën ku punoni? A është kostoja e madhe për të mirëmbajtur dhe për të zhvilluar më tej infrastrukturën e TIK në shkollën ku punoni? Apo edhe sfida të tjera si joaftësia apo jovullnetshmëria e arsimtarëve për të përdorur teknologjinë apo edhe tjera sipas jush.
5. Sipas jush si specialist, a është i domosdoshëm përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie në klasë? Pse? Cilat janë përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies?
6. A jeni të kycur në trajnimin e mësimdhënësve dhe nxënësve për të përdorur teknologji në mësimdhënie dhe nxënie apo jo? Si menaxhohet trajnimi i mësimdhënësve për të përdorur teknologjinë? A e përdorin teknologjinë arsimtarët shpesh apo jo dhe pse po ose pse jo?
7. Si e perceptoni rolin tuaj si specialist për të integruar teknologjinë në shkollë? A keni direktiva të sakta nga Drejtori se si t'i qaseni kësaj çështjeje?
8. A përdorni platformat elektronike të Ministrisë së Arsimit në shkollën ku punoni? A bashkëpunoni me organizata të huaja joqeveritare sa i përket harmonizimit të veprimeve për të përfshirë teknologjinë në shkollë?

9. Në cilat sfera teknologjike (platforma, apps, etj) është përqëndruar aktiviteti juaj si ekspert i TI dhe cilat lloje të aktiviteteve të zhvillimit profesional të përqendruara në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie keni ndërmarrë ju në bashkëpunim me drejtorin e shkollës? Cfarë aktivitete keni ndërmarrë në 2 vitet e fundit?
10. Në ç'masë ekziston bashkëpunimi i arsimtarëve në kontekst të përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën ku ju punoni? A janë të aftësuar arsimtarët për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie dhe në cfarë niveli?
11. A ka kërkesa për mbështetje teknike gjatë mësimdhënies nga ana e arsimtarëve dhe cilat me cfarë probleme teknike ata ballafaqohen?
12. Si e vlerësoni aftësinë e arsimtarëve për të përdorur teknologjinë në klasë? A kanë nevojë për trajnim apo jo? Cilat pajisje teknologjike ata mund të përdorin e cilat jo?

Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj! Me respekt!

#### Shtojca 4 - Pyetësi për arsimtarët

Pyetjet e mëposhtme kanë për qëllim të vlerësojnë ndikimin që ka teknologjia në shkollat fillore dhe nivelin e integritetit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Vendosëm 25 pyetje që kërkojnë përgjigje të tipit Likert, që përdorin një shkallë prej 5 pikësh: "1" Aspak nuk pajtohem, "2" Nuk pajtohem, "3" Neutral, "4" Pajtohem, dhe "5" Pajtohem plotësisht; **Përgjigjet tuaja janë shumë të rëndësishme për hulumtimin, dhe konfidencialiteti është i siguruar.**

- |                                                                                                             |   |   |   |   |   |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|---|---|---|---|
| 1. Kemi kompjutorë në secilën klasë dhe mund t'i përdorim ato në mësim                                      | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 2. Kemi internet në shkollë dhe mund të përdorim atë në mësim                                               | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 3. Kemi projektorë dhe pajisje tjera teknologjike në secilën klasë                                          | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 4. Kam përdorur në mësim platformat elektronike të Ministrisë së arsimit                                    | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 5. Nxënësit janë më aktiv dhe më të angazhuar kur përdorim teknologjinë në mësim (e preferojnë teknologjinë | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6. Jam i aftë (kam njohuri dhe aftësi të mjaftueshme) të përdori teknologji informative në mësimdhënie      | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 7. Përdorimi i teknologjisë në mësim është i patjetërsueshëm në shkollën tonë                               | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 8. Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) ngrit cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies           | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 9. Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) është më efikase se sa mësimdhënia tradicionale     | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 10. Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) motivon nxënësit të mësojnë më tepër               | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 11. Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë (metodat moderne) rrit rezultatet e të mësuarit                      | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 12. Mësimdhënia nëpërmjet klasës së rrokullisur (flipped classroom) është një metodë që përdorim            | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 13. Mësimdhënia në përmejt teknol. kërkon më tepër planifikim se ajo tradicionale prandaj nuk e përdorim    | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

14. Përdorimi i teknologjisë në shkollën tonë nuk është i patjetërsueshëm  
prandaj nuk e përdorim atë 1 2 3 4 5
15. Kam nevojë për trajnim për të përdorur teknologjinë informative në  
mësimdhënie 1 2 3 4 5
16. Nuk ndjehem rehat të përdori teknologjinë në mësimdhënie prandaj aplikoj  
mësimdhënie tradicionale 1 2 3 4 5
17. Infrastruktura teknologjike në shkollën tonë nuk mundëson ligjeratat bazuar  
në teknologji 1 2 3 4 5
18. Teknologjia na merrë kohë nga koha e mësimdhënies prandaj nuk e përdorim 1 2 3 4 5
19. Kemi përkrahje teknike gjatë përdorimit të TIK në rast të ndonjë problemi  
teknik 1 2 3 4 5
20. Drejtori i shkollës bën tryzni mbi ne të përdorim teknologjinë informative në  
klasë 1 2 3 4 5
21. Drejtori i shkollës vazhdimisht modernizon infrastrukturën teknologjike në  
shkollë 1 2 3 4 5
22. Drejtori i shkollës vazhdimisht na dërgon në trajnime për të përdorur TIK në  
institucione tjera 1 2 3 4 5
23. Drejtori vazhdimisht organizon trajnime për përdorim të teknologjisë në  
mësim 1 2 3 4 5
24. Drejtori i shkollës gjatë vëzhgimit të mësimi na vlerëson se si dhe sa përdorim  
teknologjinë në mësim 1 2 3 4 5
25. Prindërit mbështesin përdorimin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor  
në shkollën tonë 1 2 3 4 5

Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj! Me respekt!

### **Shtojca 5 - Pyetje për intervistë me anëtarët e këshillit të shkollës**

Ju kisha lutur që të na jepni disa informata rreth mendimit tuaj për ndikimin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor në shkollën tuaj si dhe mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë.

1. A mendoni se teknologjia ndikon pozitivisht apo negativisht në procesin edukativo arsimor në shkollat fillore në përgjithësi, si dhe në shkollën tuaj në vecanti? Si ndikon teknologjia në të mësuarit e nxënësve?
2. A përdorni teknologji në shkollën tuaj, gjegjësisht në procesin e mësimdhënies në shkollën tuaj? Nëse po, pse keni vendosur të përdorni teknologji? Nëse jo, pse nuk e përdorni atë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën tuaj?
3. Cilat pajisje teknologjike ju përdorni në shkollën tuaj? Cfarë infrastrukture keni instaluar juve në shkollën tuaj? Kur i keni sjell ato në shkollën tuaj dhe si i përdorni ato?
4. Cilat janë sfidat për modernizimin e infrastrukturës teknologjike në shkollën tuaj?
5. Cilat janë përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies?
6. Si e perceptoni rolin tuaj si anëtarë këshilli të shkollës për të integruar teknologjinë në shkollën tuaj? A keni bashkëpunim konkret me Ministrinë e arsimit të RVM për të integruar platformat elektronike të ministrisë në shkollën tuaj? A keni bashkëpunim me organizata joqeveritare në drejtim të furnizimit të shkollës me teknologji dhe trajnimit të stafit për të përdorur të njëjtat?
7. Si e vlerësoni rolin e drejtorit në menaxhimin e paradigmeve tradicionale të mësimdhënies në ato bashkëkohore të bazuara në teknologji? Cfarë aktiviteteve dhe vendimesh ka marrë drejtori për të futur teknologjinë në mësimdhënie?
8. Cilat lloje të aktiviteteve të zhvillimit profesional të përqendruara në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie keni ndërmarrë ju si këshill shkolle? Cfarë aktiviteteve keni ndërmarrë në 2 vitet e fundit?
9. A keni zyrtarë specialist për përkrahje të teknologjisë informative në shkollë dhe cfarë detyrash ka ai/ ajo?

10. Në ç'masë ekziston bashkëpunimi i arsimtarëve në kontekst të përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën tuaj?
11. Si do ta vlerësonit efikasitetin e metodave moderne të mësimdhënies të bazuar në teknologji në ngitjen e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies?
12. Ju lutem të shtoni diçka nëse nuk përfshihet në pyetjet e mësimpërme!

Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj! Me respekt!

### **Shtojca 6 - Pyetje për intervistë me arsimtarët**

Ju kisha lutur që të na jepni disa informata rreth mendimit tuaj për ndikimin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor në shkollën tuaj si dhe mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë. Ju faleminderit paraprakisht!

1. A mendoni se teknologjia ndikon pozitivisht apo negativisht në procesin edukativo arsimor në shkollat fillore në përgjithësi, si dhe në shkollën tuaj në vecanti? Si ndikon teknologjia në të mësuarit e nxënësve të klasës së 6, 7, 8, dhe klasës së 9?
2. A përdorni teknologji në ligjeratat tuaja me klasat 6-9, gjegjësisht në procesin e mësimdhënies dhe nxënies? Nëse po, pse keni vendosur të përdorni teknologji? Nëse jo, pse nuk e përdorni atë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies?
3. Cilat pajisje teknologjike ju përdorni gjatë ligjeratave tuaja? A janë ato pajisje të shkollës apo personale?
4. A përdorni platformat elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe cilat më saktë?
5. Cilat metoda mësimore të bazuara në teknologji i përdorni më shpesh në ligjeratat tuaja? Ju lutem të numëroni disa metoda që ju përdorni gjatë mësimdhënies?
6. Si i vlerësoni ato, më efikase se sa metodat tradicionale apo e kundërta? Pra, si e vlerësoni efikasitetin e metodave moderne të mësimdhënies të bazuar në teknologji?
7. Në ç'masë ekziston bashkëpunimi i arsimtarëve në kontekst të përdorimit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën tuaj?
8. Si do ta vlerësonit efikasitetin e teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në shkollën tuaj?
9. Cilat pajisje teknologjike i posedon shkolla? Dhe a keni trysni nga drejtori për të përdorur ato?
10. Cilat janë përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjië në mësim? Cili është roli juaj si arsimtar në integrimin e teknologjisë në mësim?

11. Cilat lloje të aktiviteteve të zhvillimit profesional të përqendruara në përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie ka ndërmarrë shkolla? Cfarë aktiviteteve ka ndërmarrë në 2 vitet e fundit?
12. A keni marrë pjesë në trajnime për përdorim të teknologjisë në klasë? Kur dhe ku dhe për çfarë teknologjie? Kush e ka organizuar trajnimin dhe a ka qenë trajnimi efikas?
13. A ju ka ndihmuar trajnimi juve për të përdorur teknologjinë që ju përdorni gjatë ligjeratave/ mësimin?
14. A është zhvillimi profesional i detyrueshëm apo ju vullnetarisht ndjekni trajnimet?
15. A keni zyrtarë specialist për përkrahje të teknologjisë informative në shkollë dhe çfarë detyrash ka ai/ ajo?
16. Si e vlerësoni rolin e drejtorit tuaj në vendosjen e mësimdhënies moderne të bazuar në teknologji në shkollën ku ju punoni? Cfarë aktiviteteve ka ndërmarrë ai/ ajo për ta furnizuar shkollën me teknologji? A ju detyron juve të përdorni teknologjinë në mësim?
17. Ju lutem të shtoni ndonjë informatë për të cilën mua nuk mu ka kujtuar të ju pyes e që ju vlerësoni se është me rëndësi për ta përmendur!

Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj! Me respekt!



### Shtojca 7 - Pyetësi për nxënësit

Pyetjet e mëposhtme kanë për qëllim të vlerësojnë ndikimin që ka teknologjia në shkollat fillore dhe nivelin e integritetit të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Vendosëm 25 pyetje që kërkojnë përgjigje të tipit Likert, që përdorin një shkallë prej 5 pikësh: "1" Aspak nuk pajtohem, "2" Nuk pajtohem, "3" Neutral, "4" Pajtohem, dhe "5" Pajtohem plotësisht; Përgjigjet tuaja janë shumë të rëndësishme për hulumtimin, dhe konfidencialiteti është i siguar.

1. Kemi kompjutorë në secilën klasë dhe arsimtarët i përdorin ato gjatë  
mësimdhënies 1 2 3 4 5
2. Kemi internet në shkollë dhe e përdorim atë në mësim 1 2 3 4 5
3. Kemi projektorë dhe pajisje tjera teknologjike në secilën klasë 1 2 3 4 5
4. Përdorim në mësim platformat elektronike të Ministrisë së arsimit 1 2 3 4 5
5. Jemi të aftë për të përdorur teknologjinë gjatë mësimin, në vecanti platformat  
teknologjike të Ministrisë 1 2 3 4 5
6. Mësimdhënia bazuar në teknologji na bën më aktiv në mësim prandaj e  
preferojmë atë 1 2 3 4 5
7. Mësimdhënia bazuar në teknologji na mundëson të tregojmë rezultate  
më të mira në mësim 1 2 3 4 5
8. Mësimdhënia nëpërmjet teknologjisë është më efektive se sa mësimdhënia tradicionale  
1 2 3 4 5
9. Metoda bashkëkohore "klasa e rrokullisur" (flipped classroom)  
përdoret nga ana e arsimtarëve 1 2 3 4 5
10. Posedoj një telefon të mençur të cilin e përdori për çdo ditë në shtëpi 1 2 3 4 5
11. Posedoj një laptop në shtëpi dhe e përdori atë sipas nevojës 1 2 3 4 5
12. Me kënaqësi i bëj projektet shkollore nëpërmjet teknologjisë 1 2 3 4 5

- |     |                                                                                                          |   |   |   |   |   |   |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|---|---|---|---|---|
| 13. | Teknologjia në shkollën tonë nuk është e patjetërsueshme prandaj nuk e përdorim                          | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |   |
| 14. | Dij të shkruaj email (të dërgoj dokumente) dhe të komunikoj në rrjetet sociale                           | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |   |
| 15. | Mësimdhënia tradicionale është më e mirë dhe më me kuptim                                                |   | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 16. | Më duhet trajnim për të përdorur teknologjinë në mësim                                                   | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |   |
| 17. | Infrastruktura teknologjike në shkollë nuk mundëson mësimdhënien të bazuar në teknologji                 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |   |
| 18. | Teknologjia u merrë kohë arsimtarëve nga koha e mësimdhënies prandaj nuk e përdorin                      |   | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 19. | Arsimtarët përdorin shpesh teknologjinë gjatë ligjeratave të tyre                                        | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |   |
| 20. | Kemi përkrahje teknike gjatë përdorimit të teknologjisë në rast të ndonjë problemi teknik                | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |   |
| 21. | Drejtori i shkollës vazhdimisht modernizon infrastrukturën teknologjike në shkollë                       |   | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 22. | Drejtori i shkollës vazhdimisht i dërgon arsimtarët në trajnime për të përdorur teknologjinë             |   | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 23. | Drejtori vazhdimisht organizon trajnime në shkollë për arsimtarët se si të përdorin teknologjinë         |   | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 24. | Drejtori i shkollës gjatë vëzhgimit të mësimi i vlerëson arsimtarët se si dhe sa përdorin tekn. në mësim |   | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 25. | Prindërit mbështesin përdorimin e teknologjisë në mësim                                                  | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |   |

Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj! Me respekt!

### **Shtojca 8 - Pyetje për intervistë me anëtarët e këshillit të prindërve**

Ju kisha lutur që të na jepni disa informata rreth mendimit tuaj për ndikimin e teknologjisë në procesin edukativo arsimor në shkollën tuaj si dhe mësimdhënies nëpërmjet teknologjisë. Ju faleminderit paraprakisht!

1. A mendoni se teknologjia ndikon pozitivisht apo negativisht në procesin edukativo arsimor në shkollat fillore në përgjithësi, si dhe në shkollën ku ndjekin mësimin fëmijtë tuaj, në vecanti? Si ndikon teknologjia në të mësuarit e fëmijëve tuaj?
2. A përdorin fëmijtë tuaj teknologji kur mësojnë në shtëpi?
3. Cilat pajisje teknologjike posedoni juve në shtëpitë tuaja?
4. A përdorni platformat elektronike të Ministrisë së Arsimit dhe cilat më saktë?
5. Cilat metoda të bazuara në teknologji u pëlqejnë fëmijëve tuaj?
6. Në ç'masë ekziston bashkëpunimi i arsimtarëve me ju për sa i përket zbatimit të mësimdhënies dhe nxënies bazuar në teknologji?
7. Si do ta vlerësonit efikasitetin e teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies si dhe në rezultatet e të mësuarit të fëmijëve tuaj?
8. Cilat pajisje teknologjike i posedon shkolla ku ju mësojnë fëmijtë tuaj?
9. Cilat janë përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjië në mësim? Cili është roli juaj si prindër në integrimin e teknologjisë në mësim?
10. Si e vlerësoni rolin e drejtorit të shkollës ku vijojnë mësimin fëmijtë tuaj në vendosjen e mësimdhënies moderne të bazuar në teknologji në shkollën ku ju punoni? Cfarë aktivitete ka ndërmarrë ai/ ajo për ta furnizuar shkollën me teknologji?
11. Ju lutem të shtoni ndonje informatë që unë nuk arrita të ju pyes?

Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj! Me respekt!